monumentet



1 / 1990

DO NOT COPY

Kopertina e parë

Mozaiku i Tepes (Elbasan)

KOMITETI I KULTURËS DHE I ARTEVE
INSTITUTI I MONUMENTEVE TË KULTURËS
TIRANË

DO NOT COPY

monumentet

1/1990 (39)

KOLEGJIUMI I REDAKSISË

EMIN RIZA (KRYEREDAKTOR)
APOLLON BAÇE (ZV/KRYEREDAKTORI)
ALEKSANDËR MEKSI, GJERAK KARAISKAJ, GJERGJ FRASHËRI, HASAN NALLBANI, NERITAN CEKA, PIRRO THOMO

DO NOT COPY

Pronë letrare e Institutit të Monumenteve të Kulturës
pranë Komitetit të Kulturës dhe Arteve

Adresa e Redaksisë: Rruga «Alqi Kondi» Nr. 7.

DO NOT COPY

PASQYRA E LËNDËS

ARTIKUJ

Gjerak KARAISKAJ	Elementet arkitektonike në fortifikimet mesjetare shqiptare dhe vendi i tyre në arkitekturën ushtarake të kohës	5
Dilaver KURTI	Varret shkëmbore të Matit	35
Valter SHTYLLA *Lazër PAPAJANI*	Të dhëna teknike mbi rrugën e Luginës së Shkumbinit në antikitet dhe mesjetë	57
Shpresa PRIFTI	Shtëpia e zjarrit në banesën shkodrane të shek. XVIII-XIX dhe elementet arkitektonike të saj	75
Eduard SOPPI	Të dhëna të reja të përftuara gjatë restaurimit të pikturës së Kishës Shën Mëria e Brrarit	91
Latif LAZIMI *Agron DORACI*	Probleme të mbrojtjes së vlerave urbane të qytetit muze të Gjirokastrës	101
Guntram KOH	Një portret vajze i periudhës perandorake romake në Berat	115
Sotir KOSTA *Uliam ÇIKOPANO*	Mozaiku i Bazilikës paleokristiane në Tepe të Elbasanit. Vlerat dhe restaurimi	129
Gazmend MUKA	Të dhëna të reja nga restaurimi i pikturës në Katedralen «Fjetja e Shën Mërisë» Berat	139
Koço MIHO	Mbi disa ndërhyrje ndërtimore publike në vitet 1920 – – 1938 dhe mbi vendin e rolin e tyre në evoluimin urbanistik të qytetit të Tiranës	151

KRITIKË E BIBLIOGRAFI

Moikom ZEQO	«Onufri dhe piktorë të tjerë mesjetarë shqiptarë» libër – album nga Shyqri Nimani	157

DO NOT COPY

TABLE DE MATIERES

ARTICLES

Gjerak KARAISKAJ — Les éléments architectoniques des fortifications médiévales albanaises et leur place dans l'architecture militaire 30

Dilaver KURTI — Les tombes gravées dans la roche de la région de Mat 55

Valter SHTYLLA
Lazër PAPAJANI — Données techniques sur la route de la vallée de Shkumbin en antiquité et au moyen âge 72

Shpresa PRIFTI — La «maison du feu» dans l'habitation de Shkodra aux XVIIIe-XIXe sc. et les éléments fonctionnels constituants de son architecture 88

Eduard SOPPI — Nouvelles données obtenues pendant la restauration de l'église de Notre Dame à Brrar 100

Latif LAZIMI
Agron DORACI — Problèmes de la protection des valeurs urbaines de Gjirokastra 113

Guntram KOCH — Ein kaiserzeitliches Madchenportrat in Berat 124

Sotir KOSTA
Uliam ÇIKOPANO — La mosaïque de la basilique paléochrétienne à Tépé d'Elbasan. Les valeurs et sa restauration 138

Gazmend MUKA — Nouvelles données sur la restauration de la fresque dans la cathédrale «La dormition de la Vierge Marie» à Berat 150

Koço MIHO — Quelques interventions constructives publiques au cours des années 1920-1938, leur place et leur rôle dans l'évolution urbanistique de la ville de Tirana 156

CRITIQUES ET BIBLIOGRAPHIE

Moikom ZEQO — «Onuphre et d'autres peintres albanais du moyen âge« – livre album écrit par Shyqyri Nimani 160

Nr. 1 1990

monumentet

DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

ELEMENTET ARKITEKTONIKE NË FORTIFIKIMET MESJETARE SHQIPTARE DHE VENDI I TYRE NË ARKITEKTURËN USHTARAKE TË KOHËS

Elementet arkitektonike në kalatë mesjetare, të ruajtura deri në ditët tona, meritojnë një vëmëndje të veçantë përsa i përket studimit dhe ruajtjes së tyre. Ato shërbejnë shpesh jo vetëm si elemente datimi, por edhe për të ndjekur evolucionin në kohë e si dhe ndikimet e ndërsjellta midis kulturave fqinje apo më të largëta. Në këtë studim jemi përpjekur të evidencojmë ato pak elemente të ruajtura midis rrënojave të fortifikimeve mesjetare, përcaktimi i destinacionit dhe i morfologjisë së të cilave është me rëndësi të veçantë për punimet e ardhme restauruese, për më tepër kur komplekset e ndërtimeve mbi të cilat ato ngrihen na kanë arritur tepër të dëmtuara.

Frëngji shigjete dhe pushke

Frëngjitë për shigjetë dhe pushkë janë elementet më konservative në fortifikimet mesjetare. Për të qëlluar armikun nga brenda kullave apo kurtinave, nevojitej një e çarë vertikale në mur, e cila në pjesën e brendshme të tij zgjerohej në të dy anët, duke dhënë në prerje formën e një trekëndëshi. Ky parim mbeti për një kohë të gjatë, deri në zhdukjen e frëngjive. Kështu, është e vështirë dhe në shumë raste e pamundur të dallosh një frëngji të një periudhe nga një frëngji e një periudhe tjetër dhe madje një frëngji shigjete nga një frëngij pushke.

Sa më e lartë të ishte e çara vertikale e frëngjisë aq më e manovrueshme ishte ajo për të qëlluar në drejtimin e dëshiruar e sidomos poshtë, në rrezën e mureve. Por nga ana tjetër këto të çara të mëdha dobësonin fortësinë e mureve, duke i bërë ato më pak rezistente kundrejt goditjeve të makinave gurhedhëse.

Frëngjitë për shigjetë kanë qenë mjaft të larta, nga 1,5 – 3 m, dhe mendohet të jenë shfaqur për herë të parë në Angli dhe në Lindjen e Mesme, rreth fundit të shek. XII[1]. Por frëngjitë më të hershme për shigjetë në Shqipëri i hetojmë në Butrint, në një mur të pajisur me kulla trekëndëshe, që i takon periudhës më të hershme mesjetare të qytetit dhe datohet rreth shek. IX – X[2]. Kullat në këtë pjesë të fortifikimit nuk kanë qenë pajisur me frëngji, por ato ndodhen në njërën nga kurtinat. Frëngjitë vendosur 3,40 m mbi nivelin e terrenit nga ana e brendshme, me një gjerësi prej 0,85 m, përfundojnë në anën e jashtme të murit, me një të çarë vertikale 10 cm të gjerë dhe 0,45 m të lartë. Vendosja e frëngjive në një lartësi të konsiderueshme nga niveli i terrenit tregon se ato përdoreshin nga platforma apo shkallë druri. Nuk të habit fakti që në Butrint ndeshemi me frëngji shigjete kaq të hershme, pasi kemi të bëjmë me një qytet, i cili ka vazhduar të banohet pa ndërprerje nga koha antike deri në mbarim të mesjetës dhe sepse ruhen ende modele të gatshme frëngjish nga periudha më të hershme (p.sh. frëngjitë në Portën me kulla, e cila datohet në periudhën helenistike). Gjithashtu, lartësia e vogël e të çarës vertikale tek frëngjitë e Butrintit i përgjigjet atyre të periudhës

1) A. Chatelain, Chateaux forts, images de pierre des guerres médievales, Paris 1983, f. 97.

2) Gj. Karaiskaj. Butrinti dhe fortifikimet e tij, Tiranë, 1984, f. 76.

helenistike. Një frëngji të ngjashme me ato të Butrintit, datuar me saktësi nga gërmimet arkeologjike dhe rrethanat historike në dekadat e fundit të shek. XII, e hasim dhe në murin e brendshëm rrethues të qytetit mesjetar të Sardës.

Frëngjia e vetme, e konstatuar në këtë fortifikim, ka një lartësi 0,60 m dhe gjerësi të së çarës vertikale 0,20 m.

Frëngjitë e lartpërmendura, të Butrintit dhe Sardës, janë më të hershmet, që njohim deri më sot në vendin tonë, nga periudha mesjetare. Siç del e qartë dhe nga rasti i Sardës, përdorimi i tyre në shek. X-XII ka qenë i rrallë dhe vetëm në kurtina. Ato filluan të gjejnë një përdorim të gjerë, sidomos në kulla, vetëm gjatë shek. XIII. Kullat kuadratike të periudhës së Despotatit të Epirit në Butrint ishin pajisur me dy frëngji ballore në katin e sipërm dhe me një frëngji për flankimin e kurtinave në secilin mur anësor të katit përdhes. (Tab. VI, 1).

Dy frëngji ballore të së njëjtës periudhë i hasim dhe në një kullë në Berat (fig. 1). Frëngjitë e mësipërme kanë një lartësi prej 0,60 – 1 m dhe një gjerësi të së çarës vertikale që zë gjithë lartësinë e frëngjisë prej 10 – 15 cm. Ato kanë mbulesë dhe prag të rrafshët. Mbulesa formohet nga arkitra druri ose pllaka guri. Në këtë grup bëjnë përjashtim frëngjitë e Beratit, të cilat janë mbuluar me një qemer trungkonik dhe kanë një prag të pjerrur nga jashtë për të qëlluar poshtë, në rrëzën e mureve. Në këto të fundit e çara vertikale është mjaft e gjerë, 0,22 m dhe nuk zë gjithë lartësinë e frëngjisë, por pjesa e qemerit ka mundësi të jetë e rindërtuar.

Frëngjitë me mbulesë e prag të sheshtë, me të çarën vertikale në gjithë lartësinë e frëngjisë, i hasim dhe në një sërë fortifikimesh të shek. XV-XVI. Ato përshkojnë bedenat ose trashësinë e mureve të kullave e të kurtinave (Bashtovë, Durrës, Shkodër, Lezhë etj) (Tab. II, V). Lartësia e tyre është 50-70 cm, ndërsa gjerësia e të çarës vertikale 10-15 cm. Frëngjitë me mbulesë të sheshtë përdoren gjatë gjithë kohëve, por në shembujt e vonë e çara vertikale vjen duke u ngushtuar (4 – 7 cm) dhe në të shumtën e rasteve nuk zë gjithë lartësinë e frëngjisë e vjen gjithnjë duke u ulur. Në rastet kur pragu duhet të jetë i pjerrur, për të qëlluar poshtë mureve, mbulesa ndërtohet shpesh me shkallëzime të njëpasnjëshme, për të krijuar një linjë paralele me pragun. Këto frëngji i përkasin një periudhe të vonë dhe datohen në shek. XVIII-XIX (Tab. III). Përjashtimet e shumta, në tipin e frëngjive të mësipërme, vështirësojnë së tepërmi vendosjen e një kronologjie në bazë të evolucionit të tyre, por nga gjithë ky grup mund të veçohen vetëm ato frëngji që janë tipike



Fig. 1

për periudhat e vona, si ato të ulëta me të çara vertikale të ngushtë (rreth 4 cm) dhe të ulët në mënyrë të dukshme në raport me gjithë lartësinë e frëngjisë (Tab. I, III, V, IX).

Frëngjitë me mbulesë pllakash guri të vendosura në formë çatie, shfaqen më vonë dhe zhduken më herët. Ato janë karakteristike për periudhën e pushtimit turk, pas shek. XV. Megjithatë, një shembull më të hershëm të përdorimit të këtij tipi frëngjish që i përkasin periudhës së parë të ndërtimit, datuar rreth fundit të shek. XIV e hasim në kështjellën trekëndëshe në Butrint (Tab. VII), pranë kanalit të Vivarit. Evolucioni i frëngjive me mbulesë në formë çatie ndjek të njëjtën rrugë të frëngjive me mbulesë të sheshtë, që konsiston kryesisht në zvogëlimin e lartësisë të së çarës vertikale në raport me lartësinë e frëngjisë.

Frëngjitë me mbulesë në formë çatie janë zakonisht më të larta se ato të periudhave të mëvonshme. Lartësia e tyre shkon nga 0,50 deri në 0,80 m. Kur vendosen në lartësi ato mund të kenë dhe prag të pjerrur nga jashtë. Që këto të fundit shfaqen më vonë se frëngjitë me mbulesë të rrafshët e tregon dhe fakti se ato i hasim vetëm në parapete dhe asnjëherë në bedena. Ato bashkëjetojnë me tipe të tjera frëngjish, sidomos me ato me mbulesë të rrafshët, por asnjëherë me frëngji që janë tipike për periudhat më të vona, si ato që i përkasin kohës së Pashallëqeve të mëdha shqiptare (shek. XVIII-XIX). Një renditje të tillë mund ta konstatojmë në Kalanë e Shkodrës, ku ruhen frëngji të tipeve të ndryshme, që kapin periudhën nga shek. XV deri në

POZITIVE COPY

shek. XIX. Po të përjashtojmë Butrintin, si një rast të veçantë, ne do të propozonim për datimin e këtyre frëngjive periudhën ndërmjet shek. XVI-XVIII.

Frëngjitë për pushkë me mbulesë të rrumbullakët përfundojnë, në pjesën e sipërme, nga ana e brendshme e fortifikimit, me një hark guri të punuar, të përbërë nga dy pjesë. Ato kanë një lartësi 0,60 – 0,65 m dhe gjerësi të së çarës vertikale 6 – 7 cm. Një variant i këtij tipi janë dhe frëngjitë e mbuluara me arkitra guri të gdhendur në formë harku në pjesën e poshtme (Tab. III).

Frëngji të tilla të cilësuara si tipike veneciane dhe të datuara në disa raste rreth vitit 1700[3], gjenden me shumicë në Akrokorinth. Variantin e parë e hasim në Shkodër, në bedena dhe në një nga parapetet. Parapeti i takon periudhës së Pashallëqeve (shek. XVIII). Frëngjitë e hapura në bedena (Tab. III, 2) janë më të mëdha dhe me të çarën vertikale më të lartë e më të gjerë se frëngjitë e parapetit dhe janë pa dyshim më të hershme se këto të fundit, ndoshta ato i përkasin fundit të shek. XV, kur Shkodra ishte akoma nën sundimin venecian. Si frëngjitë e bedenave, ashtu dhe ato të parapetit, kanë pragje të pjerrëta nga ana e jashtme e fortifikimit, vetëm se këto të fundit mbulohen me një qemer të shkallëzuar. Të kësaj periudhe janë dhe frëngjitë që mbulohen me hark në formë maje lundre (Tab. III. 3),

Së fundi, mbeten për t'u shqyrtuar frëngjitë dyshe dhe treshe për armë zjarri, të cilat datohen përgjithësisht në shek. XVIII-XIX. Edhe këto frëngji paraqiten në tipe dhe variante të ndryshme. Por ato mund t'i ndajmë në dy tipe kryesore: 1) frëngji që përfundojnë në anën e jashtme me një të çarë, ndërsa nga brenda kanë dy ose më shumë vende luftimi dhe 2) frëngji që përfundojnë nga jashtë me dy ose tri të çara vertikale (Tab. I, IV, V). Frëngjitë dyshe dhe treshe me prag të pjerrur nga jashtë ose jo, i kemi ndeshur në Butrint (Kulla e veçuar Veneciane), Gjirokastër, Tepelenë, Peqin, Shkodër, etj. Vlen të përmendim se në Kullën Veneciane të Butrintit frëngjitë dyshe, të dy tipave të lartpërmendur, shoqërohen dhe me frëngji të thjeshta, të cilat nuk ndryshojnë nga ato të mesjetës (shek. XIII-XIV), veçse në to e çara vertikale në dalje është më e ngushtë (6 cm).

Pra, frëngjitë për shigjeta dhe pushkë, nuk mund të shërbejnë për datimin e objekteve në të cilat janë ndërtuar. Ato mund të vlejnë për këtë qëllim vetëm kur janë tipike për kohën që janë ndërtuar, d.m.th. kur bashkojnë në vetvete një sërë detajesh që kanë evoluar në kohë. Një karakteristikë tjetër e frëngjive në fortifikimet shqiptare të mesjetës është se ato janë të thjeshta dhe utilitare dhe nuk janë ndikuar nga frëngjitë e fortifikimeve të Europës Veriore e Perëndimore. Në këto të fundit vërehen variante të ndryshme të të çarave vertikale të frëngjive, të cilat mund të shihen më tepër si një ndjekje mode se sa për qëllime përdorimi. Nga ana tjetër ato duke përsëritur tipat e thjeshtë të frëngjive antike e të kohës romake nuk janë aq të larta sa këto të fundit. Kjo dukuri mund të shpjegohet dhe me faktin se gjatë mesjetës në Shqipëri ka vazhduar të përdoret, si dhe në antikitet, harku dhe shigjeta, ndërsa arbaleta që kërkonte frëngji të larta, për të krijuar mundësi manovruese, për të qëlluar poshtë mureve, nuk ka gjetur përdorim të gjerë.[4]

Telize (hurde), erkerë dhe mashikula

Telizet ose hurdet ishin konstruksione druri, të vendosura në formën e një ballkoni të mbuluar me çati në kreshtën e mureve ose të kullave, për të siguruar bazat e mureve nëpërmjet mbrojtjes vertikale, që realizohej nga vrimat e hapura në dyshemetë e këtyre ballkoneve.

Telizet që shfaqen gjatë shek. XII u përhapën në shek. XIII dhe vazhdojnë të përdoren deri në shek. XV[5]. Këto konstruksione nuk i rezistuan kohës dhe kanë arritur deri në ditët tona të rrënuara. Në radhë të parë ne na shqetësonte problemi se kur janë përdorur për herë të parë në vendin tonë këto lloje ndërtimesh, të cilat e bënin mbrojtjen e një kalaje aktive.

Përgjithësisht, është pranuar se elementet arkitektonike që shërbenin për të realizuar një mbrojtje vertikale të rrëzës së mureve dhe kullave, si telizet, erkeret dhe mashikulat, janë sjellë në Europë nga kryqtarët prej vendeve të Lindjes së Mesme. Shembulli më i hershëm i një mashikule me një vrimë datohet në vitin 551 në Sirinë Veriore, një mashikul

3) A. Bon, The medieval fortifications of Accocorinth and vicinity, Corinth, vollume III, part II, Harvard university press, Cambridge, Massachusetta, 1936, Tab. VIII.

4) Shih për frëngjitë për harqe dhe arbaleta O. Piper, Burgenkunde, Munchen, 1912, f. 337-338.

5) A. Chatelain, Chateaux fort. Images de pierre des guerres, medievales, Paris 1983, f. 101.

DOKTORATURA

PO ZOT'ORY

me dy vrima për hedhje gurësh ose lëngjesh të nxehta datohet në vitin 729. Më vonë, në vitin 1087, kemi një **shembull** para se këto elemente të përhapeshin në Europë[6], mashikula të tilla u ndërtuan nga muratorë armenë, në një portë të Kajros. Por, akoma nuk kemi ndonjë shembull të hershëm të përdorimit të telizeve në gjithë perimetrin e kullave apo gjatësinë e mureve. Nga të dhënat historike mësojmë se një element i tillë duhet të ketë qenë aplikuar në Kalanë e Durrësit në shek. XI. Gjergj Paleologu, i emëruar dukë në Durrës më 1081, me porosi të Aleks Komnenit, tek bedenat e kalasë ndërton, në një mënyrë të re, disa konstruksione druri, shumica të pambërthyera, që kur normandët të ngjiteshin me anë të shkallëve të rrëzoheshin për tokë bashkë me to[7].

Siç është konstatuar dhe në shumë kështjella Europiane, telizet për shkak të rrezikut të zjarrit, ndërtoheshin shpesh provizorisht, në raste nevoje. Por vrimat për vendosje trarësh ose konsola druri liheshin që gjatë ndërtimit të mureve të kështjellave. Ndërtimi i telizeve në Durrës në prag të sulmit të normanëve, në pjesën më të madhe të pambërthyera, tregon për karakterin provizor të tyre, Ato, siç duket, nuk kanë qenë aq të njohura në arkitekturën ushtarake bizantine ose aplikoheshin për herë të parë, sepse nuk kanë një emër dhe përshkruhen gjatë nga Ana Komnena, ndryshe nga mjetet luftarake të njohura që më parë. Durrësi, si një nga qytetet më të fortifikuara dhe më të rëndësishme bregdetare të perandorisë bizantine, mund të ketë shërbyer si një model i vlefshëm për kryqtarët përsa i përket elementeve të ndryshme të fortifikimit, ndër to dhe të telizeve. Një rast tjetër të përdorimit të telizit e hasim në Kalanë e Petrelës, në një kullë të shek. XV (fig. 2). Në nivelin e katit të dytë të kullës ruhen gjurmët e kanaleve ku kanë qenë vendosur trarët për mbajtjen e dyshemesë së telizit, të cilët dilnin në formë rrezesh nga qendra e kullës.[8] Në faqen e kullës nuk dallohen vrima ose konsola guri, që të vërtetojnë praninë e trarëve të tjerë mbështetës. Telizi ka shërbyer, njëkohësisht, dhe për të zgjeruar sipërfaqen e shfrytëzueshme të kullës në katin e sipërm, e cila ka shumë mundësi të ketë qenë e banuar. Në



Fig. 2

këtë shembull pra s'kemi të bëjmë me një teliz provizor, që montohej vetëm në raste lufte, siç mund të ketë qenë rasti i Durrësit në shek. XI. Dublimi i telizeve me mur në pjesën e brendshme kryhej dhe për të patur një mbrojtje të dytë në se telizi gjatë rrethimit do të shkatërrohej, apo do të digjej nga armiku. Shembuj të tjerë të hershëm, ku mund të provohet ekzistenca e telizit apo hurdeve nuk janë ruajtur. Ai shfaqet tepër vonë në banesat fshatare, kryesisht të Shqipërisë Qendrore, të njohura me emrin shtëpia me teliz.[9] Karakteri mbrojtës në këtë tip banese theksohet në banesat trikatëshe, të quajtura dhe «kullë». Karakteristike për të janë: ekzistenca e një kthine për çdo kat, mungesa, në përgjithësi e dritareve në katin e parë, ekzistenca e cikmave dhe frëngjive, si dhe varfëria në kthina ndihmëse.[10]

Erkeret, që ishin dalje të vogla mbi mure dhe kulla, takohen më shpesh në fortifikimet tona. Ata mund të ishin prej druri ose me mure guri. Erkeret, ashtu si dhe telizet, shfaqen në Europën Perëndimore në shek. XII dhe përhapen vetëm gjatë shek. XIII-XIV, por në disa vende ata u përhapën në një periudhë akoma më të vonë (në Gjermani rreth mesit të shek. XV, ndërsa në Zvicër vetëm në shek. XVI[11]. Në vendet e Lindjes së Mesme erkert u shfa-

6) A.R. Zuky, Interrelations and influences of Islamic Architecture on Crusader cástés, Bull. IBI, 24, 1968, f. 79.
7) Alexias, vëll. I, lib. III, 9, 10.
8) A. Baçe, Gj. Karaiskaj, **Kështjella e Petrelës,** Monumentet 5-6, f. 141.
9) A. Muka, **Arkitektura popullore e Shqipërisë së Mesme** (Banesa me teliz) Monumentet 12, 1976, f. 199-209.
10) Gj. Karaiskaj, 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, Tiranë 1981, f. 278.
11) O. Piper, vep. cit, f. 378.

qën shumë më herët dhe në shek. X qenë përhapur tepër. Në vendin tonë më të hershme janë erkeret prej druri. Prania e tyre kuptohet nga hapjet që ekzistojnë në pjesët e sipërme të kullave dhe mureve, si dhe nga vrimat për fiksimin e trarëve mbajtës të ruajtura në këto mure. Zakonisht, erkeret vendoseshin mbi kullat, për të kontrolluar pikat e vdekura të tyre, mbi portat dhe më rrallë në mure. Gjurmët e ruajtura që vërtetojnë ekzistencën e erkereve në fortifikimet shqiptare i përkasin kryesisht shek. XIV-XV. Por, prania e tyre para kësaj kohe vërtetohet nga të dhënat historike. Në vitin 1280, Karli I Anzhu, në kuadrin e punimeve për rindërtimin e Kalasë së Durrësit, dëmtuar nga tërmeti i vitit 1273, urdhëron që të pajiset muri i akropolit më 24 erkere druri[12]. Erkeret prej druri, zakonisht, mbështeteshin mbi trarë që fiksoheshin në mur ose që lidheshin me dyshemenë e katit të kullës. Vetëm në një rast kemi hetuar erker që mbështetej në konsola guri. Ky i fundit ndodhet në kalanë trekëndëshe, pranë kanalit të Vivarit në Butrint dhe shërbente për mbrojtjen e portës (fig. 3). Erkerë të tjerë qenë vendosur mbi mure, dy në murin perëndimor dhe një në murin verior. Erkeri i vendosur mbi portën e kështjellës dilte plotësisht jashtë murit dhe mbështetej mbi dy çifte konsolash guri me prerje drejtkëndëshe, por të rrumbullakosura në pjesën e poshtme të tyre. Këtë formë mbështetjeje të erkereve e hasim shpesh në fortifikimet perëndimore, nganjëherë me një profilim më të pasur. Në një gravurë të shek. XVIII që paraqet kështjellën e Beratit shihet një erker mbi një portë të shek. XIV-XV. Ai zë gjithë ballin e portës dhe është mbuluar me çati e pajisur me dritare. Sot, nuk mund të provohet nëse ky erker ka ekzistuar që në fazën fillestare të ndërtimit të portës, apo është një shtesë e mëvonshme. Me erker druri ka qenë pajisur dhe faqja ballore e një kulle drejtkëndëshe në Krujë, ndërtuar para shek. XV.

Në Kalanë e Bashtovës erkerët janë vendosur vetëm nëpër kulla. Në kullat e rrumbullakëta të qosheve (fig. 4) ato ndodhen në këndet e vdekura të tyre, që korrespondojnë me drejtimin e diagonaleve të katërkëndëshit të formuar nga muret e fortesës, ndërsa në kullat katërkëndëshe të mesit, erkeret kanë qenë ndërtuar në faqet ballore të tyre, në nivelin e bedenave. Erkerët në këtë kala, nga sa kuptohet nga shpërndarja e vrimave të trarëve, në muret e tyre, kanë patur një gjerësi prej 1,50 – 1,60 m. Në kullat e qosheve ato komunikonin me kullën nëpërmjet një hyrje me gjerësi 0,60 m, ndërsa në ku-



Fig. 3



Fig. 4

12) L. Talloczy, C. Jirecek, M. Shufflay, Acta et Diplomata Res Albaniae Aeabis, Windobonae 1918, Vol. I, dok. 410 (27 Maj 1280).

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6

llat e mesit nga ana e prapme ishin të hapura n gjithë gjerësinë e tyre. Dyshemetë e erkerëve ishi në një nivel me dyshemetë e kateve të sipërme t kullave. Në kështjellën e kuotës 59" në Durrës, ndër tuar në gjysmën e parë të shek. XV, me erker kan qenë pajisur vetëm kullat poligonale të qosheve Në pjesën e sipërme të tyre hetohen hapje me gje rësi 0,80 m, por nuk ruhen gjurmët e trarëve n mure. Erkerët prej druri fillojnë të zhduken gjat gjysmës së dytë të shek. XV dhe në shek. XVI zë vendësohen me erkere me mure guri, të cilat ndër toheshin zakonisht mbi hyrjet. Hyrjet e kështjellës s sipërme të Lezhës kanë patur erkerë guri, të cilë nuk ruhen më, por mund të shihet në dy fotografi t Ippenit (fig. 5,6)[13] Këto hyrje bashkë me një pjes të mirë të mureve të kësaj kështjelle, sipas mb shkrimit të murosur mbi harkun e saj, është rindër tuar në kohën e Sulltan Sulejmanit, në vitin 1521 – 22. Shembuj të tjerë të përdorimit të erkerëv nga kjo periudhë nuk janë ruajtur. Ato shfaqen për sëri në periudhën e Pashallëqeve të Mëdha shqip tare (shek. XVIII-XIX), më tepër për qëllime dekora tive se sa funksionale. Erkeret në muret e Kalasë s Beratit të ndërtuara nga Kurt Pasha në gjysmën dytë të shek. XVIII kanë formën e një hunde, duk patur murin ballor të pjerrët. Muret anësore mbë shteten mbi dy konsola guri të profiluara që dali 0,40 m nga parapeti, ndërsa muri ballor mbështet mbi një arkitra që peshonte mbi dy konsolat, duk lënë të lirë vrimën katërkëndëshe që shërbent për hedhje lëngjesh të nxehtë apo sendesh të rënd mbi armikun rrëzës së mureve. Erkere të këtij tipi t quajtura dhe «hu:de për katran» ndodhen dhe n Kalanë e Tepelenës, ndërtuar nga Ali Pashë Tepe lena në fillim të shek. XIX (Tab. X). Këtu, megjithë se vrimat janë lënë të lira, pengohen nga korniz dekorative e mureve, e cila ndodhet vetëm 0,30 nën to dhe projektohet 7 cm nga faqja e murit. k fakt na çon në përfundimin se këto erkere kanë qen ndërtuar më tepër për qëllime dekorative. Far qartë kjo duket në erkerin prej guri, të ndërtuc mbi hyrjen kryesore të kështjellës në Porto Palerm (fig. 7), i cili ka formën e një ballkoni të pambuluc në pjesën e sipërme e të pambyllur me mure n pjesët anësore. Erkeri, i cili komandohet nga tarrac e fortesës, nuk ka asnjë vrimë për derdhjen e lëngje ve të nxehta mbi portë dhe asnjë element tjetër q do të shërbente për mbrojtje.

Erker guri, ndërtuar mbi mure, përdoreshin dh

13) Th. Ippen, Denkmaler, verschiedener alterstufen in Albanien, WMBH Bd, X, Wien 1927, F.

DO NOT COPY



Fig. 7

si nyje sanitare për rojet. Në këto raste muri ballor i tyre nuk binte me pjerrësi duke krijuar pamjen e një hunde, por vertikalisht, ndërsa daljet jashtë mureve ishin gjysmë rrethore (Tab. X, fig. 8). Nyjet



Fig. 8



Fig. 9

sanitare mbi mure i takojmë vetëm në fortifikimet e Ali Pashë Tepelenës dhe ato mund të shërbejnë dhe si një tipar dallues për këto ndërtime mbrojtëse. Përveç Tepelenës ato i hasim dhe në kalanë në derdhje të Vivarit, ku janë ndërtuar brenda parapetit dhe nuk dalin jashtë mureve mbi konsola.

Mashikula janë quajtur radhë të pandërprerë erkerësh prej guri, që qarkonin pjesët e sipërme të kullave dhe kreshtën e mureve. Këto elemente të sjella nga kryqtarët prej Vendeve të Lindjes u dukën në Europë rreth mesit të shek. XII. Por mashikulat përmirësohen dhe përhapen gjerësisht vetëm gjatë shek. XIV. Ato vazhduan të përdoren në rezidencat e feudalëve deri në periudhën e Rilindjes. Me fillimin e përdorimit me efikacitet të artilerisë kundër mureve të qyteteve dhe kështjellave ato nuk luajnë asnjë rol mbrojtës, por megjithatë mashikulat u përdorën gjerësisht në fortesat italiane gjatë shek. XV. Në vendin tonë nuk kemi konstatuar mashikula para shek. XV dhe as gjatë shek. XV. Skënderbeu nuk i përdori në ndërtimet e tij mbrojtëse, po ashtu edhe venecianët në fortifikimet që ndërtuan në Shqipëri gjatë shek. XV. Të vetmin rast të përdorimit të tyre e konstatojmë në kështjellën e Prezës (fig. 9 (14/a). ndërtuar rreth fundit të shek. XV – fillimit të shek.

14/a) L. Papajani, **Kalaja e Prezës,** Monumentet 7-8, 1974, f. 167-181.

XVI. Mashikulat kanë qenë ndërtuar mbi harqe tullash të mbështetura mbi dy radhë konsolash guri të vendosura njëra mbi tjetrën, por nën harqe nuk ka vrima për lëshimin e lëngjeve të nxehta, gjë që tregon se ato kishin vetëm një funksion dekorativ.

Bedanat, parapetet, shtegu i rojeve dhe shkallët

Bedenat janë nga elementet më të hershme të përdorura në fortifikime. Ato kanë qenë përdorur nga babilonasit e vjetër, në muret e Trojës, gjatë periudhës së antikitetit klasik e nga romakët. Në mesjetë bedenat, shpesh, kanë forma të ndryshme në kohë e sidomos në vende të ndryshme[14]. Por principi ka qenë i njëjtë, masa murore në lartësinë e njeriut që shërbenin si mburoja për mbrojtësit dhe intervale boshe për të lejuar qitjen me shigjetë kundër armikut që sulmonte. Raporti midis lartësisë dhe gjerësisë së bedenave apo midis gjerësisë së bedenave dhe hapësirave midis tyre në përgjithësi nuk ndjek një rregull të caktuar në kohë. Proporcionet varen nga shprehitë dhe traditat e ndërtuesve, kështu që në këtë drejtim mund të bëjmë vetëm ndonjë dallim të vogël. Në Italinë e Veriut (Piemont) është vënë re, pa qenë një rregull i përgjithshëm, se hapësirat midis bedenave qenë rregulluar në bazë të pozicionit të kështjellës. Në kështjellat e ndërtuara në vende të sheshta bedenat ishin më të larta e më të gjëra, nga ato të lartësi, ndërsa hapësirat midis tyre ndiqnin rregullin e kundërt[15]. Në fillim të shek. XIII bedenat u përshkruan nga frëngji[16]. Me përdorimin në stil të gjerë të artilerisë, në gjysmën e dytë të shek. XV, bedenat u bënë të panevojshme e u përdorën më tej vetëm për qëllime dekorative. Në të vërtetë kështjellat italiane për artileri, që u ndërtuan në gjysmën e dytë të shek. XV, ishni pa bedena. Bedenat u zëvendësuan nga parapeti me frëngji, i cili filloi të shfaqet në pjesë të veçanta të kështjellave që nga fundi i shek. XIII, por u fut në përdorim të gjerë vetëm gjatë shek. XIV[17]. Në mesjetë ka patur dhe kështjella ku nuk janë përdorur bedenat, siç është hetuar në shumë kështjella normande dhe angleze, lartësia e mureve të të cilave ofronte një farë sigurie kundrejt armiqve të dobët lokalë.[18]

Në fortifikimet shqiptare bedenat janë përdorur gjerësisht. Ato u zëvendësuan, përfundimisht nga parapetet me frëngji, vetëm në periudhën e Pashallëqeve të Mëdha shqiptare (shek. XVIII-XIX). Muri i bedenave ka patur një lartësi 75 – 80 cm dhe trashësi rreth 60 cm, ndërsa gjerësia dhe lartësia e bedenave ndryshon në fortifikime të ndryshme. Me gjithë lartësinë e murit të tyre bedenat duhet të arrinin lartësinë e trupit të njeriut, por ka raste kur ata nuk arrijnë lartësinë e një shtati mesatar ose kur e kalojnë atë në mënyrë të dukshme. Çka bie në sy në fortifikimet shqiptare është proporcionaliteti midis hapësirave boshe dhe bedenave. Nuk takohen bedena të gjëra, me hapësira të ngushta midis tyre, pararendëset e të cilave i takojmë në fortifikimet e lindjes së mesme (si në citatelen e Damaskut apo kështjellën e Davidit në Jeruzalem)[19], por që kanë qenë përhapur nga urdhërat ushtarake në Rodi dhe që hasen dhe në ndonjë kështjellë italiane, si ajo e Rocelës[20]. Po kështu mund të themi se s'kemi hasur në asnjë rast bedena të tipit bishtdallëndyshe, të ashtuquajtu-



Fig. 10

14) Për tipat e bedenave shih «Zërin Zinne» në Der grosse Brockhaus» Leipzig 1935, vëll. 20, f. 648.
15) C. Nigra, Castelli della valle d'Aosta, Aosta 1974, f. 11.
16) A. Chatelain, vep. cit, f. 95-96.
17) S. Roy, vep. cit.
18) A.C. Ramelli, vep. cit, f. 254.
19) C. Schuchardt, Die Burg im Wandel der Weltgeschichte, Frankfurt am Main, 1981 (sipas bot. të vitit 1931, f. 271, fig. 267-268).
20) A. C. Ramelli, Dallez cavrne..., f. 250-251.

DOMOTCOPY



Fig. 11



Fig. 12

ra gibeline, të cilat janë të përhapura jo vetëm në Vendet Perëndimore, por edhe në Greqi, në Argolis, Nauplia, Naupaktos, Rodos etj,[21] në periudhën e pushtimit frank. Nga format e ndryshme të bedenave, disa prej të cilave kanë një origjinë shumë të lashtë, është parapëlqyer forma katërkëndëshe, tipike për antikitetin ilir, periudhën romake dhe të antikitetit të vonë, por që gjithashtu ka qenë forma më e përhapur në mesjetë.[22] Në pjesën e sipërme bedenat mund të ishin të rrafshëta ose përfundonin me një mbulesë në formë çatie, të veshur me tulla (Bashtovë) ose me tjegulla (Durrës) (fig. 10). Megjithëse, ashtu siç kemi përmendur dhe më parë, përmasat e bedenave dhe të hapësirave midis tyre nuk sjellin ndonjë të dhënë të vlefshme për një renditje kronologjike, vërehen disa prirje që nuk mund të merren si një rregull i përgjithshëm. Vihet re se pas shek. XV, me pushtimin osman, lartësia e bedenave rritet. Në Bashtovë pas pushtimit turk lartësia e bedenave u rrit duke arritur në 1,90 m. Në Shkodër, bedenat e periudhës turke (fig. 11) janë më të larta se ato veneciane (fig. 12), Në Durrës, ndërsa bedenat e kështjellës në lartësinë 59 m janë të gjera dhe të ulëta, ato të murit që i mbështetet kësaj kështjelle, ndërtuar në vitin 1502, janë të ngushta dhe të larta (fig. 10). Por që kjo dukuri nuk mund të merret si një rregull apsolut e tregon fakti se në Berat, bedena të shpuara nga frëngji, të cilat datohen me shumë gjasë në periudhën e hershme të pushtimit turk, janë më të gjera se të larta.

Në vendin tonë bedenat u përshkuan nga frëngji në një periudhë të vonë, në krahasim me fortifikimet e Europës Perëndimore e për më tepër kjo dukuri nuk u kthye në një rregull të përgjithshëm. Bedenat e përshkuara nga frëngji shigjete u dukën vetëm në shek. XV në: Kalanë e Bashtovës, Beratit, Shkodrës (fig. 12), etj. Në disa kala të rindërtuara nga turqit në gjysmën e dytë të shek. XV ose në fillim të shek. XVI, bedenat nuk u pajisën me frëngji. Të tilla janë: Kalaja e Elbasanit, Peqinit, muri turk i vitit 1502 në Durrës, ku vetëm bedenat pranë hyrjes kanë qenë përshkuar nga frëngji etj. Ndryshe ndodh me rindërtimet e bëra më vonë në murin jugperëndimor të Kalasë së Durrësit, ku hapja e frëngjive në bedena bëhet një rregull i përgjithshëm, madje këto të fundit janë të ulëta dhe të gjëra dhe nganjëherë të bashkuara në çifte. Parapetet me frëngji, siç kemi përmendur më lart, përfundimisht i zëvendësuan muret e dhëmbëzuara nga bedenat gjatë shek. XVIII, por nuk mungojnë shembuj më të hershëm, që bashkëjetuan me këta të fundit. Ata u bënë të domosdoshëm në periudhën e përdorimit në stil të gjerë të artilerisë me barut, pra nga mesi i shek. XV. Parapetin më të hershëm, datuar në vitin

21) L. Benakis, Die Mittelalterliche Festung von Thermisi/Argolis, Actes, VIII Reunion, scientifique, IBI, Athenes 1968, f. 55.

22) Bedena të rrumbullakëta, me origjinë të lashtë egjyptiane, janë përdorur deri në shek. XVII në kështjellën turke të Karababasë në Greqi, D.A. Zivas, The turkish fortress..., f. 147-156.

DO NOT COPY

DOKTORATURA

1407-1416, e takojmë në paramuret e Kalasë së Shkodrës[23]. Me parapet të përshkuar nga frëngji ka qenë pajisur dhe faza e parë e kështjellës trekëndëshe pranë kanalit të Vivarit në Butrint, e cila datohet në shek. XV. Kështjella e Lëkursit në Sarandë, që me shumë gjasë i takon periudhës së Sulltan Sulejmanit (gjysma e parë e shek. XVI), është pajisur gjithashtu me një parapet me frëngji. Ne nuk dimë se si përfundonin kreshtat e mureve dhe kullave të ndërtuara nga Skënderbeu në mesin e shek. XV e më vonë, sepse nuk janë ruajtur gjurmë bedenash apo parapetesh. Deri në fillim të shek. XVIII shumë fortifikime ishin me bedena, këtë e vërteton fakti, se në disa nga këto fortifikime, vetëm në periudhën e pashallëqeve hapësirat midis bedenave u mbyllën me mure. Si shembull mund të sjellim Kështjellën e Peqinit, ku frëngjitë që përshkonin parapetin u hapën në murin e ri, që zinte hapësirat midis bedenave. Muri i parapetit u ngrit mbi lartësinë e bedenave, poi. në nivelin e sipërm të tyre, përfundonte me kornizën dekorative, karakteristike për periudhën e pashallëqeve. Në Kalanë e Beratit, në periudhën e Kurt Pashës, jo vetëm që u mbyllën të gjitha hapësirat midis bedenave, por këto të fundit u murosën me gjithë frëngjitë e tyre. Muri u lartësua mbi nivelin e sipërm të bedenave dhe u pajis në intervale të caktuara me erkere guri. Në kalatë e rindërtuara, apo të ndërtuara rishtazi nga Ali pashë Tepelena në shek. XVIII-XIX, kullat dhe muret janë pajisur me parapete, të cilat alternojnë frëngjitë e topave me ato të pushkëve. Parapetet në anën e jashtme kufizohen nga muret e pjerrëta të fortifikimit prej një kornize dekorative guri me prerje drejtkëndëshe. Në periudhën e vonë të pashallëqeve, parapetet me frëngji ishin pajisur dhe me dritare vrojtimi, të cilat hapeshin ritmikisht pas një numri të caktuar frëngjish. Parapete të tilla i takojmë në Kalanë e Shkodrës dhe në Kalanë e Tiranës, ndërtime të fundit të shek. XVIII fillimit të shek. XIX. Në kështjellën në derdhje të kanalit të Vivarit, ndërtuar nga Ali Pasha në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XIX, dritaret e vrojtimit janë të rrumbullakëta dhe ndodhen në skajet e kurtinave.

Shtegu i rojeve shërbente për të lehtësuar lëvizjen e mbrojtësve në nivelin e bedenave, ndërsa në kohë paqe në të qarkullonin rojet. Gjerësia e shtegut të rojeve kushtëzohet nga trashësia e mureve të fortifikimeve, duke qenë më i ngushtë se këta të fundit 50 – 60 cm, masë që i përgjigjet gjerësisë së murit të bedenave. Në muret e gjerë shtegu i rojeve ndërtohej brenda trashësisë, ndërsa në muret me gjerësi rreth 1 m, ai formohej nga një sistem pilastrash që projektoheshin nga ana e brendshme e mureve dhe mbylleshin në pjesën e sipërme me qemere tullash apo guri. Kur muret e fortifikimit ishin të holla, shtegu i rojeve mund të ishte dhe prej druri. Në Kalanë e Drishtit janë ruajtur vrimat e vendosjes së trarëve horizontalë, pikërisht në nivelin e poshtëm të murit të bedenave, i cili kishte të njëjtën trashësi me këta të fundit. Mbi këta trarë mbërtheheshin dërrasat që formonin shtegun e rojeve. Në intervale të caktuara duhet të kishte trarë vertikalë, që shkonin deri poshtë në tokë, të cilët mbanin peshën e platformave dhe të luftëtarëve, pasi në mure nuk dallohen gjurmë të tjera që do të shërbenin për vendosjen e mbështetëseve të pjerrëta. Kështu duhet të kenë qenë ndërtuar shtigjet e rojeve në fortifikime të mesjetës së hershme në Shqipërinë e Veriut si në Shurdhah (Sarda), Danjë, etj. Por rastet më të shumta janë ato kur shtegu i rojeve është ndërtuar mbi trashësinë e murit, ndërsa më të rrallat kur, ky i fundit, formohet nga një sistem pilastrash dhe qemerësh. Një shembull të hershëm të zgjidhjes së fundit e hasim në një mur të Butrintit, që datohet në shek. IX – XI. Qemeret mbi të cilët formohej shtegu i rojeve kanë qenë ndërtuar me tulla. Në një periudhë të mëvonshme hapësirat midis pilastrave u mbushën me mure, duke rritur në këtë mënyrë trashësinë e murit të vjetër.[24] Një rast tjetër, ku shtegu i rojeve formohej nga një sistem pilastrash e qemeresh, e hasim në Kështjellën e Bashtovës (shek. XV). Këtu janë përdorur dhe platformat prej druri, të cilat shërbenin për të krijuar një nivel të dytë luftimi në hapësirat midis pilastrave ku kishte dy radhë frëngjish. Shtigjet e rojeve të ndërtuara mbi sisteme pilastrash e qemeresh kanë qenë përdorur në fortifikimet e Justinianit në shek. VI të e.s., por në vendin tonë nuk kemi hasur asnjë rast. Kjo mënyrë ndërtimi vazhdoi të aplikohet dhe në fortifikimet e mëvonshme bizantine si dhe në Europën Perëndimore e Qëndrore.

Shkallët shërbenin për lehtësimin e furnizimit me ushtarë, në raste nevoje, të kurtinave dhe kullave. Përgjithësisht, shkallët që shërbenin për të furnizuar shtegun e rojeve mbi mure ishin prej guri. Shkallë druri kishte vetëm në kurtinat me trashësi të vogël

23) Gj. Karaiskaj, Die Anfange des Festungsbaus in Albanien, (15 bis 16 Jahrhundert) «Schrieftemreiche, Festungsforschung, Bd, 8, Witten 1988, f. 178

24) Gj. Karaiskaj, Butrinti dhe fortifikimet e tij, Tiranë 1984, Tab. XXXV, f. 79, 92.

muresh, në të cilat dhe shtegu i rojeve ishte prej druri. Vendosja e tyre përgjatë mureve nuk kishte ndonjë rregull të përcaktuar qartë, por ato ishin më të dendura në pjesët më të rëndësishme të kurtinave, apo pranë kullave dhe hyrjeve. Ka raste kur shkallët vendosen në një apo në dy anët e një kulle, e cila mund të shërbente dhe si kullë hyrje dhe drejtoheshin dhe nga vetë kulla apo largoheshin prej saj. Në rastin e dytë u jepej përparësi kurtinave në të dy anët e kullës apo të vetë hyrjes. Për furnizimin e kurtinave përveç shkallëve të veçanta, takohen dhe shkallë dyshe, të cilat vendosen në mesin e kurtinës, me drejtim të kundërt, duke formuar në pamje shkronjën V (Sopot, Peqin). Në Kalanë e Shkodrës ndeshemi në një shkallë të gjerë, të vendosur pingul murit rrethues, (fig. 12), e cila duke patur si synim kryesor furnizimin me luftëtarë të platformës së një kulle, mund të kryente njëkohësisht të njëjtin shërbim për dy kurtinat në anët e saj. Shkallët mund të ndërtoheshin brenda trashësisë së murit rrethues (Ishëm), pjesërisht brenda trashësisë së tij (Elbasan, Prezë) si dhe jashtë trashësisë së murit (Kepi i Rodonit etj). Kur shkallët ndërtohen brenda trashësisë së murit, një pjesë e tij, në vendin e ndërtimit të tyre dobësohet nga hollimi që pëson muri në masën e gjerësisë së shkallëve. Por më tepër në dobësimin e murit ndikojnë shkallët dyshe në formë V-je të cilat për këtë arsye janë të rralla. Në fortifikime të llogaritura për t'i përballuar goditjeve të artilerisë si p.sh. në Kepin e Rodonit, shkallët ndërtohen zakonisht jashtë trashësisë së murit. Por ky nuk mund të shërbejë si një rregull i përgjithshëm, pasi në ndërtime mbrojtëse të vona, që i përkasin periudhës së përdorimit të artilerisë me barut, i hasim të dyja variantet. Shkallët që shërbenin për komunikimin midis kateve të një kulle zakonisht ishin prej druri. Rrallë takojmë shkallë guri, të cilat ndërtoheshin brenda trashësisë së murit të pasëm të kullës, për të mos dobësuar muret e tjera të ekspozuara ndaj sulmit. Këto lloje shkallësh i takojmë në fortifikime pas shek. XV (Durrës 1502).

Një variant tjetër i shkallëve, brenda trashësisë së murit, është ai kur këto, për të mos dobësuar krejt murin që ngrihej mbi to, ndërtoheshin brenda një galerie të mbuluar me qemer cilindrik, si p.sh. në një kullë të shek. XV në Durrës.

Shkallët që lidhin katet në kulla, si ato prej guri dhe ato prej druri, janë të drejta, si në Vendet e Lindjes, ndërsa nuk hetohen shkallë spirale mjaft të përhapura në vendet e Europës Perëndimore.

Oxhakë dhe dritare

Oxhakët filluan të përdoren vetëm atëhere kur kullat u kthyen në të banueshme për garnizonin. Në kullat e fortifikimeve të periudhës bizantine nuk kemi gjetur shenja të ndezjes së zjarrit, që të dëshmojnë përdorimin e tyre për banim. Ato filluan të përdoren pjesërisht për strehimin e garnizonit vetëm pas pushtimit turk, në ndonjë rast dhe në ndonjë kështjellë veneciane të së njëjtës periudhës, d.m.th. jo më herët se mesit i shek. XV. Në Europën Perëndimore vendet e ndezjes së zjarrit të shek. XI formoheshin nga një hapje e thjeshtë në mur, me kurriz gjysmë rrethor, ku tymtarët pasi ngriheshin përpjetë në një distancë të shkurtër brenda murit, kalonin nëpër faqen e jashtme të tij dhe përfundonin me një ose dy frëngji. Me kohë plani gjysmë rrethor i le vendin atij drejtkëndësh dhe nga fundi i shek. XII tymtarët kalojnë deri në majë të murit, ku përfundojnë me një grykë.[25] Në arkitekturën osmane oxhakët më të vjetër i takojnë shek. XV. Në xhaminë Jeshile dhe të Sulltan Selimit në Bursë, ato kanë



Fig. 13

25) S. Toy, vep. cit,

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15

qenë me tambur, me dekore allçiu e të shoqëruara nga dy nike anësore.[26] Shembullin më të vjetër të përdorimit të një oxhaku në vendin tonë e hasim në kështjellën trekëndëshe pranë kanalit të Vivarit në Butrint. Kullat e kësaj kështjelle, e cila datohet rreth fundit të shek. XV – fillimi i shekullit XVI[27], katin e parë e kanë patur të banuar, ndërsa kati përdhes shërbente për vendosjen e një baterie prej 5 topash. Kati I, i cili ndahej nga ai përdhes nga një dysheme druri, ishte pajisur me një oxhak, tri dritare të mëdha, si dhe 6 frëngji shigjete. Oxhaku ka një seksion gjysmë rrethor me diametër 1,2 m (fig. 13). Seksioni i tij ngushtohet vetëm në pjesën e sipërme të murit ku arrin gjerësinë 0,38 m. Paturat e oxhakut janë ndërtuar me tulla që formojnë një kornizë me gjerësi 0,2 m. Nuk ruhen gjurmë për të vërtetuar ekzistencën e një tamburi. Më e mundshme është, që si oxhaku ashtu dhe tymtari, të kenë qenë të hapura nga pjesa e brendshme e mjedisit. Një oxhak tjetër të hershëm (me prerje gjysë rrethore) e takojmë në kështjellën katërkëndëshe mbi kuotën 59 në Durrës. Ai ndodhet në katin e sipërm të njërës nga kullat poligonale të këndit, që është rindërtuar në pjesën e sipërme në shek. XVI, ndoshta në vitin 1502, kur turqit nëpërmjet ndërtimit të një muri të ri, zvogëluan sipërfaqen e mbrojtur të qytetit. Nga oxhaku janë ruajtur pjesa e poshtme, si dhe shenja të një harkimi në të dy paturat e tij, të cilat tregojnë se ai ka qenë i mbyllur me një hark apo qemer cilindrik. Nga tymtari nuk ruhet asnjë shenjë, pra mund të kemi të bëjmë dhe me një nike të thjeshtë për ndezjen e zjarrit. Në të dy anët e oxhakut nuk konstatuam kamare. Në Bashtovë, pas pushtimit të kështjellës nga turqit, disa nga kullat, u kthyen në të banueshme për garnizonin. Punime të tjera duke përfshirë dhe ndërtimin e një xhamie mbi hyrjen kryesore qenë përfunduar deri në vitin 1521. Oxhakë janë ruajtur në katet e sipërme në dy nga kullat. Ato janë të njëkohshëm, të një tipi dhe formohen nga tymtari me prerje drejtkëndëshe, i ndërtuar në hapësirat që shërbenin më parë për ekreret, si dhe nga pjesa e poshtme që ka formën e një dritareje të mbuluar me një hark rrethor tullash (fig. 14). Në njërën nga kullat, në të dyja anët e oxhakut, ndodhen kamare drejtkëndëshe, ndërsa në tjetrën, në vend të tyre, dy frëngji të vogla. Një tip tjetër oxhaku e hasim në Kalanë e Këlcyrës, në kështjellën që zë

DO NOT COPY

26) S.H. Eldem, Turk evi osmanli donemi, vol. III, Istambul 1987, f. 66.
27) Gj. Karaiskaj, Rreth problemit të datimit të kështjellës trekëndëshe pranë kanalit të Vivarit në Butrint (Sesion shkencor në Sarandë Prill 1988).

pjesën më të lartë të kodrës. Kjo e fundit është pajisur me dhomza të vogla drejtkëndëshe për strehimin e garnizonit, të cilat i mbështeten mureve rrethuese. Secila nga dhomat është pajisur me një oxhak (Tab. IX, 2). Oxhaku ka seksion katërkëndësh (40 x 55 cm) pa tambur. Hapja e oxhakut ka një lartësi prej 2 m dhe mbulohet me arkitra druri. Mbi arkitra është ndërtuar një mur perde me trashësi 20 cm, duke lënë të njëjtën thellësi për vrimën e daljes së tymit. Pranë oxhakut, por jo në të njëjtin mur, ndodhet një kamare me përmasa 36 x 50 cm, në lartësi 1 m nga toka. Oxhakë të formave të ndryshme takohen në fortifikime të Ali pashë Tepelenës në: Tepelenë (Tab. IX), Gjirokastër (fig. 15), Porto Palermo (ifg. 16) etj. Ato kanë seksion drejtkëndësh. Në disa raste tymtarin e gjejmë të hapur në të gjithë lartësinë, ndërsa në raste të tjera e hapur është vetëm pjesa e oxhakut, e cila përfundon në formë trekëndëshi në pjesën e sipërme (fig. 15). Zakonisht tymtarët përshkojnë vertikalisht të gjithë lartësinë e murit duke dalë në çati, por në raste të veçanta ao arrijnë deri tek thembra e qemerit të mbulesës dhe e përshkojnë atë pjerrëtas, duke përfunduar nën çati në formën e një frëngjie (Tepelenë Tab. IX). Vlen të përmendim se në banesat tona, deri sot nuk janë konstatuar oxhakë me tymtarë më të hershëm se shek. XVII – XVIII. Para kësaj periudhe në vend të tyre ekzistonte një nike e thjeshtë, hapur në njërën nga muret e dhomës, e cila shërbente për ndezjen e zjarrit. Nike të tilla në fshatin rrënojë të Kamenicës, në Drisht etj u përkasin banesa që nga shek. XIV – XV. Nga ana tjetër ndryshe nga ato të fortifikimeve, oxhakëve të banesave të shek. XVIII – XIX asnjëherë nuk u mungojnë dy kamaret anash tyre.[28] Por në banesa, megjithëse relativisht të vona, hasim dhe forma të vjetra të oxhakëve, ku tymtarët nuk përfundojnë mbi çati, por dalin diku në sipërfaqen e muraturës.[29] Jo të gjitha format e oxhakëve të fortifikimeve shqiptare të studiuara më sipër, i hasim në banesa. Prej tyre takojmë ato, të cilat përfundojnë në krye me majë të mprehtë, por nuk janë karakteristike të hapurat që mbyllen me hark rrethor apo me arkitra guri. Nga sa kemi vënë re deri tani mund të nxjerrim përfundimin se format e ndryshme të oxhakëve nuk kanë ndonjë vlerë të sigurtë kronologjike. I rëndësishëm është fakti se ato fillojnë të shfaqen në një periudhë të caktuar, e cila nuk shkon më herët se fundi i shek. XV – fillimi i shek. XVI. dhe si të tilla



Fig. 16

Fig. 17



28) E. Riza, Qyteti muze i Gjirokastrës, Tiranë 1981, f. 168.
29) Po aty, f. 168.

DO NOT COPY

mund të shërbejnë, sipas rastit, për të dalluar këtë periudhë ndërtimesh mbrojtëse nga ato më të hershmet. Nga ana tjetër vihet re se oxhakët më të vjetër kanë përmasa më të mëdha (rreth 1,20 ml) dhe mbizotëron forma e rrumbullakët.

Dritaret (Tab. VIII) janë një element tjetër që shfaqen në fortifikimet tona dhe lidhen, si dhe oxhakët, kryesisht me mjedise që shërbenin dhe për banim. Në ndërtesa që shërbenin thjeshtë për banim nuk janë ruajtur dritare të një periudhe të hershme. Dritaret i takojmë kryesisht në kulla dhe vetëm në periudha të vona në ndërtesa të cilat shërbenin për strehimin e garnizonit. Hapësira e dritës së tyre duhet të ishte e vogël, për të mos u bërë burim rreziku nga predhat e armikut. Për të njëjtën arsye ato ndodheshin në pjesët e sipërme të mureve të kateve. Për një shpërndarje më uniforme të dritës ato kishin zakonisht, pragje dhe shpatulla të pjerrëta nga ana e brendshme. Kur dritaret nuk kanë pragje të pjerrët është vështirë t'i dallosh nga frëngjitë. Në këtë rast vetëm pozicioni i tyre në lartësi mund të përcaktojë praninë e tyre. Në disa kulla të hershme të pajisura me frëngji, këto të fundit shërbenin dhe si dritare. Dy dritaret, në kullën e hyrjes së rrethimit të jashtëm të Petrelës, nuk dallohen nga frëngjitë e zakonshme, vetëm se ndodhen në pjesën e sipërme të murit të kullës (Tab. VI, 3, fig. 17). Ato kanë në prerje formën e një trapezi me bazën e vogël nga jashtë, nuk kanë prag të pjerrët nga brenda dhe në pjesën e sipërme përfundojnë me një hark rrethor tullash. Këto dritare të njëkohshme me hyrjen duhet të jenë ndërtuar rreth shek. XII – XIII. Një dritare në formë frëngjie e hasim dhe në një kullë të gjysmës së parë të shek. XV në Durrës. Ajo do të mund të konsiderohej si frëngji në qoftë se nuk do të ndodhej në pjesën e sipërme të murit të kullës. Ashtu si dhe frëngjitë e topave, të vendosura paksa mbi nivelin e dyshemesë së katit, ajo është e mbuluar me një qemer trung konik tullash në pjesën e brendshme, i cili vjen duke u zgjeruar nga të dy anët dhe nuk ka prag të pjerrët.

Dritarja që ndriçon mjedisin e hyrjes në kështjellë në Kalanë e Petrelës, e fazës së shek. XV, është vendosur mbi harkun e portës. Ajo shfaqet nga jashtë në formën e një frëngjie, por duke ruajtur të njëjtën lartësi. Pasi përshkon, deri në një farë vendi, horizontalisht trashësinë e murit kthen poshtë, nga brenda, duke formuar një prag të pjerrët. Kjo kthesë brenda trashësisë së murit eleminon depërtimin e predhave të armikut në mjedisin e hyrjes dhe drejton ndriçimin për tek shkallët e këtij mjedisi. Një dritare të ngjashme me atë të hyrjes në kështjellën e Petrelës e takojmë në Shkodër, në katin përdhes të një ndërtese, e cila me sa duket ka shërbyer si burg dhe datohet rreth fundit të shek. XV (fillimi i shek. XVI (Tab. VIII, 3). Dritarja nga jashtë ka formën e një frëngjie të vendosur horizontalisht, me gjerësi 0,24 m dhe lartësi 0,14 m, por drita futet



Fig. 18



Fig. 19

PHOTOCOPY

vetëm nëpërmjet një të çare 8 cm të lartë, që ka gjerësi të njëjtë me atë të frëgjisë nga jashtë. Kjo e çarë është hapur në pjesën e poshtme të frëngjisë, në një thellësi 0,43 m nga faqja e jashtme e murit. Që këtej në drejtim të brendisë së ndërtesës fillon një prag i pjerrët duke e rritur kështu lartësinë e dritares në 0,30 m. Dritarja ndodhet në pjesën e sipërme të murit të mjedisit, madje ajo përshkon pjesën anësore të qemerit të mbulesës, në afërsi të thembrës së tij. Nga dritare të tilla, të ngushta, futej vetëm pak dritë në kthinat e ndryshme të këtij mjedisi dhe nga ana tjetër ato i përgjigjeshin funksionit të tij, si burg, për të patur një komunikim sa më të paktë me mjedisin e jashtëm. Dritare në formë frëngjie, por me prag të pjerrur nga ana e brendshme, janë hetuar dhe në Kalanë e Elbasanit, në fazën ndërtimore të vitit 1466. Në njërën nga kullat e këndit të kësaj kalaje, nga pastrimet, u zbuluan tri dritare që shërbenin për ndriçimin e shkallëve, si dhe katin përdhes. Nga jashtë dritaret kanë një gjerësi prej 17 – 20 cm dhe lartësi 1,17 cm, ndërsa nga brenda zgjerohen në 90 – 100 cm. Ato mbulohen me arkitra druri dhe kanë prag të pjerrët për të realizuar një shpërndarje më të mirë të dritës.

Nga fundi i shek. XV – fillimi i shek. XVI shfaqen dhe dritare të mëdha, si për ndriçimin e ndërtesave ndihmëse brenda kalave, ashtu edhe në ndonjë kullë që shërbente njëkohësisht për strehimin e garnizonit. Dritaret e arsenalit të Kalasë së Shkodrës, njohur me emrin «Kapiteneria», ndërtuar rreth fundit të shek. XV, janë pajisur me kangjella hekuri. Gjurmë të mbërthimit të kangjellave hetohen në shpatullat prej guri dhe tek dritaret e mjedisit të rojeve, të ndërtuara në periudhën e pushtimit turk, mbi hyrjen kryesore të kalasë së Shkodrës (fig. 18). Tek kullat e banuara, dritare të mëdha për ndriçim hasim në një nga kullat e kështjellës trekëndëshe në Butrint, ku këto të fundit mbulohen me qemere të shtrira prej tullash dhe kanë një hapësirë të madhe drite (fig. 19). Ky fakt të shtyn për një datim të vonë të kësaj kulle rreth fundit të shek. XV – gjysma e parë e shek. XVI, megjithëse elemente të tjera qëndrojnë fare mirë në shek. XV. Në fortifikimet e vona, të shek. XVIII-XIX, sidomos në ato të ndërtuara nga Ali pashë Tepelena, dritaret e mëdha për ndriçimin e mjediseve të garnizoneve bëhen të zakonshme, madje ato përshkojnë dhe muret e jashtme të fortifikimeve si në: Gjirokastër, Tepelenë, Porto Palermo etj. Në këtë kohë gjejnë përdorim të gjerë edhe baxhat për ndriçim, të cilat hapeshin në kyçin e qemereve të mbulesës ose në muret anësore të tij. Këto të fundit e futnin dritën nëpërmjet një pragu të pjerrët që fillonte në kreun e murit. Vlen të përmendim disa dritare në Kalanë e Tepelenës, të cilat nën pragun e tyre kanë një të çarë vertikale në formë frëngjie me përmasa 30 x 6 cm, e cila përshkon pjerrëtas murin nën dritare dhe shërbente për derdhjen e ujërave, pa qenë nevoja të hapej kanati i dritares.

Nga materiali i mësipërm mund të nxjerrim përfundimin se dritaret e hershme në kalatë shqiptare kanë qenë në formë frëngjie dhe pa prag të pjerrët. Në shek XV gjen përdorim pragu i pjerrët dhe nga fundi i këtij shekulli e sidomos gjatë shek. XVI shfaqen dritaret e mëdha.

DO NOT COPY

Tab. 1

PEQIN



a



b

0 1 2 3 4m



0 1 2 3m

c



d

0 1 2 3 4 5m

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tab. II





1 KARDHIQ
2 BERAT
3 BERAT





1



2



3

Tab. III



DO NOT COPY

Tab. IV



DO NOT COPY

DO NOT COPY

Tab. V









LEZHE

DO NOT COPY

Tab. VI.







2.





3



4

1 BUTRINT
2 TEPELENE
3 PETRELE
4 SHURDHAH

Tab VII



BUTRINT













DO NOT COPY

Tab VIII









1 TEPELENE
2 TEPELENE
3 SHKODER
4 KELCYRE

DO NOT COPY

Tab. IX

DO NOT COPY

1 DRAGOT
2 KELCYRE
3 TEPELENE







Tab. X

TEPELENE















DO NOT COPY

Gjerak KARAISKAJ

LES ÉLÉMENTS ARCHITECTONIQUES DES FORTIFICATIONS MÉDIÉVALES ALBANAISES ET LEUR PLACE DANS L'ARCHITECTURE MILITAIRE

RESUME

Les éléments architectoniques conservés jusqu'à nos jours dans les forteresses médiévales méritent une attention particulière en ce qui concerne leur étude et leur conservation. A part leur fonction comme éléments de datation ils servent à suivre l'évolution, l'appui sur l'ancienne tradition ou les influences réciproques dans ce domaine entre les cultures voisines ou celles plus lointaines. Dans cette étude nous avons essayé de mettre en évidence le petit nombre d'éléments conservés parmi les ruines des fortifications médiévales, la définition de la destination et de la morphologie desquels présente une importance particulière aux travaux de restaurations futures surtout quand les complexes de constructions où ils se trouvent nous sont parvenus assez endommagés.

Meurtrières pour le tir au fusil et archères

Les meurtrières pour le tir au fusil et les archères sont les éléments les plus conservateurs dans les fortifications médiévales. Ainsi, il est donc difficile et quelques fois impossible de distinguer une meurtrière d'une période d'une meurtrière d'une autre période, une archère d'une meurtrière pour le tir au fusil.

Les archères ont été très hautes, de 3 à 5 m, et elles ont dû apparaître premièrement en Angleterre et en Moyen Orient vers la fin du XIIe sc. Les plus anciennes archères en Albanie sont celles de Butrint pratiquées dans un mur flanqué de tours triangulaires, qui remonte à la plus haute période médiévale de la ville (IXe-X^e sc). Un autre ancien exemple se trouve à l'enceinte intérieure de la ville médiévale de Sarda (Shurdhahu) (tab. VI, 4) qui d'après les fouilles archéologiques et les conditions historiques, date des dernières décennies du XIIe sc. Dans les deux cas les archères ne sont pas très hautes (0,45-0,60 m) et nous rappellent les modèles de la période antique.

Des deux exemples déjà mentionnées il ressort que les archères à la période de temps entre le IX et le XII sc n'étaient pas très fréquentes et se pratiquaient seulement aux courtines.

Pratiquées aux tours, elles connurent un large emploi seulement au cours du XIIIe sc (tab. VI, 1). Ces archères sont d'une hauteur de 0,60 à 1 m et d'une largeur de la fente verticale qui occupe toute la hauteur de la meurtrière de 10 à 15 cm. Leur couverture et leur appui sont plats. La couverture est formée d'architraves en bois ou de dalles de pierre.

Les meurtrières en couverture et appui plats, avec une fente verticale qui occupe toute la hauteur de la meurtrière apparaissent dans une série de fortifications des XVe-XVIe sc. Elles percent les merlons ou l'épaisseur des murs des tours et des courtines (Bashtovë, Durrës, Shkodër, Lezha etc). (Tab. V 5). Elles sont d'une hauteur de 50 à 70 cm et d'une largeur de la fente verticale de 10 à 15 cm. Les meurtrières à couverture plate sont utilisées tout le temps mais dans celles dernières, la fente verticale devient de plus en plus étroite (4 à 7 cm) et dans la plupart des cas n'occupe plus toute la hauteur de la meurtrière. Dans le cas où l'appui doit être en talus, la couverture est réalisée en échelons successifs afin de créer une ligne parallèle à l'appui. Ces meurtrières remontent aux XVIIIe-XIX sc. (Tab. III). Les nombreuses exceptions au type des meurtrières déjà mentionnées rendent difficile l'établissement d'une chronologie sur la base de leur évolution, mais de ce groupe on peut écarter les meurtrières qui sont typiques pour les périodes tardives telles celles à une étroite fente verticale (d'environ 4 cm) assez courte par rapport à toute la hauteur de la meurtrière.

Les meurtrières en couverture en dalle de pierre en forme de toit, apparurent tard et disparurent tôt. Elles sont caractéristiques pour la période de l'occupation turque après le XVe sc mais malgré cela, un exemple plus ancien de ce type de meurtrière se rencontre à la forteresse triangulaire près du canal de Vivar à Butrint (Tab. VII). Ces meurtrières appartiennent à la fin du XIVe sc. L'évolution des meurtrières en forme de toit suit le même chemin que celui des meurtrières à couverture plate, il consiste essentiellement à la diminution de la hauteur de la fente verticale par rapport à la hauteur de la meurtrière.

Les meurtrières à couverture en forme de toit sont généralement plus hautes que celles des périodes postérieures. Leur hauteur varie de 0,50 à 0,80 m. Quand elles sont pratiquées en hauteur l'appui est un talus vers l'extérieur. Elles cohabitent avec d'autres types de meurtrières surtout celles à couverture plate mais jamais avec des meurtrières typiques pour les périodes postérieures telles celles qui appartiennent à l'époque des grands pachaliks albanais. (XVIII – XIX sc).

DO NOT COPY

DOWNLOAD

Si l'on excluait Butrint comme un cas particulier, nous proposerions pour la datation de ces meurtrières la période entre le XVI et le XVII sc.

Les meurtrières à fusil en couverture ronde se terminent dans la partie supérieure à l'interieur de la fortification, par un arc en pierres travaillées, formé de deux parties. Elles sont d'une hauteur de 0,60 à 0,65 m avec une largeur de la fente verticale de 6 à 7 cm. Les meurtrières surmontées d'architraves de pierre, gravés en forme d'arc à la partie inférieure, représentent une autre variante de ce type (tab. III). On en trouve plusieurs à Acrocorinthe qui sont qualifiées typiques vénétiennes et datent dans quelques cas de l'année 1700. La première variante se rencontre à Shkodra aux crénaux et à l'un des parapets lequel appartient à l'époque des pachaliks (XVIIIe sc). Les meurtrières qui percent les merlons (tab. III. 2) sont plus grandes, à fente verticale plus haute et plus large que les meurtrières du parapet. Elles sont sans doute plus anciennes que celles dernières peut-être elles remontent à la fin du XV sc lorsque Shkodra était encore sous le joug des vénétiens. Les meurtrières des merlons ainsi que celles du parapet ont des appuis en talus vers l'extérieur de la fortification mais celles dernières sont surmontées d'une voûte échelonnée. A Shkodra, de la période des pachaliks, sont également les meurtrières couvertes d'un arc en accolade.

A la fin il reste à éxaminer les meurtrières pour le tir au fusil à embrasure double et triple qui datent généralement des XVIIIe-XIXe sc. Même ces meurtrières se présentent en types et variantes différents. On peut les grouper en deux types principaux: Les meurtrières qui à l'intérieur sont formées de deux ou plusieurs baies qui se terminent à l'extérieur par une seule fente (tab. IV) et les meurtrières qui à l'intérieur se composent d'une seule baie qui se ramifie pour former à l'extérieur deux ou trois fentes verticales (tab. I, IV, V).

Comme il résulte du matériel déjà mentionné, les archères et les meurtrières pour le tir au fusil ne servent pas à la datation des objets où elles se trouvent, elles aident seulement à définir de longues périodes de temps qui embrassent des siècles entiers. Elles peuvent servir à la datation des objets dans le cas où elles sont typiques pour l'époque où elles furent construites, donc quand elles contiennent une série de détails qui ont évolué avec le temps. Les meurtrières des fortifications albanaises médiévales sont simples et utilitaires, elles ne sont pas influencées par les meurtrières des fortifications de l'Europe Septentrionale et Occidentale, où l'on remarque de différentes variantes de fentes verticales, qui ont obéi plutôt à la mode qu'aux buts utilitaires. D'autre part elles ne sont pas si hautes que celles dernières reprenant ainsi les types simples des meurtrières antiques et ceux de l'époque romaine.

Hourds, erker mâchicoulis

Etant donné que ces constructions ne resistent pas au temps, et les parties supérieures des murs et des tours ne parviennent à nos jours qu'en état de ruine, on n'en peut fournir que des exemples assez rares où sont conservées quelques traces de leur existence. Premièrement nous sérions préoccupés de savoir quand furent utilisées pour la première fois ces constructions qui rendaient active la défense d'une forteresse.

On a admis en général, que les éléments architectoniques destinés à la défense verticale des coins des murs ou des tours tels les hourds, les erkers et les mâchicoulis sont apportés en Europe par les croisés des pays du Moyen Orient. Nous n'avons quand même aucun exemple ancien de l'utilisation des hourds dans les pays de l'Est, comme il arrive avec les erkers. Les documents historiques nous rensegnent que cet élément a dû être appliqué à la forteresse de Durrës depuis le XIe sc. Georges Paléologue, nommé duc de Durrës en 1081, par la commande d'Alex Comnène, faisait construire d'une nouvelle façon les crénaux de la forteresse en utilisant des constructions de bois sans les fixer au mur. Ainsi, les normands, qui monteraient par des échelles seraient tombés les emportant avec eux. Ces constructions réalisées au niveau des merlons qui les remplacent, ne pouvaient être que des consoles qui s'écrouleraient par l'appui des échelles.

Comme on l'a déjà constaté dans plusieurs forteresses européennes, les hourds, en raison du feu, étaient construits provisoirement en cas de guerre, les trous de boulin étant préparé avant, pendant la construction de la forteresse. La construction des hourds à Durrës à la veille de l'attaque des normands et en plus le fait qu'ils ne furent pas fixés au mur, démontrent leur caractère provisoire. Il paraît qu'ils ne sont pas connus dans l'architecture militaire byzantine, qu'ils sont construits pour la première fois puisqu'ils n'ont pas un nom et sont décrits longuement par Anne Comnène. Durrës, l'une des plus fortifiées et des plus importantes villes maritimes de l'Empire Byzantin a dû servir de modèle aux croisés en ce qui concerne les différents éléments de fortification, entre autres les hourds. Un autre exemple de l'utilisation des hourds se rencontre à Petrela, dans une tour du XVe sc (fig. 2). Au niveau du deuxième étage sont conservées les traces des canaux où étaient posées les poutres qui soutenaient le plancher du hourd et qui sortaient du centre de la tour en forme de rayons. Aux parois de la tour il n'y a pas de trous de boulin qui pourraient attester la présence des autres poutres d'appui. Cela s'explique par le fait que le hourd ne fut pas un revêtement du mur de la tour dotée de crénaux formant un chemin de ronde, comme d'habitude, mais il a servi entretemps à élargir la superficie utilisée au deuxième étage de la tour qui a dû être habitée. Donc, dans ce cas on n'a pas à faire à un hourd provisoire comme ceux de Durrës au XI sc. Nous ne disposons pas d'autres éxemples anciens qui prouveraient l'existence des hourds, mais cet élément apparaît assez tard dans l'habitation rurale surtout en Albanie centrale. Cette habitation est appelée habitation à hourds donc elle porte le nom que nous avons utilisé pour cet élément de nos fortifications médiévales. Le caractère dé-

DOKTORI

tensif de ce type d'habitation est bien accentué dans les habitations à deux étages appelées «tour».

Les erkers, qui formaient de petites saillies aux murs et aux tours, se rencontrent plus souvent dans nos fortifications.

Tout comme les hourds ils apparaissent en Europe occidentale au XIIe sc et se répandent à une période encore plus postérieure en Allemagne vers le milieu du XVe sc, en Suisse au milieu du XVIe sc. Dans les pays du Moyen Orient, comme nous l'avons déjà mentionné, les erkers apparurent plus tôt et se répandirent au XX sc. Chez nous les plus anciens sont les erkers en bois. Leur présence est attestée par les ouvertures qui existent dans les parties supérieures des tours et des murs ainsi que par les trous de boulin qui servaient à fixer les poutres de support. Généralement les erkers étaient aménagés au dessus des tours pour contrôler leurs points morts sur les portes et moins souvent au-dessus des murs. Les traces conservées qui indiquent l'existence des erkers dans les fortifications albanaises appartiennent essentiellement aux XIV-XV sc, alors que leur présence bien avant cette date est attestée par des données historiques. En 1280, Charles Ier d'Anjou, dans le cadre des travaux pour la reconstruction de la forteresse de Durrës endommagée par le tremblement de terre en 1273 ordonna de garnir de 24 erkers le mur de l'acropole. Généralement les erkers en bois s'appuyaient sur des poutres fixées au mur ou liées au plancher de l'étage de la tour. Il n'y a qu'un cas particulier où l'on distingue que l'erker s'appuie sur des consoles, c'est celui de la forteresse triangulaire près du canal de Vivar à Butrint qui servait à défendre la porte.

Les erkers en bois commencent à disparaître au cours de la deuxième moitié du XVe sc et au XVIe sc ils sont remplacés par les erkers avec des murs de pierre qui généralement surmontaient les entrées. Les entrées de la forteresse supérieure de Lezha étaient munies d'erkers en pierres qui n'existent plus mais qui peuvent être vus en deux photos d'Yppen (fig. 5.6) D'après une inscription trouvée, ces entrées ainsi qu'une bonne partie des murs de cette forteresse ont été reconstruites à l'époque du Sultan Sulejman en 1521-22. Elles réapparaissent à l'époque des grands pachaliks albanais (XVIII-XIV sc) plutôt à des fins décoratifs que fonctionnels.

Mâchicoulis sont appelées des rangées ininterrompues d'erkers en pierres qui entouraient les parties supérieures des tours et la crête des murs. Le cas unique de leur utilisation est constaté à la forteresse de Preza (fig. 9, 14a) construite vers la fin du XV sc et le début du XVI sc. Les mâchicoulis se trouvaient au-dessus des arcs de briques appuyés sur deux rangées de consoles de pierres disposées l'une sur l'autre, mais sous les arcs il n'y avait pas de baies pour lancer des liquides chauds, ce qui prouve qu'ils n'avaient qu'une fonction décorative.

Merlons parapets, chemins de ronde et escaliers

Les merlons constituent l'un des plus anciens éléments utilisés à la fortification. Ils ont été pratiqués à l'ancienne Babylone, aux murs de la Troie, pendant l'antiquité classique, par les anciens romains, ainsi qu'au moyen âge. Les merlons présentent souvent de différentes formes selon l'époque ou le pays où ils se trouvent.

Dans les fortifications albanaises les merlons sont largement utilisés. Ils furent remplacés définitivement par les parapets percés de meurtrières à l'époque des grands pachaliks albanais (XVIII – XIX sc). Le mur des merlons était d'une hauteur de 75-80 cm et d'une épaisseur de 60 cm, alors que la largeur et la hauteur des merlons diffèrent d'une fortification à l'autre. Ce qui frappe l'oeil dans les fortifications albanaises c'est la proportionnalité entre les créneaux et les merlons. On ne rencontre pas de larges merlons avec des vides étroits dont les plus anciens se rencontrent aux fortifications du moyen Orient à Rhodes ou à quelque forteresse italienne telle celle de Rocelle. Des diverses formes des merlons dont quelques uns ont une origine très ancienne, on préfère la forme quadrangulaire, une forme typique de l'antiquité illyrienne de la période romaine et de la basse antiquité qui a été également la forme la plus répandue du moyen âge. La partie supérieure des merlons était plate ou surmonté d'une couverture de briques (Bashtovë) ou de tuiles (Durrës) en forme de toit (fig. 10). Bien que les dimensions des merlons et des vides entre eux n'apportent aucune donnée qui permetterait un rangement chronologique, on remarque quelques tendences qui pourraient être considérées comme une règle générale. On constate qu'après le XVe sc, avec l'occupation ottomane, la hauteur des merlons augmente (fig. 11).

Chez nous, les merlons furent percés de meurtrières à une période postérieure par rapport aux fortifications de l'Europe occidentale et en plus ce phénomène ne devînt pas une règle générale. Les merlons percés d'archères apparaissent seulement au XVe sc dans les forteresses de Bashtova, Berat, Shkodër etc. Dans quelques forteresses reconstruites par les turcs pendant la deuxième moitié du XVe sc ou le début du XVIe sc, les merlons ne furent pas dotés de meurtrières comme p.ex. dans les forteresses d'Elbasan, de Peqin, le mur turc datant de 1502 à Durrës etc. Les murs au crénelage substituèrent définitivement aux parapets à meurtrières au cours du XVIIIe sc, mais il ne manque pas d'exemples plus anciens qui cohabitèrent avec les murs crénelés. Ils devînrent indispensables à l'époque de l'utilisation de l'artillerie à poudre, donc depuis la moitié du XV sc. Le plus ancien parapet datant de 1407-1416 précède les murs de la forteresse de Shkodra (falsa braga). Le parapet percé de meurtrières se rencontre également aux murs de la première phase de construction de la forteresse triangulaire près du canal de Vivar à Butrint, qui date du XVe sc. Jusqu'au début du XVIIIe sc plusieurs fortifications étaient aux murs crénelés et seulement à l'époque des grands pachaliks dans quelques-unes d'elles furent murés les vides entre les merlons. Dans les forteresses faites construire ou reconstruire par Ali Pacha de Tépélena les tours et les

DOKTORI

murs sont dotés de parapets où alternent des canonnières et des meurtrières pour le tir au fusil. Au cours de la période tardive des pachaliks, les parapets à meurtrières étaient munis de tenêtres de guet percées de façon rythmique après un nombre défini de meurtrières.

Le chemin de ronde servait à faciliter les mouvements des défenseurs au niveau des merlons. Le chemin de ronde doit être 50-60 cm moins large que le mur de la fortification, donc sa largeur dépend de celle du mur de la fortification. Dans les murs larges le chemin de ronde est pratiqué à l'intérieur de l'épaisseur du mur alors que dans les murs d'une largeur de 1 m, il est aménagé par un système de pilastres conçus à l'intérieur des murs, fermées dans la partie supérieure par des voûtes de briques ou de pierres. Quand les murs de la fortification sont minces, le chemin de ronde est en bois.

Les escaliers. En général, les escaliers qui désservaient le chemin de ronde au-dessus du mur, étaient en pierres. Les escaliers en bois n'étaient pratiqués qu'au cas où le mur des courtines était mince et le chemin de ronde était en bois. Leur aménagement le long des murs ne suivait pas une règle bien définie, mais ils étaient plus fréquents dans les parties les plus importantes des courtines ou près des tours et des entrées. Les escaliers se trouvaient totalement ou partiellement à l'intérieur de l'épaisseur du mur d'enceinte ou à l'extérieur du mur. Quand les escaliers étaient construits à l'intérieur de l'épaisseur du mur celui-ci devient plus faible à cet endroit en raison de l'amincissement qu'il y subit. Les escaliers qui servaient à la communication entre les étages d'une tour, d'habitude étaient en bois. Les cas où les escaliers en pierres étaient construits à l'intérieur de l'épaisseur du mur postérieur de la tour afin de ne pas affaiblir les autres murs exposés à l'attaque, sont assez rares. Ces types se heurtent aux fortifications qui datent après le XVe sc (Durrës 1502).

Dans quelques cas, comme p.ex. dans une tour du XVe sc à Durrës, afin de ne pas affaiblir le mur qui s'élevait en dessus, l'escalier était construit à l'intérieur d'une galerie surmontée de voûtes cylindriques.

Les escaliers qui reliaient les étages des tours, étaient droits comme dans les pays orientaux. On ne rencontre pas d'escalier en spirale si connus dans les pays de l'Europe Occidentale.

Cheminées et fenêtres

Les cheminées apparurent seulement quand les tours devinrent habitables pour la garnison. Dans les tours des fortiifcations de la période byzantine on n'a pas trouvé de traces de feu. Elles devinrent habitables après l'occupation turque, quelques fois même dans quelques forteresses vénetiennes de la même époque, c.à.d. non plus tôt que le milieu du XV sc. Le plus ancien exemple de l'utilisation d'une cheminée dans notre pays, se rencontre à la forteresse triangulaire près du canal de Vivar à Butrint qui remonte à la fin du XV sc et au début du XVI sc (fig. 13). Le premier étage était habité alors que le rez-de-chaussée servait d'emplacement d'une batterie de cinq canons. Le premier étage qui était séparé du rez-de-chaussée par un plancher en bois, était muni d'une cheminée, de trois grandes fenêtres et de six archères. La cheminée présente une section semi-circulaire à un diamètre de 1,2 m (ifg. 13) qui en se retrécissant dans la partie supérieure devient 0,38 m. Il n'y a aucune trace qui prouverait l'existence du tambour. On a trouvé une autre cheminée plus ancienne à section semi-circulaire dans la forteresse quadrangulaire au-desus de la côte «59 m, à Durrës. Elle se trouve à l'étage supérieur de l'une des tours polygonales angulaires dont la partie supérieure fut reconstruite au XVI sc, peut – être en 1502 quand les turcs par la construction d'un nouveau mur, diminuèrent la superficie protégée de la ville. De la cheminée se conservent la partie inférieure ainsi que des traces d'un arc ou d'une voûte cylindrique. Des deux côtés de la cheminée on ne constate pas de niches. A. Bashtove après l'occupation de la forteresse par les turcs, quelques-unes des tours servirent de logement pour la garnison. Jusqu'en 1521 il y a eu d'autres travaux, y compris la construction d'un mosquée, au-dessus de l'entrée principale. Il faut mentionner que dans nos habitations juqsu'à l'heure actuelle on n'a pas constaté de cheminées plus anciennes que celles de XVIIe-XVIIIe sc. Avant cette date à leur place existait une niche simple ouverte du côté des murs de la pièce, qui servait de foyer. De pareils exemples des XIVe-XVe sc se rencontrent aux villages en ruine de Kamenica, Drisht etc. Les cheminées des habitations, des XVIIIe-XIXe sc à la différence de celles des fortifications, sont flanquées de deux niches. Dans les habitations on ne rencontre pas toutes les formes de cheminées des fortifications. On se heurte à des cheminées pointues mais on ne trouve pas celles ouvertes qui se terminent par un arc circulaire ou un architrave en pierre. Grâce au matériel que l'on dispose, on peut tirer la conclusion que les différentes formes des cheminées n'ont aucune valeur chronologique sûre, mais il est important de souligner qu'elles commencent à paraître à une période définie qui ne va pas plus loin que le XVe sc ou le début du XVI sc, et telles quelles elles peuvent servir selon le cas à distinguer une période des constructions défensives des autres plus anciennes.

Les fenêtres (tab. VIII) représentent un autre élément de nos fortifications qui comme les cheminées se rattache aux pièces qui servaient de logement. A cause du mauvais état de conservation, dans les habitations on ne rencontre aucune ancienne fenêtre. On en trouve essentiellement aux tours.

Vers la fin du XV sc et surtout au cours du XVI sc apparaissent les grandes fenêtres qui assuraient l'éclairage des constructions annexes et de quelques tours qui servaient entre temps de logement aux garnisons.

Dans les dernières constructions des XVIII-XIX sc, surtout

dans celles faites construire par Ali Pacha de Tepelena, l'emploi des grandes fenêtres destinées à l'éclairage, devînt une habitude. Elles percent même les murs extérieurs des fortifications comme p.ex. à Gjirokastra, Tépélena, Porto Palermo etc. A cette époque on pratique largement les lucarnes ouvertes à la clé des voûtes de couverture ou aux murs latéraux. Celles-ci introduisent la lumière au moyen d'un appui en talus pratiqué en haut du mur. A l'appui de quelques fenêtres de la forteresse de Tépélena, il y a une fente verticale en forme de meurtrière aux dimensions 30 sur 6 cm qui traverse en pente le mur au-dessous de la fenêtre et servait à faire couler les eaux sans avoir besoin d'ouvrir le battant de la fenôtre.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Dilaver KURTI

VARRET SHKËMBORE TË MATIT

Në fshatrat Derjan, Rrëmull, Urxall, Burgajet, Lis, Suç, Kurdari, Bërshi, Batër, të rrethit të Matit njihen 33 varre shkëmbore (tab. I), që nga banorët quhen **«Burgje»** dhe **«Shpella»**. Në kohët e vona ato janë përdorur për strehimin e bagëtive dhe për mbajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale, prandaj ruajnë edhe emrat e familjeve në pronësinë e të cilave kanë qenë tokat ku ndodhen. Këto objekte janë punuar në mjedise shkëmbore me përbërje rënore ose zhavori. Duke u nisur nga teknika e punimit, forma, ngjashmëria tipologjike me objekte të zbuluara në vendin tonë, mendojmë se këto monumente janë varre shkëmbore, që lidhen me periudhën e kulturës qytetare ilire.

VARRET E DERJANIT

Në këtë qëndër u fiksuan shtatë varre shkëmbore, të cilat gjenden në dy pika, dy në veri të Derjanit, në lagjen Skuraj dhe pesë në juglindje, në lagjen Daç.

Varri 1, ndodhen në lagjen Skuraj, poshtë Kodrës së Kishës, në vendin që quhet «Pazari i Skëndërbeut». Në gojën e banorëve njihet me emrin «Burgu i Kazibeut». Ai është i gdhendur në një masë shkëmbore prej shtuf zhavorri, që është shkëputur nga Kodra e Kishës. «Burgu i Kazibeut» me



TAB I

DO NOT COPY



Fig. 1

formë gati parabolike, me zgjatje JP – VL, është një ndër varret më të ruajtura (Tab. II). Hyrja formohet nga një korridor i gjatë 1,80 m, ku pas 1.10 m është hapur ulluku i kasë së portës me thellësi e gjerësi 0.20 m (Tab. 1, 1.2).



Fig 1-1

Lartësia e portës është 1.75m, kurse gjerësia 1.30m. Mbas portës korridori zgjerohet në të dy krahët. Dhoma ka gjatësinë 4m, gjerësi 3m dhe lartësi 2.5m.

Varri 2, «Burgu i Kishës» gjendet mbi varrin 1, në faqen jugperëndimore të shkëmbit të Kodrës së Kishës. Sipas dëshmisë së banorëve, që kanë mundur të hyjnë me litarë në të, ka tipare të ngjashme me varret e tjera të kësaj qendre.

Varri 3, «Burgu i Haxhiajve», gdhendur në një faqe shkëmbore, me përbërje shtuf-zhavori, me hyrje nga jug-perëndimi gjendet në lagjen Daç (fig. 2). Në varr futesh nëpërmjet një korridori 1m të gjatë dhe 2m të gjerë. Hyrja e cila ka qenë me hark, me gjerësi 2m, lartësi 1.90m dhe thellësi e gjerësi të kanalit të kasës së derës 0.20m, ndodhej 0.50m para dhomës. Dhoma në formë katërkëndëshe me cepa



TAB II

DO NOT COPY

të harkuara ka këto përmasa: gjatësi 2.60m, gjerësi 3.15m dhe lartësi 2m (Tab. III). Në varr ndodhen dy kamare (Tab. III, 2, 3). E para, 0.20m para derës, në të majtë, ka gjerësi 0.40m, lartësi të harkuar 0.40 m dhe thellësi 0.30m. Kurse e dyta, me gjerësi 0.50m, lartësi 0.40 m dhe thellësi 0.30m, është në faqen ballore, përkarshi hyrjes.

Varri 4, «Burgu i Metës» ndodhet në lagjen Daç. Varri punuar në shkëmb me përbërje shtufi zhavor është dëmtuar nga shembja e tavanit të anës jugore të portës, por megjithatë planimetria e tij është e qartë (fig. 13). Porta, me lartësi 1.80m, gjerësi 1.70m, ka dy kanale për kasën e derës me gjerësi e thellësi 0.20m. Dhoma në formë katërkëndëshe (Tab. IV, 4) me skaje të rrumbullakosura, ka gjerësi 3.30m e lartësi 1.80m. Në faqen jugore 0.70m mbi tokë është një kamare 0.60m e lartë, 0.60m e gjerë dhe 0.30m e



TAB III



Fig. 2

thellë. Porta ka një lartësi prej 1.80m dhe gjerësi 1.30m.

Varri 5, «Burgu i Nezirit» gjendet në lagjen Daç. Planimetria e tij është eliptike me hyrje nga perëndimi (Tab. IV). Përmasat e ruajtura janë: gjatësi 2.70m, gjerësi 3.15m, lartësi 1.90m. Në portë nuk duken gjurmë kanali.

Varri 6, «Burgu i Gjenit» ndodhet në lagjen Daç në një faqe shkëmbore me shtuf zhavori. Përmasat e tij janë: thellësia 4.10m, gjerësia 5.10m, lartësia 2,40m. Porta, e cila ka qenë e lartë 1.70m, e gjerë 2m, ruan kanalin e kasës së derës me gjerësi e gjatësi 0.20m, (Tab. V). Duke u nisur nga pjesa e ruajtur në anën perëndimore, ku gjendet dhe një kamare 1m mbi dysheme, me gjerësi 0.40m, lartësi 0.45m, thellësi 0.60m, mendojmë se varri ka pasur formë katërkëndëshe, me cepa të harkuara, me lartësi 1.70m.

Varri 7, gjendet ndërmjet varrit 3 dhe 5. Hyrja e tij është bllokuar nga depozitimet e dheut. Nga një hapësirë e vogël duket se është gdhendur në shtuf-

-rënor dhe ka ngjashmëri tipologjike me varret e tjera.

Varri 8, «Burgu i Koxhukut» ndodhet në lagjen Samaj, (fig. 4).

Varri, në formë gati katërkëndëshe, është hapur në mesin e shkëmbit, me portë nga verilindja (Tab. VII). Në të hyhet nëpërmjet një korridori 2.30m të gjatë. Porta ka formë katërkëndëshi 1.60 x 2.10m me kanal të derës 0.20m. Pas portës, korridori, vazhdon dhe 0.70m. Gjerësia e dhomës arrin 3.50m, gjatësia ka formë të çrregullt e shkon nga 2 në 2.50m. ndërsa lartësia 1.75m.

Varri 9, «Burgu i Stanës» gdhendur në majë të një shpati shkëmbor me përbërje shtufi rënor, me drejtim juglindje, gjendet mbi fushën e Derjanit, në lagjen Samaj (Tab. VIII).

Hyrja ka gjerësi 2.50m. Dhoma 3.10m e thellë dhe 3.50 e gjerë ka lartësi 1m. Në faqet jugperëndimore dhe veriperëndimore ka nga një kamare (0.50 x 0.50 x 0.30m dhe 0.30m x 0.30m x 0.25m).

Varri është dëmtuar dhe mbushur nga prurjet.



Fig. 3



TAB IV

Varri 10 ose «Burgu i Vjetër» gjendet në lagjen Toçaj, në anën e djathtë të Përroit të Thatë. I ngjashëm me varrin e Derjanit, sot ai është i mbuluar me ferra dhe mbushje dheu.

* * *

Burgajeti, ashtu si Derjani, shquhet për një numër të madh varresh shkëmbore, të cilat arrijnë në numrin dhjetë, por janë në gjendje tepër të dëmtuar. Ashtu si në Derjan janë të grupuara në disa pika dhe me ekspozim nga lindja deri në perëndim. Ato njihen me emrat e fiseve në pronësi të të cilëve ishin tokat në lagjet Gropë, Cibaj, Koçaj.

DO NOT COPY



TAB V

Varri 11, «Burgu i Varangut», është hapur në shkëmb shtufi rënor me drejtim të portës nga jug-perëndimi dhe ndodhet në lagjen Cibaj (fig. 6). Një kanal korridori me qemer, me lartësi 1.90m, gjerësi 1.60m e me gjatësi 0.60-1m të çon tek dera e varrit. Kanali i kasës ka përmasat 0.10 x 0.15m. Korridori vazhdon përtej tij dhe 0.25m të tjera për të arritur dhomën në formë katërkëndëshi me brinjë të harkuara, me thellësi 2.50m, gjerësi 3.10m dhe lartësi 1.90m (Tab. IX).

Varri 12, ose «Burgu i Vanit», Mbi arën e Vanit, nën Kodrën e Kazhanëve, gjenden dy varre shkëmbore me emrim «Burgjet e Vanit» Varri 12 (fig. 5) hapur në një shkëmb shtufi rënor e ka hyrjen nga perëndimi (fig. 5). Gryka e hyrjes ruhet 0.70-0.90m (Tab. 10). Porta është 2m e gjerë dhe 1.30m e lartë. Dhoma në formë katërkëndëshe, me cepa të rrumbullakosura, ka thellësi 3.75m, gjerësi 4.10m dhe lartësi 1.50m. Sot ky varr përdoret si vendstrehim bagëtish.

Varri 13, që quhet, gjithashtu, «Burgu i Vanit» ndodhet 6m larg varrit 12 dhe ka formë katërkëndëshe. Hyrja, e cila ruhet në anën e majtë, formohet prej një kanali 0.80m të gjerë. Në të dallohet ulluku i kasës së portës me thellësi e gjerësi 0.20m. Porta është e lartë 1.25m dhe e gjerë 1.80m. Më tej (Tab. XI), hyrja vazhdon dhe 0.55m, zgjerohet në të dy anët 1.20m dhe 1.10m, duke formuar dhomën e varrit në trajtë katërkëndëshe, me thellësi 3.50m, gjerësi 4.20m e lartësi 1.40-1.50m (fig. 7).

Të dy këto varre janë varret më të ruajtura në grupin e varreve të Burgajetit.

* * *

Midis Arës së Vanit dhe Arës së Stafës në anën jugore të Kodrës së Kazhanëve, ku ndodhen varret



Fig. 4

DO NOT COPY

12, 13, gjendet dhe një grup tri varresh, që njihen me emrin «Burgjet e Kazhanëve» ose «Burgjet e Dobrës». Hyrjen e kanë nga jugu dhe ndodhen 14 dhe 30m larg njëri-tjetrit. Ato janë gdhendur në faqen shkëmbore prej shtufi rënor, me reliev të pastër.

Varri 14, është i dëmtuar, nuk ka kanal dhe as vend të portës. Në hyrje ruhen zgjatimet e saja 0.30-0.40m, me gjerësi 2.35m dhe lartësi 1.60m. Në pjesën afër tavanit të hyrjes ka një kamare me përmasat 0.25 x 0.30 x 0.03m. Dhoma e varrit (Tab. XII) ka formë katërkëndëshe me cepa të rrumbullakosura, me gjerësi 2.35m në hyrje dhe 3.40m në fund. Thellësia arrin në 3.20m, ndërsa lartësia 1.70m.

Varri 15. Po në këtë faqe shkëmbore, 14m larg, ndodhet varri tjetër që hyn në grupin e varreve të Dobrës, i cili është i dëmtuar sa nuk i shquhet as hyrja dhe as porta, bile është mbushur me prurje dhe rënie nga tavani i tij. Varri ka formë katërkëndëshe (Tab. XIII), me cepa të rrumbullakosura, me gjerësi të grykës 2.30m dhe lartësi të kapshme 0.80m. Thellësia është 3m, gjerësia 2.40m dhe lartësia e zvogëluar 0.80m. Në faqen fundore ndodhen dy të thelluara vezake, njëra me përmasat 0.25 x 0.50m dhe tjetra 0.10 x 0.15m.

Varri 16. Rreth 30m larg varrit 14 ndodhen gjurmët e një varri të dëmtuar plotësisht, të cilit i duket vetëm fundi dhe gjurmët e gdhendjes me kazëm.

Varri 17. Në Lagjen Gropë gjenden dy varre shkëmbore, të quajtura «Burgu i Përleshës» dhe «Burgu i Lufit», përkatësisht sipas emrit të kodrave mbi të cilat janë ngritur. Varret, punuar në shkëmb shtufi

POOR COPY



TAB VI



TAB VII

rënor, rreth 100m larg njëri-tjetrit, janë tepër të dëmtuara, sepse përdoren si vendbanim bagëtish.

Varri 17 dhomën e ka në formë gjysmërrethi, me thellësi 3m, gjerësi 3.90m e lartësi 1.60m. Porta me orientim nga jugu, sot, është e gjerë 2.50m dhe e lartë 1.50m (Tab. XIV).

Varri 18, ka tipare më të qarta se varri 17, Hyrja e tij është e gjerë 2.45m dhe e lartë 1.80m. Në të dy faqet anësore ndodhet nga një kamare me bazë katërkëndëshe 0.35m e gjerë, 0,20m e thellë dhe 0.50m e lartë, me formë të kurbëzuar (Tab. XV).

* * *

Në Lagjen Koçaj gjenden dy varre, i pari në Arën e Hetës, kurse tjetri sipër tij. Nga etnonimi Koçi, kanë marrë emërtimin e antroponimeve të pronarëve Heta dhe Ismaili. Ato janë tepër të dëmtuara.

Varri 19, «Burgu i Hetës» është punuar në shtuf rënor. Hyrja nga juglindja ka gjerësi 2.90m (Tab. XVI) e thellësi 1.60-2m. Tavani ka disnivel, i cili varion nga 1.20-1.70m. Në njërën faqe ndodhet një kamare me formë të harkuar me bazë katërkëndëshe, 0,30m e gjerë, 0.15m e thellë dhe 0.30m e lartë.

Varri 20, «Burgu i Ismailit» me hyrje nga juglindja është tepër i dëmtuar. Thellësia për shkak të disnivelit të shkëmbit shkon nga 1.50-2.15m, kurse lartësia nga 1.20-1.80m (Tab. XVI). Tavani i tij ka formë qemeri cilindrik.

DO NOT COPY



TAB VIII



TAB IX

DO NOT COPY



Fig. 5

VARRET E LISIT

Lisi është një katund i hershëm, i njohur në mesjetë si kryeqendër kishtare e krahinore e Matit dhe vend tregu që nga shek. XV. Këtu kalonte rruga



Fig. 6



TAB X

nga Dyrrahu për në Mat, Dibër dhe Kosovë. Edhe në Lis, kryesisht në lagjen Cibaj, fiksuam mbeturinat e dy varreve shkëmbore.

Varri 21, ndodhej afër Teqes së Nel Hotit, në faqen shkëmbore të rrugës tradicionale Burrel-Lis. Në vitin 1979, kur u hap ujësjellësi i ri, nga Vinjolli për në Burrel, varri u prish nga traseja e rrugës, që shërbeu për ndërtimin e ujësjellësit.

Varri 22, pranë varrit 21, gjithashtu i dëmtuar, ndodhej ndën rrugë, tek fisi Driçi.

VARRET E SUÇIT

Suçi ndodhet 8 km larg qytetit të Burrelit, në të majtë të rrugës për në Klos dhe shtrihet mbi një rrafsh midis lumit të Matit dhe degës së tij, Lusës. Suçi është i njohur si qendër me vlera arkeolo-

gjike. Në tarracën buzë lumit gjenden rrënojat e një kishe paleokristiane, me emrin e Shën Markut, të shek. IV-VI të erës sonë.

Në kufirin midis Suçit dhe Kurdarisë, në Përroin e Ulzës dhe të Padithit, janë dy varre shkëmbore.

Varri 23, quhet «Shpella e Ulzës» nga përroi me të njëjtin emër. Në varr (fig. 8) shkohet nëpërmjet një korridori të gjatë 2.40m. Larg murit të dhomës, 0.60 – 0.70m, është kasa e derës me gjerësi e thellësi 0.20m, në të cilin fiksohej dera 1.75m e lartë dhe 2m e gjerë. Dhoma ka formë katërkëndëshe, me cepa të rrumbullakosura, me thellësi 4.10m, gjerësi 2.90m dhe lartësi 1.75m (Tab. XVII).

Varri 24, «Shpella e Tukut», ndodhet në vendin që quhet Haliaj. Korridori në hyrje të portës është 0.90m i gjatë (fig. 9). Në mesin e tij është kasa me gjerësi e thellësi 0.20m, ku ka qenë fiksuar porta, me lartësi të hyrjes 1.40m dhe gjerësi 1.65m. Dhoma e varrit ka trajtë katërkëndëshe me cepa të rrumbullakosura. Thellësia është 2.80m, gjerësia 3.25m dhe lartësia 1.75m (Tab. XIX).



Fig. 7



TAB XI

VARRET E KURDARISË

Midis Suçit, malit të Balgjajtë, Lisit dhe Patinit shtrihet katundi i Kurdarisë. Gërmimet arkeologjike në Kurdari kanë nxjerrë në dritë gjurmët e një ujësjellësi antik me qyngje balte, mbeturina tumash ilire, gjurmë antike, si dhe dy nekropole varresh shkëmbore.

Varri 25. «Shpella e Likës» (Tab. XX), kufizohet në veriperëndim me Kodrën e Kades, në perëndim me «Shpellën e Sulës» (V. 26), në jug me përroin e Topallëve dhe në lindje me Rriskat. Varri i punuar në shkëmb shtufër, portën e ka nga jugu. Hyrja formohet nga një kanal 1.20m i gjatë, në mesin e të cilit është kasa, me trajtë katërkëndëshe, me thellësi e gjerësi 0.20m, ku ka qenë fiksuar dera. Porta

DO NOT COPY

DO NOT COPY



TAB XII



TAB XIII

është e gjerë 2m dhe e lartë 1.40m. Dhoma ka formë katërkëndëshe me cepa të rrumbullakosur e tavan me formë të harkuar. Thellësia është 3m, gjerësia 3.60m, lartësia 1.40m. Tabani i varrit është nën nivelin e sotëm të terrenit.

Varri 26, që gjithashtu quhet «Shpella e Likës» ndodhet në lindje të varrit 25, 50m larg tij. Natyra e shkëmbit dhe drejtimi i tij janë si ato të varrit 25.

Kanali për në hyrje të varrit është 0.40m. Porta ka qenë fiksuar në dy kanale anësore me formë katërkëndëshe, me thellësi e gjerësi 0.20m. Gjerësia e portës është 1.50m, kurse lartësia 1.80m. Dhoma e varrit është në trajtë katërkëndëshe (Tab. XX) me cepa të rrumbullakosur gati në formë katrore, me thellësi 2.90m, gjerësi 3m dhe lartësi 1.80m. Tabani është i sheshtë, kurse tavani është në formë të harkuar dhe faqe anësore të drejta. Ky varr sot përdoret si depo herbicidesh.

Varri 27. varri shkëmbor më i rëndësishëm gjendet në lagjen Spilaj të Kurdarisë. Ai quhet «Shpella e Lazarëve» ose «Hoxhajve». Punuar në një terren shkëmbor prej shtuf zhavori, me drejtim të hyrjes nga perëndimi, përbëhet nga dy dhoma, hyrjet e të cilave janë 2.50m larg njëra-tjetrës (Fig. 10). Duke qenë të ndërlidhura dhe në funksion të një qëllimi duhen parë në unitet midis tyre. Për lehtësi përshkrimi i emërtuam, atë në të majtë të hyrjes varri 27, kurse atë në të djathtë varri 27-1.

Varri 27 e ka hyrjen 3m të gjatë. Në mesin e saj është fiksuar dera në formë qemeri, me gjerësi maksimale 1.60m në taban dhe 0.75m sipër dhe

lartësi 1.75m. Kasa e derës ka formë qemeri me thellësi e gjerësi 0.20m.

Dhoma e varrit (Tab. XXII) ka formë katërkëndëshe me cepa të rrumbullakosura. Faqet anësore janë të drejta deri në lartësinë 1.25m. Dhoma është e thellë 3m, e gjerë 3.75m, dhe e lartë 1.75m. Në ballin e faqes fundore, përkarshi portës, sipër, faqja e shkëmbit, është dalluar, duke krijuar një xhep në formë sofati (Tab. XXIII), me gjatësi 1.75m, lartësi 0.75m dhe thellësi 0.40m. Në të dy faqet anësore të hyrjes, afër tavanit, gjenden dy kamare me bazë 0.40m, lartësi 0.30m dhe thellësi 0.20m (Tab XXII,. XXIII).

Varri 27-1, për shkak të pjerrësisë së faqes së shkëmbit e ka hyrjen më të shkurtër dhe dhoma e varrit gjendet më përpara. Korridori i hyrjes është 1.35m. Në gjatësinë rreth 1m nga faqja e shkëmbit është hapur kanali i kasës së derës në formë qemeri me thellësi e gjerësi 0.20m. Dera ka lartësinë 1.75m, gjerësinë në taban 1.60m dhe afër tavanit 1.10m. Ndryshe nga porta e varrit 27 ajo është 0.30m nën nivelin e tij. Dhoma e këtij varri është më e madhe (Tab. XXII) dhe ka formë katërkëndëshe me cepa të rrumbullakosura. Kjo dukuri shihet edhe në faqet anësore, të cilat deri në lartësinë 1.50m, shkojnë drejt, ndërsa më sipër kanë tendencë harkimi. Përmasat e tabanit të varrit janë: thellësia 3.50m, gjerësia 4m, lartësia 2.10m. Edhe në këtë dhomë gjenden tri kamare. Këto ndodhen në dy faqet anësore dhe në atë ballore, në lartësinë afër tavanit (Tab. XXII, XXIII). Kamarja e faqes së majtë që është në murin e përbashkët të dy dhomave, ka formë katërkëndëshe me cepa të rrumbullakosura dhe brinjë 0.20cm. Ajo e faqes ballore, takon në tavan dhe



TAB XIV



TAB XV

DO NOT COPY

DO NOT COPY



TAB XVI



TAB XVII

zbret poshtë me një bazë të drejtë dhe lartësi e gjerësi 0.20m. Kurse kamarja e faqes së djathtë, është më e madhe, me brinjë katrore 0.50 x 0.50m.

Të dy dhomat i lidh midis tyre një hyrje në trajtë gati vezake (Tab. XXIII), hapur në cepin e faqes së majtë të varrit 27. Këtu ajo është një nivel me tabanin dhe ka gjerësi e lartësi të njëjtë maksimale 1.25m. Në faqen e varrit 27-1 ajo del 0.40m mbi dyshemenë e dhomës me përmasa më të vogla dhe forma gati të rrumbullakosura, me gjerësi rreth 1m. Kjo dukuri na shtyn të mendojmë se hyrja është hapur nga varri 27, në drejtim të varrit 27-1 dhe ndofta lidhet me radhën e ngritjes së tyre.

VARRET E BËRSHINIT

Bërshini ndodhet midis katundeve Suç, Patin, Cërujë, Pleshë, sipër rrjedhës së djathtë të lumit Mat. Ai ka një terren kodrinor dhe maja më e lartë është Kodra Kushpanjekë, me lartësi 489m.

Në Bërshin ndodhet një shpellë karstike me emrin Shpella e Mirë, e cila ka gjurmë banimi të hekurit të hershëm. Në tarracat buzë lumit Mat kanë qenë dy tuma ilire dhe në truallin e tij herë pas here kanë dalë objekte të ndryshme arkeologjike.

Edhe në Bërshin ndodhet një nekropol me dy varre shkëmbore të gdhendura në shkëmb shtufor dhe me hyrje nga juglindja, të cilat janë në lagjen Rogjaj.

Varri 28, «Burgu i Murriqit», ndodhet në lagjen Rogjaj, në Arën e Burgut. Kufizohet në verilindje me «Burgun e Begajve» në perëndim me lagjen Rogjaj e Kodrën e Trahanit, në lindje me varrezat dhe juglindje me Arën e Vëllaut.

DO NOT COPY



TAB XVIII



TAB XIX

Hyrja formohet nga një korridor i gjatë 2.50m, me kanal të kasës së derës 0.15 x 0.15m. Në të fiksohej kasa 1.75m e lartë dhe 1.55m e gjerë. Dhoma me formë katërkëndëshe, me cepa të harkuara, është e thellë 3.95m, e gjerë 3.80m dhe e lartë 1.92m (Tab. XXIV). Faqet anësore në afërsi të tavanit pësojnë harkime. Hyrja në raport me tavanin është 0.50m më e ulët.

Varri 29, «Burgu i Begajve», afër varrit 28, ndodhet tek fisi Demiraj. Ai kufizohet nga veriu me Kodrat e Kushmares, në lindje me varrezat, në perëndim me Kodrën e Trahanit dhe në jug me Arën e Vëllaut.

Hyrja me drejtim nga jugperëndimi është 1.90m e gjatë. Në të duken gjurmë të kanalit të kasës. Ky është i vetmi varr i ruajtur, në të cilin nuk e gjetëm këtë element, ka të ngjarë nga dëmtimi, ose nuk e ka pasur fare. Gjerësia e portës është 1.55m dhe lartësia 1.65m (Tab. XXV). Dhoma e thellë 3m, e gjerë 3.55m dhe e lartë 1.80m, ka formë katërkëndëshe me cepa të harkuar. Faqet anësore me rritjen e lartësisë pësojnë harkime drejt tavanit, i cili si tek varri 28 është më i lartë se hyrja.

VARRET E BATRËS

Batra, në kufi me Burrelin, Muzakën, Frankthin dhe Demin, shtrihet buzë rrjedhës së majtë të Lumit Mat. Në kodrat e Batrës, në lartësinë 300m, gjenden katër varre shkëmbore. Ato ndodhen një në lagjen Pjezhgëz dhe tre në Pepaj.

Varri 30, «Burgu i Balliut», ndodhet në lagjen

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9

TAB XX



TAB XXI





Fig. 10

Pjezhgëz, në kodrën me të njëjtin emër. Ai është gdhendur në shkëmb shtufor, me hyrje nga jugu. Tavani është shembur, ndërsa nga korridori i hyrjes ruhet vetëm 1m gjatësi, në anën e majtë të tij. Nga pjesët e ruajtura mundëm të kapim formën katërkëndëshe të dhomës me cepa të rrumbullakosura dhe përmasa: thellësi 4m, gjerësi 3.90m lartësi 2.25m (Tab. XXV).

Varri 31, «Burgu i Pepajve», ndodhet në lagjen Pepaj. Sot ai shërben si vendstrehim. Sipas dëshmisë ka pasur formë katrore, me cepa të rrumbullakosur, me brinjë 3.5m, lartësi 2m dhe me hyrje nga perëndimi.

Varri 32, «Burgu i Dedës» gjendet në lagjen Pepaj, 300m, poshtë varrit 31 e thuhet se ka qënë më i vogël se ai. Përmasat mendohen të kenë qënë: gjatësia 3m, gjerësia 3.50m dhe lartësia 1.80m, me drejtim të portës nga jugu. Edhe ky është prishur dhe është kthyer në vendstrehim.

Varri 33, «Burgu i Bukaçit», gjendet në lagjen Pepaj, 250m afër Teqesë së Domit. Ai qe mbushur me dhé, kështu nuk mundëm të përftonim përmasat dhe të dhënat mbi gjendjen e tij.

* * *

Të 33 varret shkëmbore të Matit shtrihen në nëntë qendra, 8 prej tyre në rrjedhën e djathtë të lumit Mat dhe vetëm një në të majtë. Ato janë gdhendur në faqet shkëmbore me përbërje shtufi rënor ose zhavori, duke shfrytëzuar faqet e sheshta me ekspozim nga lindje në jug dhe perëndim. Për ndërtimin e varreve janë përdorur thandra, dalta çekiçë, gjurmët e të cilave duken në profilet e lëna gjatë punës në faqet shkëmbore. Të gjitha varret kanë korridor që shkon nga 0.40-0.50m, i cili të çon në dhomën e varrimit. Për fiksimin e portës hapej një kanal në shkëmb, zakonisht në mes të korridorit, apo afër dhomës. Ndër varret e ruajtura ky kanal mungon vetëm në varret (12 dhe 29). Në pjesën e sipërme kanali mbyllet me formë të harkuar, apo të drejtë, sipas formës së vetë derës. Gjerësia e portave shkon nga 1.30-2.50m, kurse lartësia 1.25-1.90m, gjë që tregon se duhet të ketë qënë prej druri. Porta ka të njëjtën lartësi me dhomën e varrit, me përjashtim të varrit 8, 13, 14, 17, 20.

Dhomat e varreve kanë forma të ndryshme, të cilat mund të grupohen në tri variante: a) me planimetri ovale (varri 1, 8, 11, 24, 26) b) me planimetri katërkëndëshe, me cepa të rrumbullakosura (varri 3,



TAB XXII

DO NOT COPY

DO NOT COPY



TAB XXIII



TAB XXIV

4, 9, 12, 14, 15, 23, 25, 27, 28, 30) dhe c) me planimetri katërkëndëshe varri 18, 19). Përmasat e dhomës së varreve lëvizin nga 2.40-4.10m gjerësi, 2.15--3.95m gjatësi, 1.40-2.50m lartësi, 6-15.10m² sipërfaqe (shih pasqyrën 2).

Në nëntë rastet tek hyrjet e varreve dhe dhomat e tyre, janë hapur kamare, si një element plotësues me funksion ritual. Në dy varre ato gjenden në korridor dhe në shtatë rastet e tjera brenda dhomës, në faqet ballore përkarshi hyrjes ose në faqet anësore (Varri 3, 4, 6, 9, 18, 19, 27, 27-1). Vendosja e tyre është bërë në mesin e lartësisë së dhomës. Vetëm tek varri 27 këto janë afër tavanit. Ato kanë forma katërkëndëshe dhe kulme të harkuara. Përveç elementëve të sipërm tek varri 27, përkarshi hyrjes, është gdhendur edhe një sofat.

Duke u mbështetur në formën dhe elementet plotësuese të varreve, mund të përcaktojmë tipat dhe variantet e tyre, për pasojë të bëjmë dhe periodizimin kronologjik.

Mungesa e të dhënave nuk na lejon një datim të këtyre monumenteve dhe ngjashmëritë e varreve të Matit me ato të Selcës së Poshtme ende nuk mund të përdoren për të vendosur një raport kronologjik midis tyre. Për më tepër kronologjia nuk gjen mbështetje edhe në një raport relativ të vetë varreve të Matit. Kjo bën të nevojshme, në të ardhmen, një studim më të detajuar të këtyre monumenteve, të shoqëruara edhe me gërmime arkeologjike.

DO NOT COPY



TAB XXV



TAB XXVI

DO NOT COPY

PASQYRA MBI TIPOLOGJINË E VARREVE

Nr. varrit	Emërtimi dhe vendodhja	Tipi varrit			Forma e portës			Forma e dhomës				Gjindet pranë objekteve të kultit
		I	II	III	Qemer	Katërkënd	drejtimi	Hark.	Cepa rrumb.	Katër-kënd.	Nr. kamareve	
1.	Burgu i Kazibeut Skuraj-Derjan	+	—	—	+	—	JP	+	—	—	—	+
2.	Burgu i Kishës Skuraj-Derjan	?	?	?	?	?	JP	?	?	—	?	+
3.	Burgu Haxhiaj Daç-Derjan	—	+	—	+	—	JP	—	+	—	2	—
4.	Burgu i Metës Daç-Derjan	—	+	—	—	+	P		+	—	1	—
5.	Burgu i Nezirit Daç-Derjan	?	?	?	?	?	P	?	?	?	—	—
6.	Burgu i Gjonit Daç-Derjan	?	?	?	?	?	P	?	?	?	1	—
7.	Burgu i Derjan-Daç	?	?	?	?	?	?	?	?	?	?	—
8.	Burgu i Koxhukut Semaj-Rremull	—	+	—	+	—	JL	—	+	—	—	—
9.	Burgu i Stanës Samaj-Rremull	—	+	—	?	?	JL	—	+	—	2	—
10.	Burgu i Vjetër Urxall		?	?	?	?	P	?	?	?	?	+
11.	Burgu i Varangut Cibaj-Burgajet	+	—	—	+	—	JP	+	—	—	+	—
12.	Burgu i Vanit 1 Gropë-Burgajet	—	+	—	?	?	P	—	+	—	—	+
13.	Burgu i Kazhanvel Gropë-Burgajet	—	+	—	?	?	J	—	+	—	1	+
14.	Burgu i Vanit 2 Gropë-Burgajet	—	—	+	—	+	P	—	—	+	—	+
15.	Burgu i Kazhanve 2 Gropë-Burgajet	—	+	—	?	?	J	—	+	—	—	+
16.	Burgu i Kazhanve 3 Gropë Burgajet	?	?	?	?	?	J	?	?	?	?	+
17.	Burgu i Përleshës Gropë Burgajet	?	?	?	?	?	J	?	?	?	?	+
18.	Burgu i Lufit Gropë Burgajet	—	—	+	—	?	J	—	—	+	2	+
19.	Burgu i Hetës Koçaj Burgajet	?	?	?	?	?	JL	?	?	?	1	—
20.	Burgu i Ismailit Koçaj Burgajet	?	?	?	?	?	JL	?	?	?	—	—
21.	Burgu i Bilbilaj Lis	?	?	?	?	?	P	?	?	?	?	+
22.	Burgu Driçit Lis	?	?	?	?	?	P	?	?	?	?	+
23.	Burgu Ulzës Suç	—	+	—	—	+	L	—	+	—	—	+
24.	Burgu Tukut Suç	+	—	—	+	—	L	+	—	—	—	+
25.	Burgu i Likës Kurdari	—	+	—	—	+	J	+	—	—	—	—
26.	Burgu i Sulës Kurdari	+	—	—	+	—	J	+	—	—	—	—
27	Burgu i Hoxhajve Spilaj Kurdari	—	+	—	+	—	P	—	+	—	3	—
27—1	Burgu i Hoxhajve Spilaj Kurdari	—	+	—	+	—	P	—	+	—	3	—
28.	Burgu i Muriçit Rogjaj Bërshi	—	+	—	—	+	JP	—	+	—	—	+
29.	Burgu i Begajve Rogjaj Bërshi	—	+	—	?	?	JP	—	+	—	—	+
30.	Burgu i Balliut Pjeshgëz Batërr	—	+	—	?	+	J	—	+	—	—	—

Nr. varrit	Emërtimi dhe vendodhja	Tipi i varrit			Forma e portës			Forma e dhomës				Gjindet pranë objekteve të kultit
		I	II	III	Qemər	Katërkënd	drejtim i	Hark.	Cep. rrumb.	Katër-kënd	Nr. kamareve	
31.	Burgu i Pepajve Pepaj Batërr	?	?	?	?	?	P	?	?	?	?	–
32.	Burgu i Dedës Pepaj Batërr	?	?	?	?	?	J	?	?	?	?	–
33.	Burgu i Bukaçit Pepaj Batërr	?	?	?	?	?	J	J	?	?	?	+

V · 0 Shenja + shënon tiparet që gëzon grupi, kurse – jo.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

PASQYRË MBI PËRMASAT E VARREVE

Nr. varrit	Përmasat e portës		Përmasat e dhomës së varrit			
	Gjerësia	Lartësia	Gjatësia	Gjerësia	Lartësia	Sipërfaqja
1.	1.30	1.75	4	3	2.5	12
2.	?	?	?	?	?	?
3.	2	0.80 (?)	2.60	3.15	2	8.20
4.	1.70	1.80	3.30	3.30	1.80	10.90
5.	1.90	1.90	2.70	3.15	1.80	8.50
6.	1.70	1.70	3	3	1.70	9
7.	?	?	?	?	?	?
8.	2.10	1.60	2.50	3.50	1.75	8.75
9.	2.50	?	3.10	3.50	?	10.85
10.	?	?	?	?	?	?
11.	1.60	1.90	2.50	3.10	1.90	7.75
12.	1.30	2.70	3.75	4.10	1.70	14.40
13.	1.80	1.25	3.50	4	1.50	14
14.	2.35	1.60	3.20	3.40	1.70	10.90
15.	2.30	0.80 (?)	3	2.40	0.80	7.20
16.	?	?	?	?	?	?
17.	2.50	1.50	3	3.90	1.60	11.70
18.	2.45	1.80	3	3.50	1.80	10.50
19.	2.90	1.70	2	3	1.70	6
20.	3.40	1.70	2.15	3.50	1.80	7.50
21.	?	?	?	?	?	?
22.	?	?	?	?	?	?
23.	2.10	1.75	2.90	4.10	1.75	11.90
24.	1.65	1.40	2.80	3.25	1.75	9.10
25.	2	1.40	3	3.60	1.40	10.80
26.	1.50	1.80	2.90	3	1.80	8.70
27.	1.60	1.75	3	3.75	1.75	11.25
27.1	1.60	1.75	3. 5	4	2.10	14
28.	1.55	1.75	3. 9	3.80	1.92	15.10
29.	1.55	1.65	3	3.55	1.80	10.65
30.	?	?	2.25	3.90	2.25	8.80
31.	?	?	3.50	3.50	2	12.25
32.	?	?	3	3.50	1.80	10.50
33.	?	?	?	?	?	?

Dilaver KURTI

DO NOT COPY

LES TOMBES GRAVÉES DANS LA ROCHE A LA RÉGION DE MAT

Aux villages Derjan, Rremull, Urxall, Bigajet, Lis, Luç Kurdari, Bershi, Batër de la région de Mat, se trouvent 33 tombes monumentales (tab I) nommées «prisons» ou «grottes» par les gens du pays. Ces derniers temps ces tombes furent utilisées pour garder le bétail et les produits agricoles et prirent ainsi le nom des familles propriétaires fonciers, nom qu'elles conservent même à l'heure actuelle. Ce sont des objets travaillés dans un rocher sableux ou granuleux. La technique du travail la forme, la ressemblance typologique avec d'autres objets mis au jour dans notre pays nous induisent à penser que ce sont des tombes rocheuses qui se rattachent à la période de la culture urbaine illyrienne.

Les 33 tombes monumentales rocheuses s'étendaient sur neuf centres dont huit se situent sur la rive droite de la rivière de Mat et un sur la rive gauche. Elles sont gravées aux parois plats d'un rocher sableux ou granuleux, exposé dans la direction sud-est ou sud-ouest. Pour leur réalisation on a utilisé le marteau et le ciseau dont les traces demeurent même à l'heure actuelle aux profils laissés au cours du travail aux parois du rocher. Toutes les tombes sont précédées d'un vestibule qui va de 0,40 à 2,50 m et mène à la chambre funéraire et à la profondeur du rocher. Pour fixer la porte on a creusé un canal qui se trouve soit au milieu du vestibule, soit près de la chambre. En dessus il est droit ou arqué selon la forme de la porte.

La largeur et la hauteur des portes varient de 1,30 m à 2.5 m et de 1,25 m à 1.90 m ce qui montre qu'elles ont dû être en bois. A part quelques exceptions (les tombes 8,13,14, 17,20) la porte a la hauteur de la chambre funéraire.

D'après leurs formes variées, les chambres funéraires peuvent être groupées en trois variantes: a) à planimétrie ovale (les tombes 1,8,11,24,26) b) à planimétrie quadrangulaire aux coins arqués (les tombes, 4,5,9,12,14,15,23,25,27,28,30) et c) à planimétrie quadrangulaire (les tombes 10,18). Les dimensions de la chambre funéraire varient de 2,40 à 4,10 m de largeur, de 2,15 à 3,95 m de longueur, de 1,40 à 2,50 m de hauteur et de 6 à 15,10 m2 de superficie (le tab. 2).

Dans neuf cas, à l'entrée des tombes et dans les chambres sont creusées des niches, en tant qu'élément complémentaire à fonction rituelle. Dans deux cas on les rencontre au vestibule alors que dans les autres cas elles se trouvent sur la face frontale, en face de l'entrée, ou sur les faces latérales au milieu de la hauteur de la chambre, à part un cas où elles se trouvent plus près du plafond (la tombe). Elles présentent une forme quadrangulaire à coins arqués. Dans la tombe 27, de pair aux éléments déjà mentionnés on retrouve un sofa gravé.

S'appuyant à la forme et aux éléments complémentaires des tombes on peut définir les types et les variantes et par conséquent les périodes chronologiques.

L'absence des données ne permet pas une datation de ces monuments tandis que les ressemblances avec les tombes de Selca e Poshtme ne permettent pas encore d'établir un rapport chronologique entre elles. En plus la chronologie ne trouve appui même dans un rapport relatif des tombes de Matl elles-mêmes. Cela nécessite dans l'avenir une étude plus detaillée de ces monuments accompagnée aussi de fouilles archéologiques.

DO NOT COPY

monumentet

DO NOT COPY

Valter SHTYLLA
Lazër PAPAJANI

TË DHËNA TEKNIKE MBI RRUGËN E LUGINËS SË SHKUMBINIT NË ANTIKITET DHE MESJETË

Për rrugën e luginës së Shkumbinit, si pjesë e një arterje të rëndësishme, e cila që nga kohët antike lidhte kontinentin e vjetër, Europën me Azinë e Vogël, kanë shkruar herë pas here studiues e udhëtarë të ndryshëm, të huaj dhe vendas, duke e parë në këndvështrim historik, arkeologjik apo si itinerar, etj.

Në këtë punim do të përshkruhen rezultatet e dy ekspeditave, të kryera në terren gjatë viteve 1988--1989[1]), të cilat kishin për qëllim të gjurmonin dhe evidenconin në terren hollësi teknike të kësaj rruge si: kalldrëme, ura, tombino, mure mbajtëse, etj. Gjurmimi dhe përshkrimi inxhinjerik i trakteve të kalldrëmeve dhe veprave të artit të rrugës përbën kontributin e parë të kësaj ndërmarrje. Punimi shoqërohet me një hartë të hollësishme topografike të trasesë më të ruajtur, me një legjendë të detajuar, të pabotuar deri më sot (fig. 1). Shkelja në vend e tërësisë së rrugës së vjetër u krye në rrethin e Librazhdit, nga ura e Haxhi Beqarit në Mirakë deri në fshatin Qukës duke prekur dhe trakte jashtë luginës, në Qafë Thanë, si dhe u morën të dhëna nga territoret jashtë kufirit tonë shtetëror, në Strugë dhe Ohër, ku patëm rastin të gjurmojmë gjatë vitit 1988. Në Strugë, në hyrjen nga Qafë Thana, është një rrugë me emrin Via Egnatia, në Muzeun e Ohrit ruhet një pllakë me mbishkrim nga kjo rrugë. Nga gjurmimet në terren, të kryera deri më sot, dhe nga burimet e ndryshme bibliografike arrihet në përfundimin se pikërisht në trasenë nga Miraka në Qukës ruhen gjurmët më të shumta të kësaj rruge të rëndësishme me karakter europian.

Rruga e luginës së Shkumbinit fillonte në Durrës, vazhdonte nëpër Kavajë, Peqin, Elbasan (Ura e Haxhi Beqarit), majtas Shkumbinit në Babje, Dardhë, Xhyrë, Qukës, Përrenjas, Qafë Thanë, Strugë, Ohër e më pas në Selanik e shkonte deri në Stamboll. Ajo ka ekzistuar që në antikitetin ilir. Vendbanimi i Shënlliut, pranë Elbasanit dhe Qyteza në Qukës--Skënderbej, kontrollonin këtë rrugë që në periudhën e parë të hekurit[2]. Kalaja e Lleshanit, vendbanimi i Gradishtës në Dumrë dhe kalaja e Dorsit ndodheshin në degëzimet jugore e veriore të kësaj rruge. Shënlliu, Kalaja e Saragut, Vendbanimi i Xibrakës dhe Selca e Poshtme dëshmojnë për funksionimin e rrugës së Shkumbinit edhe në periudhën qytetare ilire[3]. Kalaja e Vilës në Petrelë, kulla e Gracenit, Dorsi nga veriu dhe Gradishti, Kamunaku, Lleshani, e Valshi, kontrollonin degët e kësaj rruge në këtë periudhë.[4] Materialet arkeologjike të gjetura në këtë

1) Në dy ekspeditat e rrugës së luginës së Shkumbinit kanë marrë pjesë V. Shtylla, L. Papajani, topografi M. Bezhani (në 1988), skicografi A. Delvina dhe S. Korani (në 1988). Skica dhe harta janë tushuar nga A. Qyshka. Fotot janë të V. Shtyllës.

2) N. Ceka-L. Papajani, **Rruga në luginën e Shkumbinit në kohën antike,** Monumentet 1/1971, 43.

3) Po aty, 45.

4) N. Ceka-L. Papajani, **vep. cit, 45.**

DO NOT COPY

zonë dëshmojnë për marrëdhëniet tregtare ndërmjet Dyrrahut dhe Maqedonisë në lindje[5] në periudhën helenistike.

Rruga antike e luginës së Shkumbinit para pushtimit romak njihej me emrin rruga e Kandavisë, siç quheshin malet e Polisit në atë kohë.[6] Nëpërmjet rrugës Kandavia bëhej lidhja ekonomike e krahinave. Pas shekullit IV p.e.s në këto anë zhduken monedhat maqedonase, ndërsa monedhat e Dyrrahut arrijnë deri në rrethinat e Pogradecit[7]. Gjurmët e vetme të tërësisë së rrugës së Kandavisë ruhen në përroin Gurrat e Zeza, ndërmjet fshatit Dardhë e Xhyrë dhe më saktë, ndërmjet Bregut të Sqepurit dhe Bregut të Kostanilit, ku ruhet një serpentinë e fortë e rrugës së mëvonshme Egnatia. Ky trakt, majtas përroit, rreth 30 m poshtë urës së drurit (të rrugës Egnatia) ka gjatësi rreth 80 m. Trakti i Kandavisë me pjerrësi rreth 20% është rrugë karvanesh me gjerësi që ndryshon sipas terrenit nga 1,2 deri 1,8 m (fig. 2). Kalldrëmi është i punuar me gurë të mëdhenj, të shtrirë, me përmasa 60 x 90 cm, 45 x 60 cm dhe gurë të vegjël 20 x 45 cm, etj. (fig. 3). Nga ana e përroit kalldrëmi mbrohet me një mur mbajtës primitiv punuar me gurë masivë. Këta gurë, me gjatësi 2m, të japin më tepër përshtypjen e blloqeve shkëmbore të papunuara (fig. 4). Teknika e mureve me gurë të mëdhenj, të papunuar, që krijojnë boshllëqe midis tyre i takon periudhës së parë të hekurit. Teknika e njëjtë me atë të murit mbajtës në Gurrat e Zeza, haset në fortifikimet e Marshejt e Gajtanit në veri dhe Gjo-



Fig. 2



Fig. 3

5) **Po aty,** 47.

6) Strabonis, Geographia, libri VII, Burime të zgjedhura për Shqipërinë vol I, 1965, Cezar, **po aty,** 93.

7) N. Ceka, **Vështrim arkeologjik në rrethin e Elbasanit,** Monumentet 3/1972, 12.

DO NOT COPY



Fig. 4



Fig. 5

nonmadhit e Bellovodës në Korçë, etj.[8]. Kështu, trakti i kalldrëmit në Gurrat e Zeza si kohë ndërtimi i takon periudhës para romake. Një dëshmi e rëndësishme e funksionimit të rrugës së luginës së Shkumbinit në antikitet është së fundi një trakt i madh muri mbajtës i rrugës në Kroin e Shelgut në Qafë Thanë (fig. 5). Ky trakt punuar me blloqe guri të çrregullta, të paputhitura mirë, me boshllëqet ndërmjet tyre të mbushura me gurë më të vegjël, vende-vende në formë pyke, ka gjatësi rreth 55 m dhe lartësi 3 m. (fig. 6). Vërehet një ngjasim me teknikën e periudhës së dytë të mureve fortifikuese të Lisit, të cilat rrinë si kohë ndërmjet mureve të periudhës së parë të hekurit dhe atyre të stilit trapezoidal të rreshtuar e poligonal datuar në periudhën qytetare ilire, në fund të shek. IV-III p.e.s[9]. Duke u mbështetur në traktet e kalldrëmit në Gurrat e Zeza dhe në traktin e ruajtur qartë të murit mbajtës në Qafë Thanë (shek. IV-III p.e.s) del se rruga e luginës së Shkumbinit e njohur me emrin rruga e Kandavisë ka funksionuar gjatë antikitetit ilir. Trakti i murit mbajtës në Qafë Thanë, i ndodhur jashtë luginës dëshmon se rruga e Kandavisë nuk qe vetëm rrugë e provincës ilire, por ajo e lidhte atë me trevat Maqedonase e më tej. Nga përmasat e Gurrave të Zeza del se rruga antike e Kandavisë ka qenë rrugë e ngushtë, për karvane me kafshë, në ndryshim nga rrugët romake, të gjera për qerre.

Kalldrëm i njëjtë me atë të Kandavisë tek Gurrat e Zeza ruhet edhe në një krahinë tjetër të vendit tonë, në Vajushë të Gruemirës. Ky trakt kalldrëmi, me gjatësi rreth 40 m e gjerësi 1,2-1,5m shtruar me gurë pllocakë me format 40 x 60 cm dhe 40 x 70 x x 80 cm është pjesë e rrugës së hershme të karvaneve, që lidhte Shkodrën me Kalanë e Ballecit dhe më tej me Kosovën. Kalaja e Ballecit, në lindje të Reçit, në malin e Maranajt, ngritur mbi themele të një ndërtimi të hershëm të periudhës së parë të he-



Fig. 6

8) Gj. Karaiskaj, 5000 vjet fortifikime në Shqipëri, Tiranë 1981, 13, 17.
9) Po aty, 81.

kurit, tipi i Marshejt e Gajtanit[10], është kala e kohës së Skënderbeut.

Gjithashtu, një kalldrëm me teknikë të ngjashme anë të Gurrave të Zeza ruhet në fshatin Krura Jelia në Mal të Zi, në degën Risinum (Kotor) – Salthua (Nikshiq) të rrugës bregdetare, pjesa Scobre (Shkodër) – Leusinium[11]

Kalldrëmi i ngushtë 1,2-1,8 m, për karvane me kafshë, me gurë të mëdhenj pllocakë, me syprinë konvekse, haset jo vetëm në luginën e Shkumbinit, ku në periudhën para dhe qytetare ilire ka funksionuar rruga e Kandavisë, por edhe në rrugën ndërmjet Kotorrit e Salthuas, vendbanime të fisit ilir të Dokleatëve, si dhe në rrugën e Gruemirës. Kjo tregon për njohjen e teknikës së rrugëve nga vendasit (ilirët), si dhe për atë që pushtuesit romakë, në Iliri, gjetën një rrjet rrugor të trajtuar teknikisht, siç dëshmon muri mbajës në Qafë Thanë, një realizim i goditur për kohën.

* * *

Pas pushtimit të Ilirisë nga romakët në shekullin e II p.e.s, rruga e luginës së Shkumbinit u bë pjesë e rëndësishme e rrugës ushtarake dhe tregtare, që lidhte Europën Perëndimore me Azinë e Vogël e nëpërmjet saj me lindjen e Mesme.

Tek Polibi (200-120 p.e.s)[12] rruga e Shkumbinit përmendet si rrugë që lidhte Epidamnin me Helladën. Tek ekspeditat e Cezarit (viti 54 p.e.s)[13] ajo njihet me emrin e vjetër ilir «Kandavia» dhe vetëm tek Straboni (63 p.e.s-20 e.s)[14], për herë të parë, njihet si pjesë e rrugës së gjatë Egnatia. Në fundin e shek. të V, gjatë sulmit të Gotëve në trevat ilire, Malchi e përmend përsëri rrugën e Shkumbinit me emrin e hershëm ilir «Kandavia»[15].

Në itineraret e rrugëve antike dhe pikërisht tek Tabula Peutigeriana e gjysmës së parë të shek. XII[16], janë shënuar stacionet e rrugës Egnatia në luginën e Shkumbinit, të cilat duke filluar nga Durrësi janë: Dyrratio-Clodiana (Peqini) – Scampis (Elbasani) – Genesis Flumen (Ura e Haxhi Beqarit) – Ad Dianam (Babja) – In Candabia (Qukësi) – Ponsservili (Uraka) dhe Lignido (Ohri).

Gjatë shekujve të II-I p.e.s, veçanërisht në gjysmën e parë të kësaj periudhe, ndërtimet inxhinjerike patën një zhvillim të mëtejshëm. Në këtë drejtim spikat ndërtimi i rrugëve, të lidhura këto me realizimin e ekspeditave ushtarake të Romës, si dhe me vetë nevojën për bashkëpunim të qyteteve ilire, të cilat në shekujt e parë të erës sonë patën një zhvillim ekonomik, si pasojë e fuqizimit të degëve të ndryshme të zejtarisë dhe tregtisë. Në vendet e pushtuara rrugët kryesore romake u integruan me rrugët ekzistuese vendase (të dokumentuara në rastin tonë nga gjurmët e tyre) dhe sipas eksperiencës shekullore provinciale ekzistuese.[17]

Në mjaft raste, tentativat romake për ndërtime të reja rrugore hasën pengesa dhe vështirësi të ndryshme nga natyra e vendit, rrëshqitjet e terrenit, shirat e shumtë, të papritur e të furishëm, si dhe nga prania e shtresave argjilore nën nënshtresat rrugore.[18] Në luginën e Shkumbinit pushtuesit romakë gjetën të trasuar rrugën e hershme të Kandavisë, mbi të cilën kryen mjaft përmirësime si: zbutje vende-vende të pjerrësisë, zgjerimi tërësisht i kalldrëmit për kalimin e qerreve, ndërtime urash me trarë ose qemerë guri apo tulle, ndërtime të mureve mbajtëse, vendosje të gurëve miliarë dhe të mbishkrimeve në pika të ndryshme të rrugës e të tjera ndryshime të domosdoshme për kalimin e ekspeditave ushtarake.

Duke filluar prej Durrësit gjurmët e para të rrugës Egnatia në trevat tona i hasim në fshatin Qerret të Kavajës, ku në thellësinë 0,5 m nga sipërfaqja e tokës kanë dalë gjurmët e kalldrëmit me gjerësi 4-

10) Gj. Karaiskaj, **Gjurmë fortifikimesh ilire në disa kështjella të Shkodrës,** në Buletin Arkeologjik 4, 1974, 150.

11) Maja Paroviç-Peshikan, **Rimski put Risimium Salthua, në Starinar,** XXIII Fig. 1, 1972, ku kalldrëmi në Krua Jelia cilësohet si i periudhës romake, ndryshe nga mendimi ynë.

12) Polibi, Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, V. I, 1965, 47.

13) **Po aty,** 93.

14) Strabonis, **vep. cit,** 158.

15) Malch, **Byzantia,** në Ilirët dhe Iliria, Tiranë 1965, 409.

16) **Hirët dhe Iliria,** 311.

17) P. Gazzola, **Ponti Romani,** V. II, Firenze 1963; 115.

18) P. Gazzola, **vep. cit,** 115.

DOKTORE

DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 9

- 5m, shtruar me gurë pllocakë të mëdhenj.[19] Në vazhdim, para hyrjes për në Scampis (Elbasan), rruga e luginës së Shkumbinit, në fshatin Bradashesh



Fig. 8

ka stacionin Ad Quintum, ku ruhet dhe sot një banjo romake e shek. II[20]. Pas Scampinit gjurmët e rrugës Egnatia i takojmë te Ura e Haxhi Beqarit, e cila lidh fshatin Mirakë me zonën e Polisit. Tek kjo urë rruga Egnatia kalonte nga e djathta në të majtë të lumit Shkumbin duke hyrë në malet e Polisit ose të Kandavisë, siç quheshin këto male në antikitet.

Në urën e Haxhi Beqarit, në mbështetjen e Bregut të djathtë, ruhen gjurmë ndërtimi të një ure romake mbi rrugën Egnatia (fig. 7). Gjurmët duken në mbetjet e themeleve, pasi kjo urë ka pësuar riparime të ndryshme gjatë kohëve. Qemeret e urës romake me trashësi 70cm dhe gjerësi 4,2m kanë qenë me tulla. Tulla e përdorur në urë ishte me përmasa 4,5 x x 24 x 34 cm. Muret e faqeve të dukshme të murit jugor janë ndërtuar sipas teknikës «opus incertum» tipike për shekullin II-III, me një rresht gurësh të çrregullt dhe dy rreshta tullash. Duke u nisur nga përmasat e tullave[21] dhe teknika e mureve pranojmë si kohë ndërtimi shekujt II-III. Besojmë se kjo duhet të ketë qenë ura e prishur nga gotët në vitin 479, kur po ndiqeshin nga romakët. Gjatë rrjedhës së posht-

19) H. Myrto, **Mbi disa qendra arkeologjike ndërmjet Kavajës dhe Durrësit,** Monumentet 7-8, 1984/252.

20) N. Ceka, L. Papajani, **Nymfeu dhe termat e stacionit Ad. Quintum,** Monumentet 4/1972, 41.

21) N. Ceka, – L. Papajani, **Nymfeu...,** 47, A. Mano, **Qeramikë masive e Apolonisë,** Studime historike, 1/1965.

V. Vurstor – J. Guzert, **Ura e Limyrës në Lyki**, në Archaologische Anzeiger – 2/1978, 288.

P. Gazzola, **vep. cit,** 161.

– Malch, **vep. cit,** 409.



Fig. 10

me rreth 500 m nën urën e mësipërme, 60 m djathtas derdhjes në Shkumbin të përroit të Gostimës ndodhen rrënojat e një ure tjetër romake, urës së Keçit (fig. 8). Mbetjet e muraturës së këmbëve të urës së Keçit sot ruhen mbi tokë të thatë. Sipas matjeve në terren del se konstruksioni i urës së Keçit ka qenë me katër qemerë me hapësira drite rreth 14 m. Gjerësia e urës arrinte 3,5 m, trashësia e këmbëve rreth 4 m dhe gjatësia totale arrinte përmasën rreth 95 m. Duke hartuar skemën e vendtakimit të lumit Shkumbin me përroin e Gostimës, tek Ura e Keçit dhe duke u bazuar në traktin e ruajtur të një muri mbajtës bregor në takimet e dy lumenjve arrijmë në përfundimin se ajo i takonte përroit të Gostimës dhe lidhte fshatrat majtas përroit në rrugën Egnatia. Gjatësia e madhe 90 – 100 m tregon për një deltë të gjerë të përroit të Gostimës gjatë derdhjes në Shkumbin. Harqet e qemereve, si dhe tek ura e Haxhi Beqarit, kanë qenë realizuar me tulla. Tullat e Urës së Keçit me përmasa 4,5 x 26,28 x 32,35 cm, janë pothuaj si tullat e përdorura tek Ura e Haxhi Beqarit. Pra, këto dy ura janë ndërtuar në një kohë, në shekujt II – III.

Në vargun malor, majtas lumit Shkumbin, nga Ura e Haxhi Beqarit deri tek Ura e Quksit, përsëri në Shkumbin, ruhet pothuaj kudo, e lexueshme, traseja e rrugës Egnatia, me ndonjë devijim të vogël, në përmirësimet e vona të periudhës turke, për shkak të zbutjes së pendencave. Devijime të lehta ka para Qafës së Dervenit, në Babje, tek Rrafjet e Spatharit, tek Bregu i Kostanilit, tek hanet e Hoxhës para Xhyrës, në dalje të Xhyrës, etj. Duke ndjekur vendbanimet në segmentin e rrugës gjatë maleve të Polisit, traseja e rrugës Egnatia kalonte nëpër këto pika: Ura e Haxhi Beqarit, Qafa e Dervenit-Babje-Qershizë-Kulla e Pirgut-Rrafjet e Spatharit-Spatharë-Çekrez të Dardhës-Bregu i Sqepurit-Përroi i Gurrave të Zeza-Qukës Skënderbej-lumi i Shkumbinit-Qukës. Gjurmët teknike të rrugës Egnatia si kalldrëme, mure mbajtëse dhe ura ruhen vetëm pas fshatit Babje dhe Spatharë.

Së pari, trakte të kalldrëmit të rrugës Egnatia me gjatësi rreth 50 m dhe gjerësi 5,5-6 m takohen në Çekrez të Dardhës (fig. 9). Kalldrëmi është i shtruar me gurë të mëdhenj plloçakë. Gurët më të mëdhenj janë vendosur kryesisht në anët dhe në aksin e rrugës (fig. 10). Në vazhdim arrihet tek përroi i Gurrave të Zeza, ku si kalldrëm, ruhen vetëm trakte të rrugës së ngushtë të Kandavisë. Muri mbajtës i rrugës Egnatia është ndërtuar me gurë të mëdhenj, të prerë dobët në faqe dhe në anët (fig. 11). Madhësia e gurëve ndryshon, gurët më të vegjël futen ndërmjet më të mëdhenjve. Rruga Egnatia në përroin e Gurrave të Zeza kalonte mbi një urë të vogël (fig. 12). Sot prej saj ruhen vetëm mbështetjet bregore, e majta me gjerësi 4,3m dhe djathta 2,3m. Ura me mbështetje bregore të përmasave të ndryshme dhe të sfazuara në plan ndaj njëra tjetrës, duhet të ketë qenë me mbikalim druri me hapësirë drite 6m. The-



Fig. 11

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13



Fig. 14

DO NOT COPY

mrat nga ana e ujit janë punuar me blloqe guri të latuara pa kujdes të veçantë (fig. 13). Teknika e rreshtimit të gurëve nuk duhet aq solide për përballimin e një qemeri prej guri, gjë që përforcon mendimin se kemi të bëjmë me një urë druri, megjithëse në themrën e majtë, tek bjefi i poshtëm duket një formë e kurbëzuar, si linjë e një fillimi harku. Faqet e mureve bregore kanë pothuaj teknikën e murit mbajtës të rrugës Egnatia (fig. 14).

Pas Gurrave të Zeza vazhdon e njëjta trase dhe para serpentinës së Kostanilit, traseja e periudhës turke shmanget në dy serpentina, djathtas për t'u takuar me rrugën Egnatia, pikërisht pas bregu të Kostanilit. Serpentina tek Bregu i Kostanilit me gjerësi 4,5 m, me gurë të çrregullt, s'është punuar me teknikën e shtruar të Egnatias në trase horizontale (fig. 15). Kalimi nëpër serpentinë është shqetësues, mbi maja e brinjë gurësh kave mali (fig. 16). Rreth 300--400 m pas Bregut të Kostanilit, në pjesën Dardhë--Xhyrë, tek rrënojat e haneve të Hoxhës, ruhen gjurmët më të qarta të rrugës Egnatia. Para haneve gjurmohen rreth 20 ml trakte të rrugës. Në pjesën më të lexueshme me gjatësi 4 m shihet teknika tipike e rrugës Egnatia dhe e rrugëve romake në përgjithësi (fig. 17). Këtu rruga ka gjerësinë 3,35 m. Anët bien në sy për brezat më të rregullt, të prerë drejt nga jashtë, me gjerësi 60 dhe 70 cm, me gurët me gjerësi 25, 30, 40 cm. Fusha e kalldrëmit vende-vende me gurë më të vegjël 30 x 40 cm, 20 x 30 cm si dhe me të tjerë më të mëdhenj. Syprina e kalldrëmit s'është shqetësuese, pasi gurët janë të shtruar nga ana më e gjerë dhe më e sheshtë. Menjëherë pas haneve të Hoxhës hasen përsëri gjurmë të rrugës Egnatia (fig. 18). Këtu brezat më të punuar anësore, që konturojnë me kufij të drejtë kalldrëmin, janë të dëmtuar, por ruhen gurët e mëdhenj brenda fushës së kalldrëmit me përmasa 90 x 95 cm, 85 x 106,75 x x 100, me gurë më të vegjël ndërmjet 40 x 45, 36 x x 48, 33 x 60 cm, etj. Përsëri syprina e kalldrëmit është e sheshtë dhe jo shqetësuese. Trakti ruhet me përmasën 4 m të gjerësisë së tij.

Disa dhjetra metra poshtë këtij trakti, në përroin e Gaducit, shkarja e dheut krijon mundësinë e leximit të profilit teknik të rrugës Egnatia. Këtu ruhet një brez anësor i rrugës me gjerësi 60-70 cm. Trashësia e gurëve pllocakë në fushën e kalldrëmit është 30-40 cm dhe nën to është shtruar një shtresë çakëlli 5-8 cm. Kësisoj kalldrëmet e rrugëve romake shtroheshin me gurë pllocakë, me trashësi 30 – 40 cm mbi nënshtresë çakëlli mbi shtratin e rrugës.

Pas haneve të Hoxhës, deri në Xhyrë-Mal, rruga Egnatia ecën paralel me rrugën e periudhës turke, por në një kuotë më të ulët se ajo. Rreth 500 m



Fig. 15


Fig. 16


Fig. 17

DO NOT COPY

para Xhyrës, 100 m pasi kalon një tombino të rrugës Egnatia, ka një mur mbajtës. Ai ka shërbyer për mbrojtjen e rrugës Egnatia, nga rrëshqitjet e dherave (fig. 19). Para hyrjes në fshatin Xhyrë-Mal shtrihet një trase e qetë dhe e gjerë e rrugës Egnatia (ku kalon dhe rruga turke) me gjatësi 150 m dhe gjerësi afër 6,5 m. Këtu duket vetëm tapeti i barit dhe asnjë gjurmë kalldrëmi (fig. 20). Poshtë shkollës së Xhyrës, rruga Egnatia kalon nën qemerin e një ure guri të rrugës së periudhës turke. Traseja e rrugës Egnatia vijon kështu poshtë trasesë së rrugës turke deri në Qafën tek Guri i Mollës, ku e takon përsëri këtë rrugë dhe traseja e njëjtë vazhdon deri poshtë në lumin e Shkumbinit tek ura romake në hyrje të Qukësit. Në këta pjesë të trasesë nuk ruhen gjurmë të rregullta të kalldrëmeve të rrugës Egnatia, veç ndonjë shtresë të shpërbërë gurësh tek-tuk gjatë anëve, në Qukës-Skënderbej, si dëshmi të rrugës së hershme. Punimet bujqësore në arat me tokë të butë kanë zhveshur rrugën e vjetër nga mbistrukturat me kalldrëm. Në Xhyrë – Mal, në vijim të urës turke, menjëherë pas saj, vërehet një shtresë kalldrëmi rreth 50 m, me gjerësi 3,5 m realizuar me teknikë që ndryshon nga ajo e rrugës Egnatia. Nuk vihen re borduret e rregullta kufizuese anësore dhe fusha e kall-



Fig. 19

drëmit nuk i ka gurët e mëdhenj si të Egnatias. Veçse teknika e murit mbajtës nga ana e përroit të Vilzës ndryshon pak nga ajo e Egnatias tek Gurrat e Zeza. Kjo fazë e kalldrëmit përkon me trasenë e rrugës së mëvonshme të periudhës turke. Mbase në këtë rast kemi të bëjmë me një përmirësim të trasesë së rrugës Egnatia në një kohë tjetër, mbas shekujve II-I p.e.s. kur mendohet se rruga e luginës së Shkumbinit, si pjesë e rrugës së gjatë Egnatia, filloi të plotësohet me vepra arti rrugore.

Në përfundim, vepra e fundit e artit e rrugës Egnatia, gjatë maleve të Polisit, është Ura e Qukësit mbi lumin e Shkumbinit. Kjo urë buzë rrugës nacionale Elbasan – Korçë është 210-300 m para qendrës së Qukësit. Ura e Qukësit ruan gjurmë nga këmbët e saj (nga themrat bregore, si dhe nga këmbët e mesit). Ajo ka qenë e ngritur mbi tri qemere me hark guri me hapësira drite rreth 15-16 m. Gja-

TRAKT I EGNATIAS
POSHTE HANEVE TE HOXHES



Fig. 18



Fig. 20

Do not copy



Fig. 21

tësia totale e urës arrinte 70 m dhe gjerësia 3,7 m (fig. 21). Nga rruga Egnatia, e cila kalonte mbi këtë urë, ruhen gjurmë në themelet e themrës së djathtë dhe në një nga këmbët e mesit. Në thembrën e bregurt të djathtë shihen qartë shenjat e fillimit të qemeri prej guri. Qemeri ka qenë i ndërtuar me blloqe të punuara gëlqerorë me trashësi 20 – 35 cm lidhur me llaç gëlqere (fig. 22). Konstruksioni i tij qe zgjidhur me dopio qemer, i poshtmi me trashësi 72 cm e i sipërmi 52 cm. Koha e ndërtimit të Urës e Qukësit është në shekullin e I, kur ishte mjaft e përhapur teknika e ndërtimit të urave me qemere me blloqe guri të punuara[22]. Ajo u përdor dhe pas pushtimit romak. Në themrën e djathtë dhe në këmbët e mesit duken



Fig. 22

22) P. Gazzola, ven. cit. 129.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

faza ndërtimi të kohëve më të vona, ndoshta të periudhës bizantine. Tek ne, ura romake me blloqe të punuara janë: ura e Bashtovës e degës jugore të Egnatias, ura e Vjosës në Tepelenë dhe ura e Topçiasit në Elbasan.

Rruga e luginës së Shkumbinit, me drejtim nga Durrësi në Bizant, e njohur me emrin rruga e Kandavisë gjatë antikitetit dhe rruga Egnatia në periudhën e pushtimit romak, vazhdon të punojë dhe në mesjetë. Burimet dokumentare përmendin funksionin për qëllimet e ekspeditave ushtarake të kësaj rruge në intervale kohe të ndryshme. Gjatë shekujve V – VI në rrugën e Shkumbinit kaluan invazionët barbarë[23], kurse në shekullin e XI kaluan fiset normane dhe kryqëzatat[24]. Po në shekullin e XI, perandori i Bizantit, Vasili i II, marshoi gjatë kësaj rruge kundër pushtuesve bullgarë[25]. Në fund të shekullit XI Aleks Komneni udhëtoi në këtë rrugë për në lindje[26], duke pushuar pak në malin e Babjes. Komandanti bizantin, Gjergj Akropoliti, në vitet 1257 – 58 lëvizi gjatë kësaj rruge për të shtypur kryengritjet arbëreshe[27]. Nga një dokument i vitit 1308 del se «nga Durrësi, nëpërmes Arbërisë mund të kalosh në rrugë.»[28] Të gjitha këto burime bëjnë fjalë për shfrytëzimin në mesjetë të rrugës Egnatia edhe për qëllime strategjike ushtarake.

Ndërtimet e periudhës bizantine në rrugën e luginës së Shkumbinit janë të pakëta, pasi kalldrëmet dhe veprat e artit të rrugës para bizantine u trashëguan në gjëndje të mirë teknike. Ngjitur me urën turke tek përroi i Vilzës, në dalje të fshatit Xhyrë-Mal ruhet një riparim, ose më saktë, një trakt kalldrëmi, i cili duke u mbështetur edhe në teknikën e murit mbajtës, mund të jetë kalldrëm i periudhës bizantine.

Në mbështetjen e djathtë të urës së Haxhi Beqarit ruhen riparime të kohëve të ndryshme, ndoshta dhe nga periudha bizantine. Tek ura e Qukësit, në mbështetjen e djathtë, dallohen rrënoja të një qemeri me blloqe guri të periudhës romake. Mbi të, pas rrëzimit të tij, është ndërtuar një qemer tjetër (sot i rrëzuar) me gurë më të hollë, të zinj, 12-17 cm të lidhur me llaç, fakt që flet për mendimin tonë, për një riparim të urës së periudhës bizantine. Riparimet dëshmojnë për funksionin e rrugës së Shkumbinit edhe gjatë mesjetës.

Gjatë mesjetës paralel me rrugën Egnatia fituan rëndësi rrugë të tjera të brendshme si: rruga e luginës së Osumit, rruga e Devollit, rruga Tiranë-Dibër, ku nuk mungojnë dhe fortifiikmet mesjetare. Rruga më strategjike ishte ajo e luginës së Devollit, e cila duke qenë se kalonte në një terren tepër të vështirë, gjatë periudhës turke[29] nuk u përdor më.

Rruga e luginës së Shkumbinit vazhdoi përsëri funksionimin e saj gjatë shekullit të XV, me pushtimin e Shqipërisë nga turqit pas vdekjes së Skënderbeut. Me rindërtimin e kalasë së Elbasanit[30] në vitin



Fig. 23

23) Historia e Shqipërisë, V. I. 1967, 141.
24) Po aty, 179 – 79.
25) Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë, shek. X-XV, 1975, fq. 34,
26) Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, V, II, shek. VIII-XV, 1962, 47,
27) Po aty, 89.
28) Po aty, 110.
29) A. Ducellier, La place de l'Albanie dans les circuits comerciaux në La façade de l'Albanie au Moyen Age, Thessaloniki, 1981, 75.
30) Gj. Karaiskaj, Kalaja e Elbasanit, Monumentet 1/1971, 1. 61.



Fig. 24



Fig. 25

1466 rruga e Shkumbinit përmendet përsëri[31]. Në të marshoi Sulltan Mehmeti II për ekspeditën e rrethimit të Krujës.

Po këtu, në verën e vitit 1537, kaloi Sulltan Sulejmani me trupat e tij, për të dalë në Elbasan e Vlorë[32]. Në vitin 1591 këndej kaloi ambasadori ve-



Fig. 26



Fig. 27

31) A. Baçe, **Vep. cit,** 62.

32) I. Zamputi, **Disa fletë të Historisë së Shqipërisë në periudhën** 1506-1574, B.U.SH.T. 2/1990. 3.

DO NOT COPY

nedikas Bernardi, i cili informon se duke kaluar nga Dardha në Përrenjas, Shkumbini kalohet mbi urë druri.[33] Nënkuptohet ura e Qukësit, qemeret e periudhës bizantine të së cilës në këtë kohë ishin rrëzuar.

Në mesin e shekullit të XVII Elbasani nëpërmjet karvaneve tregtare[34] kryente një volum të mirë tregtie me Korçën.

Me pushtimin turk disa fshatra të luginës së Shkumbinit në zonën e Polisit u ngarkuan me detyrën e derbenxhiut, të ruajtësit të grykave malore dhe të mirëmbajtësit të rrugës së luginës. Të tilla ishin fshati Polis (tek ura e Haxhi Beqarit[35]), Babja, Dardha, Xhyra, Rrajca në Përrenjas, etj.[36]. Në Qukës, Xhyrë, Dardhë dhe në Babje kishte hane për pushimin e karvaneve[37] (fig. 23).

Në aksin e rrugës së luginës së Shkumbinit vërehen shumë pak gjurmë ndërtimesh nga ana e pushtuesve turq. Ruhen pak trakte kalldrëmesh, apo ura, ose mure mbajtëse nga shekujt e parë të pushtimit turk. Me sa duket, në fillim, turqit shfrytëzuan kryesisht kalldrëmet e ruajtura nga rruga Egnatia dhe u mjaftuan vetëm me korrigjimin dhe zbutjen e pjerrësisë në pika të ndryshme, duke bërë kështu vende-vende devijime të reja.

Trakte kalldrëmesh, nga shekujt XVII-XVIII, të periudhës ruhen në fshatin Qershizë, matanë Babjes (fig. 24). Rreth 400 m në jug të Qershizës, mbi trasenë e Egnatias, janë riparuar rreth 200 ml kalldrëm me gurë kave. Ky kalldrëm në anën e djathtë kufizohet nga brezi anësor tipik i Egnatias, me gurë më të mëdhenj, me gjerësi 80 cm. Gjithë kalldrëmi është i gjerë 4,6 m (fig. 25). Gjurmë të tjera kalldrëmi të hershëm turk ruhen në Rrafjet e Spatharit (fig. 26). Kalldrëmi s'është shtruar mbi trasenë e rrugës Egnatia. Ai ishte ndërtuar me gurë kave me gjatësi rreth 200 m dhe gjerësi 4,5 m. Ky duhet të jetë më i vonë se ai i Qershizës, ndoshta në shekujt XVIII-XIX. Për arsye të pjerrësisë çdo 1,2 m janë ngritur breza tërthorë, në formë shkallore, për të penguar rrëshqitjen (fig. 27). Brezat me trashësi 15 – – 20 cm lartësohen 8 cm nga rrafshi i kalldrëmit. Kësaj kohe duhet t'i takojë dhe ura e Haxhi Beqarit,



Fig. 28

33) Burime të zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, V, III, 1962, 174.
34) A. Çaushi, Transporti në Elbasan gjatë shekujsh, Etnografia Shqiptare II, 1963, 144.
35) S. Pulaha, Pronësia feudale në tokat shqiptare, 1988, 372.
36) K. Luka, Klos, Këlcyrë, Dervan..., Etnografia Shqiptare 14, 1985, 275.
37) A. Boue, Recueil d'itinéraires dans la Turquie d'Europe, V, I. Vienne 1854, 268.

DOKUMENTOR

DOMOTORK



Fig. 29



Fig. 30



Fig. 31

të cilin Bueja, në mesin e shekullit XIX, e përmend si konstruksion me tri harqe guri[38].

Urën e Qukësit ai e gjeti vetëm me një qemer guri. Devijime të rëndësishme të rrugës së vonë turke, nga rruga Egnatia, vërehen në pjesën tek përroi i Gurrave të Zeza – Bregu i Kostanilit para Xhyrës, në pjesën pas bregut të Kostanilit – Hanet e Hoxhës – Xhyrë dhe matan Xhyrës deri tek Gurri i Mollës.

Në variantet e përmendura më sipër, vihen re, aplikime rrugore të përparuara. Mendojmë, se ato janë punimet e fundit që pushtuesit turq kanë kryer mbi trasetë e rrugës së luginës së Shkumbinit. Këto variante me gjerësi 6-6,5 m të ngjashme me rrugët e sotme. Muret mbajtës të tyre, siç shihen tek Hanet e Hoxhës kanë qenë mjaft të larta duke iu përshtatur terrenit. Ata janë ndërtuar me gurë mesatarë, pa lidhje llaçi. Shtresa e rrugës është vetëm me çakëll me trashësi 10 cm. Profili tërthor i rrugës në formë harku të shtrirë, në lidhje me rrafshin e trasesë, ngrihet 15 cm. Matanë Xhyrës, në rrugën e rregullt turke, ruhen dy tombino me seksion 64 x 72 cm dhe 43 x 78 cm (fig. 28). Të kësaj periudhe janë dhe dy ura, njëra me qemer guri me hapësirë 1,8 m (në Xhyrë) dhe tjetra me mbikalim druri, (para Xhyrës) me hapësirë drite 2,5 m (fig. 29). Në bregun e majtë të Urës së Haxhi Beqarit, shekulli XVIII, shihen qartë mure mbajtëse vertikale, të cilat mbrojnë nga gërryerjet rrugën me kalldrëm.

Rrugët e vona nuk kanë mure mbajtëse, por sistemim dherash nga ana e malit. Nga kjo anë kanë një kunetë ujërash të patrajtuar, me pllaka guri dhe vende – vende tombino të vogla për shkarkimin e tyre. Një e tillë, me seksion 50 x 50 cm, është ajo pranë urës së drurit të lartpërmendur. Variantet turke, të fillimit të shekullit tonë, janë të trasuara me instrument dhe ndjekin mirë vijat rrushkulluese. Nga Ura e Haxhi Beqarit deri tek Qafa e Dervenit në Babje vërehen plotësime të kryera nga ushtria italiane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këto janë: kalldrëme me aks të theksuar me gjerësi 3,3 m (fig. 30), ura betoni, mure mbajtëse betoni ose me gurë, etj. (fig. 31).

* * *

Rruga antike mesjetare e luginës së Shkumbinit, pjesë e rrugës së njohur Egnatia, ruan mjaft ndërtime rrugore të periudhave të ndryshme, që hedhin dritë mbi zhvillimin dhe funksionin historik të saj.

Traktet e rrugës së ngushtë, tek Gurrat e Zeza,

ndërmjet Dardhës e Xhyrës, përfaqësojnë rrugën ilire para rrugës, Egnatia.

Traktet e kalldrëmit të gjerë për kalim karrosh dhe qerresh në Çekrez të Dardhës, tek Hanet e Hoxhës, para Xhyrës, janë gjurmë tipike të rrugës Egnatia nga shekujt II p.e.s deri IV e.s. Pjesë të rrugës Egnatia janë dhe Urat e Haxhi Beqarit, Keçit, Gurrave të Zeza dhe Qukësit, të shekujve të parë të erës sonë.

Trasimi topografik i rrugës Egnatia, përgjithësisht, është optimal, përveç disa thyerjeve të forta në Qershizë, tek Bregu i Kostanilit, pranë Haneve të Hoxhës dhe tek përroi i Vilzës poshtë Xhyrës, etj.

Gjurmë ndërtimesh nga periudha bizantine vërehen, sot për sot, vetëm tek riparimet e kalldrëmit ngjitur urës turke me qemer tek përroi i Vilzës në Xhyrë, në riparimet e fazës së dytë tek qemeret e urës së Qukësit, mbi Shkumbin, dhe tek riparimet e urës së Haxhi Beqarit. Riparime të periudhës së hershme turke nga shekujt XVII-XVIII ruhen në Qershizë dhe Rrafjet e Spatharit.

Më shumë gjurmë ruhen nga traseja e periudhës së vonë turke, e cila për nga gjerësia e madhe, dhe kompleksiteti i veprave rrugore të jep përshtypjen e një rruge të realizuar gjatë fundit të shekullit të XIX dhe fillimit të shekulli XX. Gjurmimi, studimi dhe botimi i përbërësve të rrugës Egnatia, përgjatë territorit tonë, përbëjnë ndoshta një hallkë për një studim të plotë në të ardhmen.

DO NOT COPY

38) A. Boue, **Po aty,** 268.

Valter SHTYLLA, Lazër PAPAJANI

DO NOT COPY

DONNÉES TECHNIQUES SUR LA ROUTE DE LA VALLÉE DE SHKUMBIN EN ANTIQUITÉ ET AU MOYEN ÂGE.

RESUME

Sur la route de la vallée de Shkumbin, en tant qu'une partie de l'artère importante qui depuis l'antiquité reliait l'Europe à l'Asie Mineure, ont écrit de temps en temps plusieurs chercheurs et voyageurs autochtones et étrangers, la traitant du point de vue historique, archéologique, etc.

Cet article décrit les résultats de deux expéditions effectuées sur le terrain au cours des années 1988-1989, lesquelles avaient pour but de chercher et de mettre en évidence les particularités techniques de cette route.

La route de la vallée de Shkumbin a existé depuis l'antiquité illyrienne. L'habitat de Shënlliu près d'Elbasan et la cité à Qukës-Skënderbej, contrôlaient cette route depuis la première période du fer. La forteresse de Lleshan, l'habitat de Gradishtë, de Dumre et la forteresse de Dorsi, se situaient aux ramifications méridionales et septentrionales de cette route. Plus tard, au cours de la période urbaine illyrienne, Shenlliu, la forteresse de Saragu, l'habitat de Xibrakë et de Selca e Poshtme, témoignent du fonctionnement de la route de Shkumbin pendant la période urbaine illyrienne.

La forteresse de Vila, la tour de Gracan, la forteresse de Dorsi au nord et les villages Gradisht, Kamunak, Lleshan et Veleshi, contrôlaient les ramifications de cette route pendant la période urbaine illyrienne. La route antique de la vallée de Shkumbin, avant l'occupation romaine était connue par le nom la route de Kandavl.

A côté du torrent Gurrat e Zeza, entre les villages Dardhë et Xhyrë, sont conservées des traces de cette route. Il s'agit d'un fragment d'une longueur de 30 m et d'une largeur qui varie de 1, à 1,8 m selon le terrain. Le pavé qui est fait en pierres de différentes dimensions 60x90 cm, 45x60 cm, 20x45 cm etc) du côté du torrent est protégé d'un mur de soutènement réalisé en blocs de pierres. La construction de ce pavé remonte à la première période du fer. La dernière étude d'un grand fragment du mur de soutènement de la route Kroi i Shelgut à Qafë Thanë, fournit un témoignage important concernant le fonctionnement de la route de la vallée de Shkumbini pendant l'antiquité. C'est un fragment d'une longueur de 55 m et d'une hauteur de 3 m, composé en blocs de pièrres irréguliers qui ne se joignent pas bien. Le fragment du mur de soutènement à Qafë Thanë situé en dehors de la vallée, temoigne que la route de Kandavi n'était pas seulement une route de la province illyrienne mais elle allait plus loin parce qu'elle reliait cette province aux contrées de la Macédoine et à d'autres contrées situées plus loin.

Le pavé étroit de 1,2 à 1,8 m réalisé en grandes pierres aplaties à surface convexe se rencontre à la vallée de Shkumbin où, au cours de la période préurbaine et urbaine fonctionnait le route de Kandavi, entre Kotorr et Solthuas, habitats du tribu illyrien des Docléates et à la route de Gruemire.

Après l'occupation de l'Illyrie par les romains au IIe sc. av.n.e., la route de la vallée de Shkumbin devint une partie de l'importante route militaire et commerciale qui reliait l'Europe Occidentale à l'Asie Mineure et puis au Moyen Orient.

Partant de Durrës, les premières traces de la route Egnatia dans nos contrées se rencontrent au village Qeret de Kavaja, où à une profondeur de 5 m ont apparu les traces d'un pavé large de 4 ou 5 m fait de grandes pierres aplaties, Ensuite, avant d'entrer à Scampis (Elbasan) sur la route de la vallée de Shkumbin, qu'on va appeler Egnatia, au village Bradashesh, il y a une station in Ad Quintum où sont conservées les traces d'un bain romain du II sc. Plus loin les traces de la route Egnatia apparaissent au pont de Haxhi Beqari qui assure la communication entre le village Mirakë et la zone de Polisi. Au pont de Haxhi Beqari, la route Egnatia passait de la rive droite à la rive gauche de Shkumbin, en entrant dans les montagnes de Polis nom actuel ou de Kandavi, comme on les appelait à l'antiquité. Au pont de Haxhi Beqari, à la culée de la berge droite, sont conservées les traces d'un pont romain sur la route Egnatia.

A la chaine des montagnes à gauche de la rivière de Shkumbin, du pont de Haxhi Beqari jusqu'au pont de Quksi, se distingue partout le tracé de la route Egnatia. Il y a de petites déviations devant Qafa e Dervenit, à Babje, à Bregu i Kostanilit, aux auberges de Hoxha avant d'entrer à Xhyre, à la sortie de Xhyre etc. En poursuivant les habitats dans

DO NOT COPY

le segment de la route le long des montagnes de Polis, le tracé de la route Egnatia traversait ces points: le pont de Haxhi Beqari, Qafa e Dervenit, à Babje, Qershizë, Bregu i Sqepurit, Bregu i Kostanilit, Xhyrë, Guri i Kollës, Guri i Shqipes, Qukës Skënderbej, rivière de Shkumbin, Qukës, Des traces de pave, de mur de soutènement et de pont, sont conservées seulement après les villages Babje et Spatharë.

Tout d'abord des fragments de pavé de cette route, à une longueur de 50 m et une largeur de 5,5 m se trouvent a Cekrez de Dardha. Dans le fragment Dardha Xhure, aux ruines des auberges de Hoxha, se conservent les plus distinctes traces de la route Egnatia. Dans la partie la mieux conservée, sur une longueur de 4 m on discerne la technique typique de la route Egnatia et celle des routes romaines en général.

A Xhure Mal, à la suite du pont turc on remarque une couche de pavé d'environ 50 m de long à une largeur de 3,5 m, réalisé par une technique qui diffère de celle de la route Egnatia. On ne distingue pas de bordures régulières latérales et les pierres du pavé ne sont pas très grandes comme celles de la rue Egnatia. La technique du mur de soutènement du côté du torrent de Vilza ressemble à celle de la route Egnatia à côté du torrent Gurrat e Zeza. Ce fragment du pavé correspond à celle du tracé de la route datant de la période turque. Peut être dans ce cas on a à faire à un aménagement de la route Egnatia à une autre époque, après les IIe-Ie sc. quand la route de la vallée de Shkumbin, en tant qu'une partie de la route Egnatia fut complétée d'oeuvres d'art routières.

Enfin, la dernière oeuvre d'art de la route Egnatia le long des montagnes de Polis, fut le pont de Qukës sur la rivière Shkumbin. Il se trouve vers 300 m devant le centre de Qukës, au bord de la route nationale actuelle Elbasan-Korçë. On distingue des traces de ces piliers et de ces culées. Il s'agit d'un pont d'une longueur de 70 m et d'une largeur de 3,7 m, qui reposait sur trois arches à une travée de 15 ou 16 m. Du pont de la période de la route Egnatia sont conservés les fondations de la culée droite, et l'un des pilliers du milieu, renversé dans la rivière.

La route de la vallée de Shkumbin allant de Durrës à Byzance, en antiquité connue par le nom la route de Kandavi, et pendant la période de l'occupation romaine, par le nom, Egnatia fonctionne encore au moyen âge.

Du point de vue technique, il y a eu très peu de constructions de la période byzantine à la route de la vallée de Shkumbini, étant donné que le pavé et les oeuvres d'art de cette route furent hérités en un très bon état et leur traces existent même aujourd'hui.

La route de la vallée de Shkumbin fonctionna intensivement au cours du XVe sc avec l'occupation de l'Albanie par les turcs. En 1466 avec la reconstruction de la forteresse d'Elbasan, on mentionne de nouveau la route de Shkumbin.

Dans le village Qershize au delà de Babje, sont conservés des fragments de pavé des XVII-XVIIIe sc. La route tardive turque subit des déviations importantes de celle Egnatia au torrent Gurrat e Zeza à Bregu i Kostanilit avant Xhyra, aux auberges de Hoxha à Xhyra, et plus loin jusqu'à Gurri i Mollës.

Aux variantes aménagées, déjà mentionnées, on remarque des aplications routières avancées. Ces variantes ont dû être réalisées au cours des années 1908-1909, avant la proclamation de l'Indépendance. A une largeur de 6-6,5 m, elles ressemeblent aux rues actuelles. Ces routes sont, munies de murs de soutènement assez hauts au bord des grands précipices, comme p.ex. aux auberges de Hoxha.

Le long de la route antique mediévale de la vallée de Shkumbin, qui n'est qu'un fragment de la route Egnatia, sont conservées maintes constructions routières appartenant à de différentes périodes, qui jettent de la lumière sur son evolution et son fonctionnement historique.

Les fragments de l'étroite route à Gurrat e Zeza entre Dardha et Xhyra appartiennent à la route illyrienne antérieure à celle Egnatia.

Les fragments du large pavé à Cekrez de Dardha aux auberges de Hoxha avant d'arriver à Xhyra, sont des traces typiques de la route Egnatia du IIe sc. av.n.è. jusqu'au IV sc. Les ponts Haxhi Beqari, Keçi, Gurrat e Zeza et Qukësi, qui datent des premiers siècles de notre ere, sont des fragments de la route Egnatia.

Actuellement on trouve des traces de constructions de la période byzantine au pavé réparé près du pont qui traverse le torrent de Vilza à Xhyre aux parties des voûtes réparées pendant la deuxième phase du pont de Qukësi à Shkumbin, aux parties réparées du pont Haxhi Beqari. Des réparations effectuées pendant l'ancienne période turque des XVIIe-XVIIIe sc sont conservées à Qershize, et à Rrafjet e Spatharit.

Les plus nombreuses traces conservées sont celles de la route construite pendant la période tardive turque. La largeur, la complexité des oeuvres d'art routières ainsi que son profil longitudinal optimal tout comme celui des routes actuelles de la fin du XIXe sc et du début du XXesc. Les recherches effectuées sur les composants de la route Egnatia le long de notre territoire représentent un chainon d'une etude future complète sur cette route importante transbalkanique.

DO NOT COPY

RRUGA E VJETER E LUGINES SHKUMBINIT · VIA EGNATIA



SHK. 1:2500C

DO NOT COPY


Shkumbini
Bregu Konstandinit
Xhyra Frashërit
Xhyra Bushit
Guri Kalase
Xhyra
Kamina
Guri Kokutës
Guri Bletës
Guri Mollës
Qukës Skënderbej
1093.7
Guri Sukullit
burime
Rruga Automobilistike
Elbasan - Korçe
Lumi Shkumbinit
QUKES
Tres Tabernae
LEGJENDA
TRASEJA E RRUGES EGNATIA
KALLDREM I RRUGES KANDAVIA
KALLDREM I RRUGES EGNATIA
KALLDREM I PERIUDHES TURKE
MUR MBAJTES I RRUGES KANDAVISE
MUR MBAJTES I RRUGES EGNATIA
MUR MBAJTES I RRUGES SE PERIUDH. TURKE
RRENOJE URE HARK E RRUGES EGNATIA
URE GURI ME HARK I PERIUDHES TURKE
URE ORURI E PERIUDHES TURKE
TOMBINO E RRUGES SE PERIUDHES TURKE
HAN I PERIUDHES TURKE
KARAKOLL RRUGOR I PERIUDHES TURKE
STACIONE QYTETE RRUGES EGNATIA

DO NOT COPY

Nr. 1 1990

monumentet

DO NOT COPY

Shpresa PRIFTI

SHTËPIA E ZJARRIT NË BANESËN SHKODRANE TË SHEK. XVIII-XIX DHE ELEMENTET ARKITEKTONIKE TË SAJ[1])

Ky artikull, i cili është pjesë përbërëse e studimit tipologjik, synon në trajtimin më analitik e më të thelluar të njësisë bazë kompozicionale të banesës, shtëpisë së zjarrit, si dhe të elementeve të veçanta të saj.

Shtëpia e zjarrit, e cila përbën mjedisin më të vjetër, si mbarë banesa ka një zhvillim të dallueshëm në kohë, që është pasqyrues i mënyrës së të jetuarit[2]. Analiza e tri përbërësve të saj thelbësorë, funksionit, vendit në kompozim, si dhe trajtimit të brendshëm, lidhet me faktorin e formacionit ekonomiko-shoqëror, si dhe shkallën e zhvillimit të qytetit të Shkodrës, në të cilën lindi dhe u zhvillua kjo banesë. Deri rreth mesit të shekullit të kaluar në Shkodër, e parapëlqyer nga shtresat e borgjezisë në lindje dhe atyre me origjinë çifligare, u ndërtua në masë të gjerë në variante të ndryshme të saj banesa e hapur me çardak.

Shtresa e re e popullsisë qytetare, që merrej me tregti e zejtari, ishte ende e lidhur me tokën.[3]. Si e tillë ajo nuk mund t'u shmangej kërkesave që kushtëzoheshin me lidhjen e ngushtë të qytetit me ekonominë bujqësore, kërkesa të cilat duhet të gjenin zgjidhje brenda kuadrit të banesës, që për atë kohë nuk qe vetëm një strehë banimi. Kjo e bën të shpjegueshme përhapjen e tipit të banesës me çardak, e cila në konceptimin dhe kompozimin e saj u përgjigj më së miri këtyre rrethanave.

Në banesën shkodrane, duke filluar prej variantit më të thjeshtë, me numër të paktë mjedisesh, deri tek ai më i zhvilluar, me një numër më të madh mjedisesh, shtëpia e zjarrit përbën mjedisin bazë të banesës, duke luajtur rol kryesor në të. Ajo paraqet në vetvete një njësi kompozicionale të pavarur nga mjediset e tjera. Zanafilla e saj duhet kërkuar që në fazat më të hershme të banesës, ku ajo konceptohet me një kthinë të vetme, në të cilën kryheshin të gjitha funksionet e nevojshme për jetën e një familjeje. Elementi më i rëndësishëm, i saj, rreth të cilit organizohej jeta, ishte vatra ku ndizej zjarri. Me zhvillimin e banesës, mjedisi i quajtur «shtëpi zjarri» fiton emërtime të reja si «odë zjarri», «akshihane». Pavarësisht nga emërtimet e ndryshme ne do të përdorim në artikull emërtimin tradicional «shtëpi zjarri».

Shtëpinë e zjarrit në banesën shkodrane mund ta ndajmë në dy grupe. Në të parin hyjnë realizimet deri në vitet 40-50 të shek. XIX. ndërsa në të dytin ato që përfshijnë gjysmën e dytë të shek. XIX. Ky klasifikim përkon dhe me klasifikimin tipologjik të banesës shkodrane.

Në banesën shkodrane, shtëpia e zjarrit, përgjithësisht, ka formë katërkëndëshe, me raport të brinjëve që variojnë në kufijtë 1 : 1,1 m deri 1 : 1,4 m dhe lartësi 3-3,5 m. Në krahasim me mjediset e tjera të banesës, madhësia e saj, nuk ndryshon ndjeshëm.

---

1) Rilevimet janë kryer nga autori, F. Zarshati, B. Penxha, vizatimet janë të S. Terezit, fotot të H. Çollakut e R. Veselit.

2) E. Riza, **Shtëpia e zjarrit në banesën qytetare shqiptare.** Etnografia shqiptare Nr. 14.

3) E. Riza, **Banesa popullore në Shkodër gjatë shek. XVII-XIX.** Monumentet Nr. 4/1972.

DO NOT COPY

Ajo mund të jetë më e madhe ose më e vogël se ato, e variueshme nga 10 m^2 deri 46 m^2, që janë pak a shumë dy ekstremet e saj. Në variantin e thjeshtë, me dy mjedise banimi në kat, shtëpia e zjarrit (krahas odës së miqve, me funksione të përcaktuara qartë) përfshinte të gjitha funksionet e tjera, siç ishin ai i përgatitjes së ushqimit, i ngrënies, i vendqëndrimit, pjesërisht ai i fjetjes dhe ai i ndërlidhjes së brendshme. Në mjaft raste, në stinën e ftohtë të dimrit, kur çardaku dilte i papërshtatshëm, mjedisi i shtëpisë së zjarrit shërbente dhe si vend për përgatitjen e produkteve të ndryshme ushqimore. Shpesh këtu punohej edhe me vegje.

Shumëllojshmëria e funksioneve të shtëpisë së zjarrit e vendosin atë në vendin qendror në banesë, gjithmonë në krah të mjedisit të odës së miqve (fig. 1 a,b,c,d). Në zgjidhjet a,b, ajo është në variantin me çardak në gjithë ballin, në zgjidhjen c në variantin me çardak në një krah dhe në zgjidhjet d, në variantin me çardak në qendër.

Me shtimin e mjediseve të banimit, shtëpia e zjarrit, humbet përherë e më tepër funksionet e saj fillestare. Mjediset e shtruara një ose më shumë, sipas shkallës së zhvillimit të banesës, e çlirojnë atë nga funksioni i fjetjes dhe pjesërisht nga ai i ndenjjes. Vihet re një ndërlidhje e drejtë midis zhvillimit të varanteve të banesës shkodrane dhe zvogëlimit të funksioneve të shtëpisë së zjarrit, dukuri e cila shpreh kalimin nga banesa me pak mjedise e shumë funksione në banesën me shumë mjedise e pak funksione.[4]

Lidhja e marrëdhënieve të reja kapitaliste, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, solli fuqizimin ekonomik të qytetit. Krijimi i shtresës së re të borgjezisë zejtaro-tregtare, largimi përherë e më i madh nga ekonomia bujqësore, marrja e gatshme e shumë produkteve ushqimore, rritja e shkallës së kërkesave, për një jetë më të kulturuar, janë shkaqet e humbjes, gjithnjë e më tepër, të rolit kryesor të shtëpisë së zjarrit. Pozicioni i saj zhvendoset nga vendi i zakonshëm tradicional, prapa mjediseve të banimit, duke ruajtur përgjtthësisht ndërlidhjen e saj me çardakun. Pozicioni i ri i shtëpisë së zjarrit takohet në variantet e zhvilluara të banesës shkodrane (fig. 10 f.)

Vendi i saj në kompozim, duhet parë gjithmonë në lidhje me çardakun. Kur vendi i saj është qendror ndërlidhjen me çardakun e takojmë kryesisht në tri zgjidhje. Në zgjidhjen e parë (fig. 2 a) hyrja është nga çardaku, në zgjidhjen e dytë (fig. 2 b) ajo realizohet nëpërmjet tamburit të ulët, të krijuar nga ekzistenca e trapazanit dhe në zgjidhjen e tretë (fig. 2 c) ajo realizohet nëpërmjet rruginës në krah të saj. Për shtëpitë e zjarrit të grupit të dytë, ku ajo është e vendosur pas mjediseve të banimit, përgjithësisht, ndërlidhja realizohet nëpërmjet rruginës, e cila fillon prej çardakut e mbaron në shtëpinë e zjarrit (fig. 2 d). Kjo është një zgjidhje mjaft funksionale e njëherazi komode, për faktin se në stinët e ftohta në shtëpinë e zjarrit, sigurohet një temperaturë konstante. Në zgjidhjet a, b, c, d, ku kjo ndërlidhje konsiderohet e drejtpërdrejtë, shtëpia e zjarrit ka vendin qendror në banesë, rrjedhimisht dhe roli i saj në të është kryesor. Në zgjidhjen e fundit kjo ndërlidhje nëpërmjet rruginës bën që ajo të mos jetë direkte me çardakun. Ky faktor i rëndësishëm, i humbjes së lidhjeve direkte me çardakun, tregon se tani ky mjedis, i cili njëherazi ka humbur dhe vendin qendror në banesë, nuk është i ndonjë rëndësie të veçantë, por është thjesht një mjedis ndihmës i banesës. Humbja e funksionit të banimit duhet konsideruar si shkaku i parë i largimit të shtëpisë së zjarrit nga vendi tradicional. Kjo përbën një dukuri të cilën e takojmë përgjithësisht në banesën qytetare shqiptare.

Funksioni i ndërlidhjes së brendshme, merr përparësi në variantet e zhvilluara të banesës shkodrane, kur vendi i shtëpisë së zjarrit është qendror. Në variantin e thjeshtë, me dy mjedise në kat, kjo ndërlidhje kryhet me odën e miqve dhe anekset ndihmëse të banesës. Në variantet e zhvilluara me disa mjedise në kat, roli i saj ndërlidhës rritet, ajo ndërlidh një ose më shumë mjedise, duke ruajtur gjithnjë lidhjet me mjediset ndihmëse. Shpesh shtëpia e zjarrit komunikon nëpërmes shkallës së drunjtë, mbuluar me një kapak druri, dhe me mjedisin poshtë saj, ahurin.

Për trajtimin kompozicional dhe analitik të shtëpisë së zjarrit duhet të ndalemi tek elementet e veçanta përbërëse funksionale e arkitektonike të saj të cilat janë: 1) vatra, 2) kompleksi musandër-trapazan, 3) dollapët, 4) dyert, 5) tavani, 6) furra, 7) sqolli, 8) sergjia.

1) Vatra — vendi i zjarrit

Funksioni më jetëgjatë i shtëpisë së zjarrit, që e ndoqi atë gjatë gjithë zhvillimit të saj, qe ai i gatimit. Kjo dukuri gjen shprehje edhe tek vetë emërtimi «shtëpi zjarri».

Vatra është elementi i parë i rëndësishëm që merr pjesë në formulimin e brendshëm të këtij mjedisi, bashkëudhëtare e pandarë e tij. Pozicioni i vendosjes së saj kushtëzohej nga funksionet dhe mëny-

4) E. Riza, **Shtëpinë e zjarrit në banesën qytetare shqiptare.** Etnografia shqiptare Nr. 14.



Fig. 1

DO NOT COPY

DO NOT COPY

ra e ndërlidhjes së saj me mjediset e tjera. Ky pozicion, me evolimin e shtëpisë së zjarrit, ka lëvizur, nga mesi i mjedisit, përbri njërit nga muret perimetrale[5]. Rëndësia e këtij elementi dhe kompleksiteti i veprimtarisë së tij i japin vendin kryesor të mjedisit. Kështu, ai, përgjithësisht, vendoset në faqen e djathtë, ose në faqen përballë hyrjes, duke rezervuar gjithnjë vendin më spikatës. Faqja ku vendoset vatra rrallë qëllon të dalë në çardak.

Kalimi i vatrës përbri njërit prej mureve perimetrale, duhet parë si një zhvillim i lartë, me pikësynim tërheqjen e organizuar të tymit[6]. Kjo vatër e re, me kërkesa të reja për kohën, sjell në vetvete ndërtimin e kanalit tymtërheqës, i cili në bashkëmarrëdhënie me vendin e zjarrit, koncepton tashmë një vatër të re. Format dhe realizimi i saj ndryshojnë nga mundësitë ekonomike të pronarit.

Duke u nisur nga shembuj konkretë mund të bëjmë një ndarje të përgjithshëm të vatrave:

1 — vatra të thjeshta, 2 — vara me tymar, 3 — vatra të përbëra. Ndarja e parë, i përket realizimeve të kryera deri në vitet 40-50 të shek. XIX, e treta realizimeve të kryera gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, ndërsa ndarja e dytë duhet konsideruar tranzitore mes dy periudhave të mësipërme.

Vatrat e thjeshta, lidhur me bashkëveprimin e kanalit tymtërheqës dhe vendin e zjarrit i ndajmë në: vatra të cilat kanë të kompozuar vetëm kanalin tymtërheqës, ndërsa zjarri ndizet në gropën pranë saj dhe vatra me kompozim të vendit të zjarrit. Në rastin e parë tymari mund të jetë gjysmë rrethor ose katërkëndëshkëndrejtë me përmasa të ndryshme. Ai, në pjesën e sipërme, ngushtohet në formë konike. Vatra me kompozim të vendit të zjarrit është hapi i parë i formimit të saj si objekt në vetvete. Ajo krijon mundësinë e realizimit të vendit të zjarrit në forma të ndryshme, mjaft të thjeshta, a të ngritura nga dyshemeja e mjedisit, që mund të jenë, elemente të veçanta ose një bllok i vetëm.

Në zgjidhjen e parë (fig. 3, a) vatra i përket viteve 1760[7] dhe është një nga zgjidhjet më të thjeshta e njëherazi më primitive. Hapësira e kanalit tymtërheqës me seksion gjysmë rrethor është një e plotë. Bri saj ndodhen dy kamare të vogla. Në zgjidhjen e dytë (fig. 3,6 fig. 4) hapësira e kanalit tymtërheqës në pjesën e poshtme është e ndarë nga një

Fig. 2



5) Po aty.

6) Po aty.

7) Sh. Prifti, **Një banesë karakteristike e datuar në qytetin e Shkodrës** «Monumente historike në vendin tonë», Tiranë 1978.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4



Fig. 4

shtresë, e cila ka shërbyer për vendosjen e enëve të gatimit.

Funksioni i vatrës plotësohet me të ashtuquajturin shtrat i ndërtuar me binarë, mbi të cilin, zakonisht, thahej mishi. Mbi vatrën, lidhur tek trarët e tavanit, varej kamostra[8]. Ky instalim i rrallë për kërkesat e tij, i gjetur dhe i ruajtur mjaft mirë, mendojmë se është përdorur dhe në banesa të tjera të asaj kohe. Në zgjidhjen e parë (fig. 5a), kemi të bëjmë me vatër me kompozim të vendit të zjarrit. Insta-

8) E. Riza, **Banesa poullore në Shkodër gjatë shek. XVIII-XIX,** Monumentet 4/1972.

DO NOT COPY



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6

limi i vendit të zjarrit është i zgjidhur nga katër bordura të ngritura nga dyshemeja. Në zgjidhjen e dytë (fig. 5b) ky instalim punon si një bllok i vetëm me dy të thelluara. Zgjidhja e tretë (fig. 5c) është një rast disi i veçantë. Këtë instalim e gjejmë me të perparuar, pasi mbi shtresën ndarese është ndërtuar një llloj furre e vogël, kompozimi i së cilës e bën të pakuptuesnme funksionin e vertetë të saj.

Çdo Nopça e ka venë re këtë instalim që rezervonet me të arejte ta quaje tymar[9]. Tek vatrat me tambur, të naertuara gjatë gjysmes së parë të shek. XIX (fig. 6), venai i zjarrit pajiset me një tambur me seksion katerkendesh kënarejtë, i cili i bashkengjitet kanalit tymterneqës në lartësinë 1,70 – 1,80 cm nga dysnemeja. Ai naertonet me skelet tnuprash, suvatuar ne anen e jasntme, e mbajtur nga dy binare te fiksuar tek traret. venai i zjarrit ka zgjidhje të naryshme.

Vatra te përbera do të quajmë ato vatra të ciiat kane perparuar ne tekniken e ndërtimit dhe kompozimin e tyre veçanerisnt najesnem në formen e zgjianjes se venait te zjarrit. Ne të shumtën e rasteve, këto vatra kane aranur si pasojë e modifikimit te venait te zjarrit ne kuadrin e naryshimeve që peson banesa shkodrane gjatë gjysmës së dyte të shek. XIX. Sipas rastit, vendi i zjarrit, muna te jete nje volum i vetem ose dy, të mbivene njëri mbi tjetrin, me funksione perkatese te naezjes së zjarrit, te gatimit ose te pjekjes, duke qene tamburi pjese perberese e panaare e tyre. Ne zgjidhjen e parë (fig. 7a) venai i zjarrit formonet nga dy volume katerkendesne te mbivenë njeri mbi tjetrin. Volumi i poshtem sherbente per naezjen e zjarrit dhe i sipermi per pjekje. Tamburi i varur përrsnin gjithë sipertaqen e vendit të zjarrit posnte tij. Në zgjidhjen e dytë (fig. 7b), naertimi i vitit 1864[10], venai i zjarrit është mjatt komod per kohën. Furra është zëvendësuar nga platforma e gatimit, e cila mbështetet mbi volumin katerkendesn te vendit të zjarrit. Kompozimi i tij me dy vatra për ndezjen e zjarrit, si dhe ndërtimi perballë i një dritareje të vogël për largimin e ererave të gjellës e bën mjatt funksonal dne njeherazi komod per kushtet e asaj kohe, duke iu arruar mjatt konceptit të sotëm të sobave. Tamburi ka përmasa mjatt proporcionale. Ai është i pajisur me fashatura të gdhendura dhe binarë të daltuar, suvatuar dhe në faqet e brendshme. Realizimi i arritur teknikisht, me përkujdesje të pakëta estetike, është një hap pozitiv për shtëpinë e zjarrit në drejtim të rritjes së vlerave estetike të saj që tregon se këto mangësi po korrigjoheshin në kushtet e reja të jetës. Në zgjidhjen e fundit (fig. 2 d) vatra relati-

9) Po aty.

10) Datimin e gjejmë në fashaturën e dritares, shtesë e mëvonshme, të shtëpisë së zjarrit të banesës së Luigj Gurakuqit.

DO NOT COPY



Fig. 7

visht e re, nuk ka tambur. Ajo trajtohet në formën e një podiumi të ngritur, pjesa e poshtme e të cilit shërben për ndezjen e zjarri, ndërsa sipër ndodhen 4 vatra zjarri. Pra shihet prirja drejt konceptit të sobës së mirëfilltë. Rastet e mësipërme tregojnë se edhe elemente të veçanta të shtëpisë së zjarrit, siç është vatra, pësojnë evolucion ashtu si dhe shtëpia e zjarrit. Bashkekzistenca në të njëjtën kohë e të dy formave të vatrës, asaj të thjeshtë dhe të përbërë, është shprehje e diferencimit klasor.

Kompleksi musandër – trapazan është një element arkitektonik, të cilin e takojmë rrallë në formulimin e brendshëm të shtëpisë së zjarrit. Ky kompleks ndërtohet, gjithmonë në faqen tërthore, përballë ose në krah të vatrës. Si kompozim arkitektonik, ai formohet nga dy volume të mbivëna në lartësitë respektive 2,20-2,30m dhe 1,10-1.20m. Volumi i poshtëm përbëhet nga dy parahyrje anësore, që lidhin shtëpinë e zjarrit me çardakun e mjedisin e banimit e anekset ndihmëse, dhe pjesën qëndrore që zë musandra, e cila sipas rastit është e mbyllur krejtësisht në formën e një perdeje dërrase, ka formën e një dollapi, ose është e hapur nga mjedisi. Pjesa e sipërme, trapazani, përbën një volum të vetëm, të mbyllur ose të hapur nga ana e mjedisit. Ngjitja për në këtë volum kryhet përmes kapanxhes që lidhet me shkallë druri. Musandra luan funksionin e vendit të ruajtjes së shtresave e pajisjeve të tjera të banesës. Ndërlidhja e saj me trapazanin e odës së miqve jepte mundësinë që gratë dhe vajzat e shtëpisë të qëndronin tek trapazani i odës së mirë për të parë se ç'bëhej aty.

Në zgjidhjen e parë (fig. 9a) volumi i pjesës së poshtme vjen dhe thyhet në dy skajet anësore të tij tek dyert duke dalë para. Gjithë kompleksi trajtohet i mbyllur me dërrasa të afruara vertikalisht, me gjerësi 20-23 cm, të konturuara me dërrasa horizontale. Gjithë trajtimi i këtij kompleksi është shumë i thjeshtë, pa asnjë pretendim dekorativ. Forma, teknika dhe trajtimi i varfër estetik i kompleksit musandër-trapazan, në analogji me vetë formulimin e brendshëm të shtëpisë së zjarrit, na bindin se ai është një element po aq i vjetër dhe i njëkohshëm me të. Evoluimi i shtëpisë së zjarrit, lidhur ky me zhvillimin apo rikonstruksionin që ajo pëson gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, pranon forma më të përparuara. Në zgjidhjen e dytë (fig. 9b). Ky kompleks përbëhet nga një dollap, mbi të cilin kalon një platformë që kap krejt faqen kundruall oxhakut e vazhdon deri në mesin e faqes tjetër. Platforma ka shërbyer për depozitimin e produkteve ushqimore. Ndërtimi i saj mendojmë se është i një faze të mëvonshme.[11]

Kur shtëpia e zjarrit zhvendoset pas mjediseve të banimit, volumi trapazan-musandër vendoset në fa-



Fig. 8

11) Banesa është e datuar në vitin 1806, datë e vendosur në portën e jashtme të banesës, por gjendja e sotme është faza e dytë e zhvillimit të saj.

DO NOT COPY

qen e hyrjes, përpendikular me rruginën, e cila kryen lidhjen me çardakun. Në këtë rast, trapazani trajtohet në formën e një platforme që del në këtë faqe, kurse musandra përbehet nga një ose dy dollape të vendosur në krah të hyrjes. Me zhvillimin e banesës, si pasojë e numbjes së funksionit të ndenjjes në shtëpinë e zjarrit, volumit musandër-trapazan i bie gjithnjë e më tepër vlera, duke shkuar drejt eleminimit të tij.

Në variantet e thjeshta, kur shtëpia e zjarrit ka vendin qendror, në rastin kur faqja tërthore nuk trajtohet me volumin musandër-trapazan, ajo gjithmonë është një perde e ndërtuar me struktura të lehta, mjart primitive. Në shpinë e zjarrit (fig. 3 b), perdja ndarëse me rruginën e mjedisit në krah është realizuar me dërrasa të puthitura vertikalisht, të fiksuara në një sistem binarësh. Në këtë faqe janë të vendosura tri radhë sergjish. Në shtëpine e zjarrit (fig. 3 a) perdja ndarëse me volumin musandër-trapazan është një strukturë e formuar nga një gardh, suvatuar ne dy anët me llaç gëlqereje, fiksuar në binarë me Ø 8-10 cm, çdo 60-70 cm. Në shtëpinë e zjarrit (fig. 3c) e njëjta perde ndarëse ka një strukturë të krijuar nga një sistem binarësh vertikalë 6 x 8 cm, të vendosur çdo 60 cm, të cilët ndërpriten nga një brez horizontal që kalon në nivelin e derës. Nga ana e dhomës së miqve ajo është e veshur me paretka horizontale suvatuar në këtë faqe, duke lënë zbuluar konstruksionin nga ana e shtëpisë së zjarrit. Për kjo perde (fig. 3b) trajtohet e suvatuar edhe nga ana e mjedisit të shtëpisë së zjarrit, duke qenë tashmë kjo një teknikë mjaft e përdorshme.

Furra është një tjetër element përbërës i shtëpisë së zjarrit, të cilën e takojmë shpesh. Ajo, e dalë në formën e një platforme trekëndëshe, të ngritur nga dyshemeja e mjedisit, shfrytëzon gjithmonë këndin që krijohet nga dy muret perimetrale në krah të vatrës. Sipas rastit atë e gjejmë të përbërë nga një ose dy furra pjekjeje të mbivëna, me dalje harkore (fig. 10), apo të drejtë (fig. 11). Ky element i shtëpisë së zjarrit, nuk është i njëkohshëm me të. Ai është krijuar më vonë si nevojë elementare e përmirësimit të kushteve të gatimit. Shpesh atë e takojmë në një mjedis të veçantë të banesës të quajtur qilar. Lindja e qilarit, në një fazë të mëvonshme të zhvillimit, duhet konsideruar një hap pozitiv, për banesën shkodrane në përgjithësi, e për shtëpinë e zjarrit në veçanti. Zakonisht qilari është një mjedis i vogël, i vendosur në pjesën e pasme të banesës, gjithmonë i lidhur me shtëpinë e zjarrit. Trajtohet në volum si një trup i vetëm me nyjet sanitare që dalin jashtë konfiguracionit të banesës në formë xhepi, por nuk përjashtohet dhe rasti kur ai ka përmasa të konsiderueshme dhe del i shkëputur. Funksionet e tij, të karakterit ndihmës, për pjekje, larje enësh, si dhe për depozitimin e produkteve ushqimore, justifikojnë trajtimin e tij tepër të varfër e primitiv, pa suvatim, pa tavan, me shtresë shpesh, drejt në truall, ose me rrasa guri. Toleranca në përmasat e tij shpjegohet me gjendjen ekonomike të pronarit.

Raftet e murit janë nga të pakëtat elemente arkitonike, të cilat formulojnë brendësinë e shtëpisë së zjarrit. Ato mund të jenë një ose dy, të vendosura gjithmonë poshtë nivelit të sergjive. Rafti i qarkuar nga fashatura, përbëhet nga dy flegra dhe kamarja, e vendosur, sipas zgjidhjes së mjeshtrit, në pjesën e sipërme apo të poshtme. Ekzistenca në kohë e këtij elementi padyshim ka mbartur forma më të hershme, kur kjo kamare ishte thjesht një hapësirë e hapur në mur, me dy ose tri ndarje. Evoluimi i saj është i njëkohshëm me atë të shtëpisë së zjarrit.

Dera e hyrjes është një element i rëndësishëm, përbërës i shtëpisë së zjarrit. Forma e trajtimi i saj estetik lidhet me mjedisin të cilit i përket. Në dallim nga dera e hyrjes për në odën e miqve, bri saj, ajo trajtohet mjaft varfër estetikisht. Flegra e saj formohet me dërrasa të afruara vertikalisht, shpesh me ndonjë ndarje horizontale, mbërthyer me pafta kovaçi. Hapësira e saj mbulohet, sipas rastit, me arkitra druri ose hark gjysmë rrethor (element karakteristik i odës së mirë) me një trajtim të varfër dekorativ. Derës nuk i mungon mekanizmi i thjeshtë i hapjes dhe i mbylljes, si dhe i menteshave fiksuese punuese punuar me hekur të rrahur.

Sergjia është një element i thjeshtë prej druri i vendosur në nivelin e sipërm të dritareve. Ajo përbëhet nga dy dërrasa, njëra fiksuar në mur dhe tjetra e dalë konsol, mbështetur në mbajtëse të thjeshta. Sergjia shërben për vendosjen e enëve të ndryshme. Vendosja e saj trajtohet në disa forma. Forma më e rëndomtë është ajo e qarkimit të saj në një ose disa faqe. Në faqen e vatrës ajo ndërpritet buzë saj me një profil të thjeshtë gjarpërues, duke e vlerësuar atë. Ka raste kur në një faqe ajo vendoset dy dhe tri radhëshe (fig. 3b).

Sqolli është një hapësirë në trashësinë e murit, i cili në platformën e dyshemesë së tij ka një vrimë për largimin e ujërave. Ai ka shërbyer për larjen e duarve, por nuk përjashtohet dhe rasti kur ai ka përmasa më të mëdha dhe ka shërbyer edhe për larjen e enëve. Në një fazë të veçantë të zhvillimit të shtëpisë së zjarrit, me ndërtimin e qilerit, ai instalohet atje.

Dritaret përbëjnë një prej elementeve më të larmishme të shtëpisë së zjarrit. Ato kanë forma dhe madhësi të ndryshme, të lidhura me funksionin e

DOWNTOOK

Shtëpia e zjarrit në banesën shkodrane të shek. XVIII-XIX



DO NOT COPY

Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 10



Fig. 11

mjedisit, si dhe periudhën kur ndërtohen, duke luajtur përherë e më shumë një rol me rëndësi, si një prej elementeve të rëndësishëm dhe në trajtimin e pamjeve të jashtme.

Elementet më të hershme të ndriçimit të shtëpisë së zjarrit kanë qenë baxha.[12] Ndërtimi i tyre ka ardhur si pasojë e pozicionit qendror të këtij mjedisi, i cili shpesh s'jep mundësi për dritë. Në këtë rast baxhoja, një ose dy të tilla, është me dritë direkte. Me ndërtimin e tavanit baxhat pësojnë përmirësim, me pikësynim drejtimin e organizuar të dritës.

Me zhvillimin e tipit të banesës shkodrane, pjesët përbërëse të dritareve vinë e shtohen. Në periudha të caktuara futen persionet, telajot me xhama, kafazlijet e drurit, si dhe zgara e hekurit. Dritaret poshtë sergjive vendosen mjaft ulët, 40-50 cm nga niveli i dyshemesë, për të lehtësuar shikimin jashtë duke qenë ulur pranë vatrës. Dritaret më të hershme kanë qenë ato pa telajo xhami, vetëm me dy kapakë, të ashtuquajtura «kapakë të territ», mbylla e të cilave siguronte mosfutjen e të ftohtit. Formë e hershme e dritareve është dhe ajo e dritareve dyfishe, ku ato janë të mbivëna njëra mbi tjetrën. Në këtë rast, dritarja e sipërme e pajisur me kafazlije druri është fikse. Këtë element funksional e njëherazi arkitektonik, e takojmë shpesh të instaluar tek dritaret e poshtme, kur ato vështrojnë në çardak, për të fshehur sadopak gratë dhe vajzat që punonin dhe rrinin aty. Kërkesat e reja të kohës, gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX, sollën një konceptim më të gjerë për jetën. Prirja e përgjithshme ishte ajo e rritjes së sipërfaqes së ndriçimit, pra e dritareve. Ato rriten në numër, zmadhojnë hapësirat e tyre, pajisen me fashatura druri nga jashtë e nga brenda, si dhe me zgara hekuri duke tentuar gjithnjë drejt barastrajtimit me dritaret e odave të tjera.

Tavani është një element përbërës i shtëpisë së zjarrit, i cili ka hyrë në këtë mjedis në një fazë të mëvonshme të zhvillimit të saj. Në fazat e hershme, me zgjidhje të thjeshta të vatrës, shtëpia e zjarrit trajtohej pa tavan, sepse mungesa e tamburit tymtërheqës bën që tymi të kalojë drejt e në çati. Vendosja e tamburit, gjatë gjysmës së parë të shek. XIX, duhet konsideruar shkaku i parë i ndërtimit të tavanit. Tavani i kompozuar thjesht, nga korniza konturuese që vjen rreth e qark dhe nga fusha e tij, e cila formohet nga dërrasa të puthitura të vendosura bri njëra-tjetrës ose të bashkëlidhura me një bordurë të ngushtë.

Ndryshimet që pëson shtëpia e zjarrit gjatë gjysmës së dytë të shek. XIX si: modifikimi i vendit të zjarrit duke ndërtuar oxhak me tambur, ritrajtimi i kompleksit musandër-trapazan dhe i rafteve të

12) E. Riza, **Shtëpia e zjarrit në banesën qytetare shqiptare,** Etnografia shqiptare, Nr. 14.

murit, shtimi apo zgjerimi i dritareve, ndërtimi i tavanit, largimi furrës dhe sqollit, janë ndryshime esenciale, që lidhet me kompozimin arkitektoniko-dekorativ dhe përmbajtjen e këtij mjedisi, si reflekse të ndryshimeve që pëson vetë banesa në kuadrin e krijimit të kushteve më të mira të jetesës për borgjezinë e re shkodrane.

Gjatë evolucionit të banesës shkodrane, shtëpia e zjarrit, ka qenë një njësi kompozicionale më vete. Njëllojshmëria e funksioneve të saj, si dhe kërkesat estetike mjaft modeste, për vetë natyrën e këtij mjedisi, i japin asaj një trajtim të spikatur qartë nga mjediset e tjera të banesës. Ky fakt shpjegon dhe kontradiktën mes mospërputhjes së trajtimit arkitektoniko-dekorativ të mjediseve të banesës, veçanërisht odës së mirë dhe shtëpisë së zjarrit. Ndërsa me kalimin nga variantet më të thjeshta në më të zhvilluarat, oda e miqve, rrit vlerat e saj, shtëpia e zjarrit mbetet konservatore për shkak të programit pa kërkesa estetike. Kjo shpjegon dhe tipizimin e saj në zgjidhjet kompozicionale, formulimin e brendshëm funksionalo-arkitektonik si dhe trajtimin e elementeve të veçanta përbërëse të saj ku, veçanërisht tek vatra, elementi kryesor më i vjetër, tipizimi është më i qëndrueshëm.

Shtëpia e zjarrit në banesën shkodrane ka bashkëekzistuar, përgjithësisht, me banesat e tipit me hajat e çardak të Beratit, Elbasanit, Kavajës, dhe në të kundërtën, kemi largimin nga banesa përdhese e Tiranës, në drejtim të formulimit të brendshëm kompozicional dhe trajtimit të elementeve përbërëse të saj.

Në bashkëmarrëdhënie me shtëpinë e zjarrit të banesës fshatare takojmë paralele, veçanërisht, në trajtimin e elementeve të veçanta, vatrës, vendit të zjarrit, të shpjeguara këto me programin e njëjtë në kushtet e formacionit feudal të shoqërisë, ndërsa me kalimin në formacionin kapitalist, kjo bashkëmarrëdhënie vjen dhe zbehet, për shkak të programit me kërkesa gjithnjë e më të thelluara të banesës qytetare.

BOOT COPY

Shpresa PRIFTI

DO NOT COPY

LA MAISON DU FEU DANS L'HABITATION DE SHKODRA AUX XVIIIe-XIXe SC. ET LES ÉLÉMENTS FONCTIONNELS CONSTITUANTS DE SON ARCHITECTURE

RESUME

La «maison du feu» constitue la plus ancienne pièce de l'habitation urbaine albanaise, qui comme toute l'habitation, présente un développement distinct dans le temps, reflétant ainsi le mode de vie. L'analyse de ses principaux constituants, la fonction, la place qu'elle occupe à la composition et le traitement de l'intérieur, se rapporte au facteur de la formation économique sociale, ainsi qu'au degré du developpement de la ville de Shkodra où cette habitation vit le jour et évolua. Le type de l'habitation à «tchardak» peut être qualifiée de maison du propriétaire foncier qui bien qu'installé en ville, ne perd pas ses rapports avec sa propriété.

Dans l'habitation de Shkodra, depuis la variante la plus simple qui est celle à un petit nombre de pièces, jusqu'à la variante la plus développée donc à plusieurs pièces, la «maison du feu» constitue une pièce principale de l'habitation. Elle représente en soi même une unité compositionnelle indépendante des autres pièces et de la typologie même de l'habitation.

Ayant en considération l'époque où elle fut construite, on distingue deux groupes. Dans le premier font partie les réalisations des années 40-50 du XIXe sc alors que dans le deuxième celles qui appartiennent à la deuxième moitié du XIX sc. Ce classement correspond au classement typologique de l'habitation de Shkodra.

Dans l'habitation de Shkodra, la «maison du feu» a généralement une forme quadrangulaire. Par rapport aux autres pièces, elle ne diffère pas sensiblement du point de vue des dimensions. La principale fonction est celle de la préparation des mets mais elle sert également de salle à manger, de lieu de repos, de lieu de communication intérieure et quelques fois de chambre à coucher. La diversité de ses fonctions fui dicte une position centrale à l'habitation, à côté de la «chambre des amis» ou parallèle au tchardak.

L'adjonction des autres pièces à l'habitation lui fait perdre ses fonctions initiales. Elle ne sert plus de logement. On remarque une relation dirécte entre l'évolution de l'habitation de Shkodra et la réduction des fonctions de la «maison du feu». Ce fait reflète le passage de l'habitation à peu de pièces et à plusieurs fonctions, à l'habitation à plusieurs pièces et à peu de fonctions.

L'établissement des nouveaux rapports capitalistes au cours de la deuxième moitié du XIXe sc apporta l'affermissement économique de la ville. La naissance de la nouvelle couche de la bourgeoisie artisanale commerciale, les exigences pour une meilleure vie, causèrent 'a perte graduelle du rôle principal de la maison du feu», La dépendance qui existe entre le rôle principal de la «maison du feu» et sa position dans l'habitation apporta son déplacement derrière les pièces d'habitation tout en conservant sa communication avec le «tchardak». Il s'agit ici d'un bond positif à la typologie de l'habitation de Shkodra.

Pour faire le traitement compositionnel et analytique de la «maison du feu» il faut s'arrêter à ses éléments fonctionnels architectoniques tels.

1) fe foyer 2) le complexe musander trapazan 3) les placards 4) les portes 5) les plafonds 6) le four 7) l'évier 8) le dressoir.

1. Le foyer, lieu où l'on fait du feu. La fonction de la préparation des mets qui était liée à la présence du feu, connut une longue durée et accompagna la «maison du feu» pendant toute son évolution.

La foyer représente le premier élément important qui prend part à l'aménagement intérieure de cette pièce et l'accompagne pendant tout le temps. Avec l'évolution de la «maison du feu» la position du foyer se déplace du milieu de la pièce à l'un des murs périmétraux. L'importance de cet élément et la complexité de son activité lui dictent la place centrale. Les foyers sont groupés en 1) foyers simples, 2) foyers à cheminée 3) foyers composés. Le premier classement correspond aux réalisations des années 40-50 du XIXe sc, le deuxième comprend celles de la deuxième moitié du XIXe sc alors que le troisième doit être consideré comme transitoire. Dans les foyers simples, la cheminée présente des solutions en fonction de sa forme et de ses dimensions, alors que le foyer, selon le cas, est traité simplement ou par des éléments particuliers en forme de blocs élevés du plancher.

Au groupe des foyers composés sont compris les foyers dont la technique de construction et la composition ont avancé, surtout en ce qui concerne la forme du choix du lieu où l'on fait le feu qui peut être un four ou tout simplement une plateforme pour faire la cuisine. La coexistence des deux formes de

foyer reflète la différentiation de classe et entre temps les différents degrés de l'évolution du foyer à l'intérieur d'une typologie définie.

2. Le complexe musandër-trapazan est un élément architectonique qui n'est pas très fréquent à l'aménagement intérieur de la maison du feu. Ce complexe formé de deux volumes superposés est amenagé en face du foyer ou à son côté. Le volume inférieur est composé des deux avant-entrées latérales qui relient «la maison du feu» au «tchardak» et aux autres pièces de l'habitation et de la partie centrale occupée par musandra. Avec la reconstruction que l'habitation subit au cours de la deuxième moitié du XIXe sc, le complexe musandër-trapazan s'installe à la face du mur qui comporte l'entrée et prend des formes avancées. Les formes, la technique et le pauvre traitement constructif du complexe musandër-trapazan par analogie avec l'aménagement intérieur de la «maison du feu» nous indiquent qu'il est un élément aussi ancien que la «maison du feu»;

L'uniformité des fonctions de la «maison du feu» ainsi que les exigences esthétiques assez modestes, lui dictent un traitement bien distinct. Ce fait explique également la contradiction entre la non-conformité du traitement architectonique décoratif de la «maison du feu» et les autres pièces de l'habitation, particulièrement la chambre d'amis. Pendant le passage des variantes simples à celles plus developpées, les valeurs de la «chambre d'amis s'accroissent alors que la «maison du feu» demeure conservatrice à cause du programme limité sans exigences esthétiques.

La «maison du feu» de l'habitation de Shkodra représente une affinité avec celles des habitations du type à tchardak et à hayat de Berat, Elbasan, Kavaja mais elle diffère des habitations de Tirana où la «maison du feu» occupe la hauteur de deux niveaux.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Eduard SOPPI

TË DHËNA TË REJA TË PËRFTUARA GJATË RESTAURIMIT TË PIKTURËS SË KISHËS SHËN MËRIA E BRRARIT

Në vitin 1981 në Brrar, fshat në afërsi të Tiranës, gjatë punimeve të rastit u zbulua një pjesë muri me pikturë murore dhe një pllakë varri[1] me mbishkrim. Menjëherë pas zbulimit u ndërhy për përforcimin e fiksimin e pikturës së zbuluar. Siç treguan gërmimet arkeologjike të vitit 1986 ato i takonin Kishës së Shën Mërisë[2] së Brrarit.

Pjesa e zbuluar e kishës përbëhet nga naosi 12 – 16 m i gjatë dhe 8 m i gjerë dhe narteksi 8 x 5,3 m. Në qoshen verilindore të narteksit ndodhej dhe varri i sipërpërmendur, me drejtim lindje-perëndim. Gjatë gërmimit të varrit, poshtë tij, u gjet një varr tjetër, më i vjetër, i cili sipas autorëve të gërmimit ka shërbyer si osteotekë. Vjetërsia dhe vendndodhja e varrit flet për influencën e madhe të kësaj familje në këtë zonë, që para pinjollit të saj, sevastit Mihal Sgura. Nga shkrimi i gdhendur në dy gjuhë, greqisht dhe latinisht, në pllakën jugore të varrit, mësojmë se aty, në vitin



Fig. 1



Fig. 2

1) A. Meksi, D. Komata, «Kisha e Shën Mërisë Brrarit», Iliria 1987, 2, f. 215-221.
2) Po aty

DO NOT COPY



Fig. 3

1201[3] është varrosur sevasti Mihal Sgura me të shoqen e fëmijët, të cilët mund të kenë vdekur njëherësh, në kushte historike të panjohura.

Në muret e naosit, 40-50 cm lart nga shtroja, u gjetën copëza të vogla afresku që paraqisnin harqe me ngjyrë të kuqe në sfond të bardhë.

Në muret e narteksit u zbuluan fragmente pikture në teknikën e afreskut. Ndonëse të dëmtuara rëndë ato paraqisnin interes, sepse përmbanin dhe shkrime në gjuhën latine. Në narteks u gjetën edhe copa të shumta afresku të rëna përdhe sëbashku me materiale të tjera. Në mesin e murit verior të tij ishte pikturuar skena «Deissis» (fig. 3, 4). Skena anash theksohet me një bordurë në ngjyrë të verdhë, më e gjerë se zakonisht, pikturuar me ngjyrë të kuqe sipas traditës[4]. Në qendër, ndonëse zbehtë, dallohet portreti i Krishtit me aureolë dhe kryqin brenda saj. Piktori i fazës së mëvonshme e ka çukitur lehtë këtë pikturë e mbi të ka hedhur afreskun e tij. Nga ky afresk ruhej, përveç palave, një pjesë shkrimi në ngjyrë të kuqe angleze në fushë të bardhë. Fjalët latinisht që kanë mbetur: «. . . Ista esso. . .» e më poshtë «. . . ordine. . .», sipas H. Nallbanit lidhen me varrin. Deri para gërmimit kjo ishte pjesa më e madhe e afreskut që ndodhej në kishë. Pjesë të tjera të vogla ishin të shpërndara në faqet veriore e perëndimore të narteksit.

Në një pjesë tjetër afresku, tek shkallët e varrit, në murin lindor, lexohej qartë motivi me lule e dekoracion. Gjatë gërmimit u zbulua se edhe froni i ndërtuar me mure mbi sofa ishte i pikturuar me teknikën e afreskut në gjithë sipërfaqen e tij. Froni i pikturuar me ajethe të shumta, të kaltërta, në një sfond gri të kuqërremtë, ishte i spërkatur me një shumicë pikash



Fig. 4

3) Gërmimin e shoqëron grupi restaurator i pikturës së IMK E. Soppi, A. Devolli.
4) Po aty

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6



DO NOT COPY



Fig. 7



Fig. 8

të bardha (fig. 7). Një fragment tjetër ndodhej në nikën që qarkon varrin (Tab. I), në nivelin e tij, shpatulla e kësaj nikeje mbështetej mbi një pilastër ndërtuar me gurë të skalitur. Mbas pilastrës ishte muri ndarës narteks-naos. Në pjesën e sipërme, ku muri i pilastrës mungonte, dallohej një pjesë shkrimi në gjuhën latine (fig. 8), me bojë të kuqe në sfond të bardhë të ngrohtë. Pranë derës së hyrjes së narteksit, në grumbullin e dherave u zbulua një gur kuadratik me shtresë suvaje të pikturuar. Në të kishte pjesë shkrimi në gjuhën greke, me gërma të mëdha të zeza në sfond të bardhë të ftohtë.

Për të nxjerrë në dritë afreskun nën pilastër u vendos heqja e këtij të fundit. Para se të çmontohej pilastri u hoq piktura mbi të. (fig. 9). Pastaj gur pas guri hoqën pilastrin, duke nxjerrë në pah gjithë pikturën në qoshen verilindore të narteksit. Në anën veriore të kësaj pjese të murit kishim dy shtresa afresku njëra mbi tjetrën. Pra, varri i Mihalit ndërtuar më 1201 lidhej me fazën e katërt të pikturimit.

Në fragmentin 2 m të lartë dhe 80 m të gjerë me mbisnkrim latinisht dallojmë një pjesë të skenës eukaristike «Dasma e Kanës» (fig. 10). Në qendër të afreskut të mbetur është pikturuar pitosi i madh, me grykë të ngushtë, në të cilën janë vizatuar një tufë vizash vertikale. Majtas shihen dy njerëz me shishe në dorë (fig. 11). Veshjet e tyre, janë të trasha dhe me kapuç të mëdhenj që mbulojnë gjithë kokën, duke lënë në dukje vetëm fytyrat. Pikturimi i portreteve është kryer mbi një ngjyrë të kaltër në umbra të ftohtë, mbi të cilën është vendosur e verdhë napolitane e hapur, në fillim e lehtë dhe pastaj më e fortë (fig. 12). Me mjaft shije është përdorur e kuqja për mollëzat e faqeve. Rrobat në ngjyrë kafe të murme, prej cope të trashë, por të derdhur, të kujtojnë së tepërmi zhgunin e domenikanëve. Në anën e majtë dallohet një dorë që bekon e pjesërisht hunda e pak sytë e figurës së Krishtit, e cila është e dëmtuar. Anës kokës dallohet aureola e tij me kryqin e pikturuar brenda. Poshtë dallohet njëra këmbë me drejtim nga pitosi. Në sfond

janë pikturuar ndërtesa. Kjo skenë kufizohet me disa bordura: e bardhë, e zezë dhe e kuqe. Në mesin e bordurës së kuqe janë vendosur në rresht pika të mëdha të bardha. Këtë dukuri të rrallë ne do ta shikojmë edhe në Kishën e Rubikut, piktura e së cilës si kohë është para vitit 1272, në Kishën e Orikumit dhe në pikturën e Kishës së Shën Kollit në Lezhë (fig. 13). Në këto kisha, përgjithësisht të shërbesës përndimore, kjo bordurë nuk lihet thjesht e kuqe, por në mes ngacmohet me anë të motivit me pika ose vija të bardha. Poshtë bordurës së lartpërmendur është një bordurë tjetër e kuqe më e errët dhe më e ngushtë, në anën e majtë të së cilës lexojmë me gërma të mëdha, në ngjyrë të kuqe më të errët se vetë bordura, fjalën «DEVIRESOAT» që ne ende nuk e shpjegojmë dot. Piktura, e cila përfundon mbi sofat, mbyllet me një motiv zbukurues bimor.

Motivi i bordurës së kuqe me pika të bardha në mes vazhdon edhe në pikturën ngjitur. Pikturat duhet të jenë të të njëjtit piktor e të së njëjtës fazë, jo vetëm për ngjashmërinë stilistike, por edhe sepse në qoshe suvaja e afreskut është një copë e vetme, pa fugë. Fragmenti paraqet figurën e një strategu, me një ushtë a skeptër. Afresku në vendin ku duhej të ishin koka dhe këmbët është i dëmtuar. Këtij strategu i lexojmë vetëm torsin deri në gjunjë, veshja e të cilit është pikturuar me motive gjeometrike e bimore. Piktura mbi të paraqet, gjithashtu, një strateg në përmasat e të parit. Suvaja e këtij afresku vendosur pa çukitur të parën, mbulon bordurën me pika të bardha të skenës «Dasma e Kanës» e përfundon pa u futur në skenën në fjalë. Në të ndjehet një karakter i thatë e dekorativ, ndryshe nga piktura pranë. Ky afresk, i mbuluar gjithashtu gjatë ndërtimit të varrit do të ketë qenë faza e tretë e pikturimit të narteksit.

Në këtë mënyrë si fazë të parë quajmë pikturën që paraqet skenën «Deissis». Fazë të dytë përbën afresku me fjalët latine «... ista ... esso ..., dhe afresku me shkrim latin në qoshe, që paraqet në njërën anë strategun dhe në anën tjetër «Dasmën e Kanës». Për lidhjen midis tyre na shtyn ngjashmëria stilistike dhe teknika e pikturimit.



Fig. 9



Fig. 10

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 11



Fig. 12



Fig. 13

Në studimin e tyre A. Meksi e D. Komata duke u nisur nga fakti se muri verior ndahet me fugaturë me murin perëndimor të naosit e quajmë narteksin si fazën e dytë të ndërtimit të kishës, shtesë të mëvonshme. Për këtë problem ne mendojmë të kundërtën. Shembuj të kthimit të naosit në narteks ka. Kështu në fshatin Gollomboç, në absidën e kishës buzë liqenit të Prespës së Madhe (kisha duke u nisur nga ngjashmëria që ka në arkitekturë dhe pikturë me kishën e Maligradit është e afërt në kohë me këtë kishë) është hapur dera e hyrjes (pasi u mbyll dera e mëparshme) dhe është shtuar naosi i ri. Kësisoj naosi i vjetër u kthye në narteks.

Kisha e vogël në fillim ka pasur të pikturuar vetëm skenën «Deissis». Mendojmë kështu nga mbyllja e kompozimit në të katër anët me bordurën e verdhë të kësaj skene. Gjurmë të tjera afresku të kësaj kone nuk u gjetën. Më vonë kisha është afreskuar e gjitha me pikturë. Ka të ngjarë, që në këtë kohë, me rastin e rregullimit të kishës, të jetë ngritur edhe froni. Edhe në fazën e tretë të pikturimit (e cila mendojmë se ka qenë pjesore, duke u nisur nga piktura në qoshin verilindor ku ka mbuluar vetëm njërën anë të qoshes, duke lënë në anën tjetër skenën «Dasma e Kanës» varri mungonte. Arsyet e këtij riparimi janë të panjohura. Ndoshta, pas kësaj kohe është shtuar naosi dhe është ndërtuar varri.

Të shikojmë nga afër problemin tonë. Tek piktura në qoshen veri-lindore, ana lindore, nën suvanë e afreskut të fazës së parë, poshtë suvasë ku është shkrimi, dallojmë një suva tjetër pa pikturë (fig. 14). Kjo suva futet jo më shumë se 5-6 cm në brendësi të murit verior.

Në fillim ne u ngatërruam me këtë suva për sinop, për shkak të disa ngjyrave që kishte që s'ishin gjë tjetër veçse prova të penelit të artistit. Duke vërejtur e ndjekur me kujdes këtë suva shikojmë se ajo përfundon diku pak më tepër se gjysma e gjerësisë, nën skenën «Dasma e Kanës». Kjo dallohet mirë, pasi kjo zonë e afreskut është e prerë statigrafisht në anën e majtë të saj sëbashku me murin. Këtë fenomen nuk e vërejmë në suvatë e tjera të kësaj kohe. Pra nuk është karakteristikë teknike, por ka shërbyer si mbushës i muraturës së çrregullt, sidomos në këtë zonë, e cila është qoshe e çdo shtrembërim nuk duket mirë. Këtë fenomen e ndeshim në shumë kisha.

Në murin verior kjo suva nuk krijon fugaturë, por hyn fare pak (gjë normale në një muraturë me gurë të çrregullt).

Këtij muri narteks – naos i është mbështetur ose më saktë i është veshur një mur tjetër duke ia zgjatur trashësinë nga 70 në 90 cm. Pastaj, mjeshtrit për të formuar naosin e ri janë zgjatur nga lindja, për të formuar naosin e ri.

Siç pamë, në këmbët e varrit ndodhet froni me dy krahë 40 cm të lartë dhe 35 cm të gjerë. Ndenjësja e tij është 50 cm. Ai është ngritur mbi sofatin me muraturë guri e tulle. Krahu i majtë, mbuluar me rrasa, ka shërbyer për të mbajtur pllakën e sipërme të varrit (e cila nuk u gjet) dhe si mbështetje për niken, ndërsa shpatulla tjetër siç pamë ishte pilastri që hoqëm ne. Kjo tregon se froni ka qenë para se të ngrihej varri i Mihal Sgurës me niken mbi të. Duket qartë se me ndërtimin e varrit froni ka humbur rëndësinë e tij. Duke u nisur nga madhësia e tij, rëndësia që i jepet duke e pikturuar me motive me gjethe, do të mendonim se ai është një fron peshkopal, i cili e ka vendin në naos. Shembull tjetër ne nuk gjejmë në të gjithë zonën tonë. Naosi i ri është ngritur rreth vitit 1201, ose ndoshta, pak para kësaj date. Më vonë, kur naosi kishte kohë që ishte kthyer



Fig. 14

KISHA E SHEN MERISE - BRRAR



Fig. 15

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17

në narteks, në anën veriperëndimore të tij ngrihet një këmbanore. Në këtë drejtim hedh dritë edhe zgjedhja ikonografike e renditja tematike. Skena «Deissis» është një domethënie e madhe, ajo mbase në pikturën lindore dhe perëndimore në këtë kohë, nuk kishte një vend të përcaktuar në naos[5] por në narteks nuk e gjen gjëkundi. Kjo skenë nuk është gjë tjetër vetëm se reduktimi i skenës «Shestia» të cilën lindorët e vendosin mbi absidë. Në kishën katolike të Rubikut skena «Deissis» vendoset në gungën e absidës, në vend të Shën Mërisë. Edhe skena «Dasma e Kanës» e shenjtorët në këmbë, nuk pikturohen në narteks.

Kisha e vogël në fillim ka pasur të pikturuar vetëm skenën «Deissis» nga sa dimë ne, duke u nisur nga mbyllja e kompozimit në të katër anët me bordurën e verdhë të kësaj skene. Gjurmë të tjera afreske të kësaj zone nuk u gjetën. Më vonë kisha është afreskuar e gjitha me pikturë. Ka të ngjarë, që në këtë kohë, me rastin e rregullimit të kishës, të jetë bërë edhe froni. Mbas fazës së tretë është shtuar naosi dhe është ndërtuar varri për të parët e Mihail Sgurës. Më 1201, me rastin e ngritjes së varrit të vetë Mihalit, varr ky tani më i madh, siç ja kërkonte sëra, nga nikja mbi varr është mbuluar me muraturë e gjithë piktura e fazës së dytë dhe riparimi i fazës së tretë. Pra, del se nikja e piktura mbi të janë faza e katërt e pikturimit. Datimin e fazës së parë të pikturës e kemi të vështirë, pasi nuk kemi objekt tjetër krahasimi, aq më tepër se kjo pikturë është e një shkolle lokale.[6] Por, ne e lidhim me datimin e arkitekturës, të cilën shokët arkeologë e vendosin në shek. XI. Edhe ata e vendosin këtë datë duke pasur si bazë kohën e ndërtimit të varrit e duke zbritur vitet nga një fazë e pikturës ndërmjet fazës tjetër, duke vendosur një mesatare vitesh ndërmjet fazave të pikturës[7]. Edhe ne do të bënim të njëjtin arsyetim, por duke ditur mirë numrin e fazave të pikturimit, të cilat janë 4, do ta shtynim datimin pak më tej se fillimi i shek. XI.

Si gjatë gërmimit ashtu edhe me përfundimin e tij, kryem përforcimin e menjëhershëm të copave të afreskut në rrethimin me shirit llaçi 2-3 cm të gjerë. Të gjitha fragmentet u fiksuan për të mbrojtur shtresën e ngjyrës. Fragmentin e afreskut të nikes mbi varr, që ishte në pilastër u detyruam ta hiqnim, për të nxjerrë pikturën nën të. Ky fragment si dhe disa copa të tjera (fig. 16) u hoqën me teknikën «stappo a

5) Dh. Dhamo, Kisha e Shën Mërisë Maligradit, B.U.SH.T/2 1963, f. 163.
6) H. Nallbani, **Po aty**
7) A. Meksi, D. Komata, **Po aty**

DO NOT COPY

marsello». Afresku që u çlirua në qoshen verilindore në fillim i kishte ngjyrat tepër të freskëta e plastike. Kjo qe rezultat i lagështisë. Për të mos krijuar thërmimin dhe plasaritjen nga ndryshimi i menjëhershëm i mikroklimës pikturën e mbajtëm disa ditë të mbuluar me beze të lagur, duke pakësuar çdo ditë sasinë e ujit. Pastaj e lamë të thahej në mjedis pa diell. Në afresk u krijua një velaturë e lehtë e bardhë, e cila në disa zona dendësohet. Një dukuri e tillë është në natyrën e vetë teknikës së afreskut. Në zonat ku ajo dendësohej ne e ulëm këtë njollë të bardhë duke e thithur me tulin e bukës, gjë e cila na dha rezultat të mirë.

Pas pastrimit mekanik të mbetjeve të gëlqeres mbi ngjyrë piktura u fiksua me fiksuesin e njohur Paraloid B. 72, tretur në aceton, tepër të holluar. Në fund të punimeve u prish mbulimi provizor dhe u ndërtua një mbulesë e përhershme me konstruksion druri e me çati (fig. 17).

DO NOT COPY

Eduard SOPPI

DO NOT COPY

NOUVELLES DONNÉES OBTENUES PENDANT LA RESTAURATION DE L'ÉGLISE DE NOTRE DAME À BRRAR

L'église de Notre Dame, à l'heure actuelle en état de ruine, se situe au village Brrar de la région de Tirana. Il y a quelques années qu'au même endroit fut decouvert une tombe qui porte l'inscription: ci-gît le sebastocrator Mihail Sgura et sa famille. En 1986 les fouilles archéologiques mirent au jour la planimétrie complète de l'église. Elle était composée du narthex de dimensions 8 x 5,5 m et du naos de 12 (ou 16) x 8 m. Au mur septentrional du narthex fut découvert un fragment de fresque représentant la scène «Déisis» encadrée d'une bordure en jaune, rompant ainsi avec la tradition. Cette peinture est imprégnée d'un esprit populaire. Sur cette scène on trouva une autre fresque avec l'inscription latine.

Dans les ruines de cette pièce on découvrit également un trône peint en motifs en feuilles. Sur la tombe où autrefois il y avait une niche, on trouva des fragments de fresque. L'enlèvement du pilastre mit au jour d'autres couches de peinture au coin N-E.

D'un côté l'on distingue un fragment de la scène «Noces de Cane» avec un texte latin en dessus, de l'autre côté furent découvertes deux couches de fresques superposées représentant le même saint.

A. Meksi et D. Komata, se basant sur le fait qu'entre le mur septentrional et la cloison qui sépare le narthex du naos il y a une jointure, pensent que le narthex appartient à la deuxième phase de la construction de l'église. Nous allons essayer de prouver le contraire. Ils affirment qu'un fragment de la fresque de cette zone entre en partie dans cette jointure. Il ne s'agit ici que d'un enduit utilisé pour remédier à la déformation du coin et la jointure se trouve quelques centimètres plus à droite. La cloison qui sépare le narthex du naos est d'une épaisseur de 90 cm. La jointure divise ce mur en deux fragments, l'un de 60 cm et l'autre de 20 cm. Celui de 20 cm se trouve du côté du naos. Nous pensons que les constructeurs ont élargi ce mur en lui joignant un autre mur puis ils l'ont allongé des deux côtés pour former le nouveau naos. Près de la tombe se trouve le grand trône dont l'une des ailes est couverte de dalles pour supporter la plaque horizontale de la tombe et l'une des pilastres de la niche. Donc ce trône est plus ancien que la tombe. Nous pensons qu'il a servi de trône episcopal ou de lieu de prière, ce qui renforce notre opinion que cette partie de l'église a dû être l'ancien naos. En 1201, avec la construction du nouveau naos il perd sa première fonction et se convertit en narthex.

Les scènes iconographiques telles celles de Diésis et les «Noces de Cane» où les saints sont debout, renforcent davantage l'idée qu'il s'agit là d'une partie du naos.

Au cours des fouilles archéologiques et immédiatement après, furent prises des mesures pour la consolidation et la restauration. Toute la zone fut couverte d'une couverture transparente et d'un toit.

Nr. 1 1990

monumentet

DO NOT COPY

Latif LAZIMI
Agron DORACI

PROBLEME TË MBROJTJES SË VLERAVE URBANE TË QYTETIT MUZE TË GJIROKASTRËS*

Vlerësimi i trashëgimisë urbanistiko - arkitektonike të qytetit muze të Gjirokastrës përbën tashmë një shembull tipik të punës së madhe të kryer në vendin tonë në këto tri dekadat e fundit për studimin, mbrojtjen dhe restaurimin e monumenteve. Veprimtaria e shumanshme në terren për restaurimin e këtij qyteti-muze është paraprirë dhe shoqëruar vazhdimisht nga puna studimore e projektuese e specialistëve dhe nga punime të shumta shkencore e botime[1]), të cilat trajtojnë këto probleme. Mirëpo kontrasti midis «qytetit të vjetër» dhe mënyrës së re të të jetuarit, i cili me kalimin e kohës vjen duke u thelluar, shtron për zgjidhje edhe një problem të rëndësishëm të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës, atë se si do të funksionojë në perspektivën e afërt hapësira muzeore e këtij qyteti.

Detyra për mbrojtjen me konsekuencë të çdo vlere autentike brenda hapësirës muzeore të qytetit nga njëra anë dhe presioni që ushtrohet çdo ditë nga realiteti i zhvillimit të përshpejtuar të mënyrës së sotme të jetesës, nga ana tjetër, kërkojnë ndërhyrjen aktive të urbanistëve për gjetjen e rrugëve të zbutjes të kësaj kontradikte[2]). Kësisoj morëm iniciativën të parashtrojmë një studim modest urbanistik për këtë çështje. Zgjidhja jonë konsiston në mbrojtjen me përparësi e këmbëngulje të vlerave urbanistiko-arkitektonike që trashëgohen në hapësirën muzeore të qytetit. Kështu në një farë mase gjejnë zgjidhje pretendimet e ligjshme të një pjese të banorëve të saj, nëpërmjet rregullimit funksional të elementeve urbane. Studimi bën një hap përpara, duke patur parasysh se deri tani nuk është parashtruar ndonjë punim rreth kësaj çështje me rëndësi aktuale dhe të perspektivës.

Nëse detyra e ruajtjes së plotë të vlerave urbanistiko-arkitektonike në praktikën e derisotme të punimeve restauruese është parë me përparësi, për nevojat e ngutshme që shtronte qyteti muze[3]), detyra e dytë, ajo e gjetjes së mënyrës së funksionit të tij në harmoni me kushtet bashkëkohore, për shkallën e vështirësive në zgjidhjet praktike dhe mungesën e përvojës në këtë drejtim ka mbetur disi më prapa. Ky studim urbanistik synon pikërisht zgjidhjen e kësaj detyre, zbutjen e kontradiktës ndërmjet «qytetit të vjetër» dhe kërkesave të reja jetësore, duke krijuar premisa për një komoditet më të madh, duke u udhëhequr nga normat bashkëkohore, në përputhje me specifikat e qytetit muze.

Qyteti i sotëm i Gjirokastrës (fig. 1) është i nda-

*) Skicat e artikullit janë punuar nga F. Zarshati e autori.

1) G. Strazimiri, **Gjirokastra dhe vlerat e saj kulturore,** Monumentet 1971, 2, f. 85-102. E. Riza, **Qyteti muze i Gjirokastrës,** Tiranë 1981, L. Lazimi, **Oda e mirë dhe elementet arkitektonike të saj në banesën gjirokastrite dhe beratase,** Monumentet 1989, 1. f. 107-137.

2) André J. Donzet, **Le probleme de la modernisation dans les quartiers anciens.** «Le monument pour l'homme» 1971, Padova f. 730.

3) E. Riza, **Qytetet – muze dhe vendi i tyre në jetën e sotme,** Monumentet, 1988, 2, f. 42.

DOKTORATË

rë administrativisht në 12 njësi (lagje) urbanistike, të cilat janë lagjja «Palorto» me 2500 banorë, lagjja «Varosh» me 3100 banorë, lagjja «Dunavat» me 3100 banorë, lagjja «Partizani» me 772 banorë, lagjja «Punëtori» me 1800 banorë, lagjja «Pazari i Vjetër» me 450 banorë, lagjja «Hazmurat» dhe «Meçite» me 2750 banorë dhe lagjja «18 Shtatori» me 4500 banorë, të cilat përbëjnë një populsi të përgjithshme prej afro 26.000 banorësh.

Zona e qytetit që është marrë në studim përfshin: zonën muze, zonën e mbrojtur, zonën ku nuk lejohen ndërtime të reja dhe pjesërisht zonën e lirë, në të cilën roken: (fig. 2). 1) zona e lirë e një pjese të qytetit të vjetër, jashtë kufijve të zonës muze, e cila përmbledh lagjet «Dunavat i Sipërm», «Manalat» dhe një pjesë të lagjeve «Palorto», «Varosh» dhe «Cfakë». Në këtë zonë me shumë banesa individuale, të cilat ruajnë pamjen karakteristike të qytetit muze nuk parashikohen ndërtime të reja, shumëkatëshe, por vetëm rikonstruksione të banesave ekzistuese, 2) zona e lirë që shtrihet pranë lagjeve muze: «Pllakë», «Pazari i Vjetër», «Hazmurat», «Meçite», në të cilat janë ndërtuar banesa shumëkatëshe.

Populsia e zonës së studiuar arrin në 75% të popullsisë së qytetit, nga të cilat në zonën muze dhe të mbrojtur banojnë 30%, në pjesën e zonës së lirë me banesa individuale banojnë 30% dhe në zonën tjetër të zonës së lirë banojnë 15% të popullsisë.

Këto zona nga pikëpamja e shtrirjes urbanistike janë të lidhura organikisht njëra me tjetrën dhe studimi ynë është realizuar mbi këtë bazë strukture të patjetërsueshme urbanistike. Pjesa verilindore, ku është zhvilluar qyteti gjatë viteve të fundit dhe ku parashikohet rritja e tij në të ardhmen, me një popullsi prej 25% nuk është marrë në studim, sepse ajo funksionon më vete, si njësi e re urbanistike dhe zgjidhja e objekteve social-kulturore në të, nuk i nënshtrohet kritereve si në zonat e lartpërmendura. Një çështje tjetër, është ajo e shtimit të popullsisë në zonat në studim, të cilat për vetë natyrën e tyre, në kuadrin e strukturës urbanistike të patjetërsueshme të qytetit të vjetër, nuk kanë mundësi të lejojnë rritje të madhe numerike të popullsisë. Në zonën muze dhe të mbrojtur rregullorja për qytetet muze përjashton ndërtimet e reja brenda tyre.[4] Por, në këtë zonë ekziston mundësia e pakësimit të popullsisë për dy arsye: 1) nga lehtësimi i ngarkesës së banimit në një numër monumentesh të kategorisë së parë dhe të dytë[5], 2) nga ndryshimi i funksionit të një numri tjetër monumentesh nëpërmjet përshtatjes nga funksioni për banim në atë social-kulturor.

Edhe në zonat e tjera të «qytetit të vjetër» përjashtohet mundësia e ndërtimeve të reja shumëkatëshe. Fizionomia e «qytetit të vjetër», jashtë kufirit të zonës muze dhe të mbrojtur, do të mbetet e tillë me përmirësime të pjesshme strukturore. Pra, mund të themi se rritja e popullsisë në zonën e qytetit të marrë në këtë studim do të jetë minimale.

Problemi thelbësor është që, duke ruajtur vlerat urbanistike-arkitektonike të qytetit muze, banorët e tij të jetojnë thuajse me të njëjtat kushte bashkëkohore të qyteteve të tjera të vendit tonë.

Për efekt studimi u shfrytëzua ndarja e qytetit në lagjet ekzistuese. Çdo lagje u nda në njësi urbanistike me një popullsi të përafërt prej 1000 banorësh. Shpërndarja e objekteve të ndryshme social-kulturore nëpër njësitë, grup njësitë dhe grup lagjet u krye sipas normave urbanistike bashkëkohore, në përputhje me kushtet konkrete të qytetit. Shërbimet social-kulturore të cilat duhet të zënë vend në njësitë urbanistike të qytetit muze, për të plotësuar kërkesat e jetës bashkëkohore në raport me numrin e banorëve nëpër këto njësi, janë paraqitur në tabelën Nr. 1 (fig. 3). Vendosja e këtyre objekteve në zonën e qytetit muze do t'i përmbahet kritereve, tashmë të njohura, duke përshtatur monumentet e kategorisë së dytë.[6] Në to pa cënuar kompozimin volumor dhe trajtimin e jashtëm do të bëhen ndryshime në përputhje me funksionin bashkëkohor që kërkon objekti social-kulturor. Praktika jonë restauruese në këtë qytet, ka treguar se kjo zgjidhje është plotësisht në frymën e kritereve për mbrojtjen e qendrave historike dhe njëherazi frytëdhënëse për mundësitë e mëdha që ofron banesa gjirokastrite për t'u përshtatur për këto funksione.

Një numër i monumenteve të kategorisë së parë, janë përshtatur për muze të profileve të ndryshme, por ekziston mundësia që edhe një pjesë prej tyre të përshtaten për kopshte, çerdhe, salla leximi, salla mbledhje, etj. duke iu përmbajtur gjithsesi kriterit, që funksioni i ri të mos cënojë vlerat arkitektoniko-konstruk-

4) Rregullore mbi mbrojtjen, restaurimin dhe administrimin e qyteteve muze të Beratit dhe Gjirokastrës (1961).

5) L. Lazimi, Studim mbi popullimin e monumenteve të qytetit muze të Gjirokastrës (Ruhet në arkivin e Institutit të Monumenteve të Kulturës)

6) L. Lazimi, **Përshtatja e monumenteve për qëllime shoqërore,** Monumentet 2, 1988, f. 112.

DO NOT COPY



Fig. 2

tive të tyre[7]. Zgjidhja e objekteve, të cilat do të vendosen sipas studimit, jashtë kufirit të zonës muze dhe të mbrojtur, gjithnjë në pjesën e qytetit të vjetër, do t'i përmbahet kriterit të lartpërmendur, të përshtatjes së banesave ekzistuese. Kur zgjidhja funksionale kërkon patjetër ndërtim të ri, ai do të ketë një kompozim volumor arkitektonik, i cili do të harmonizohet me arkitekturën tradicionale të qytetit muze. Edhe objektet e reja, që ofron studimi, në zonat me banesa shumëkatëshe do t'i përmbahen kriterit të për-

Tab. 1

OBJEKTET SOCIAL KULTURORE NË NJËSITË, LAGJET DHE GRUP LAGJET

Nr.	EMËRTIMI	Objektet social kulturore	Nr. banorëve në njësitë dhe lagjet 1000-3500 banorë	Nr. banorëve në grup-lagje 7000 banorë
A	Ndërtesë arsimore dhe shëndetësore	Kopshte e çerdhe	po	—
		Shkolla 8 vjeçare	—	po
B	Repartet e tregtimit ushqimor.	Ushqimore	po	—
		Mish	—	po
		Bukë	po	—
		Bulmetore	po	—
		Fruta-zarzavate	po	—
C	Repartet e tregtimit të mallrave industriale	Këpucë	—	—
		Metrazh-Konfeksione	—	—
		Cigare-Kinkaleri	po	
		Kinkaleri	po	
		Enë kuzhine	—	po
D	Repartet e shërbimit social	Gjelltore	—	po
		Pastiçeri	—	po
		Furrë-pjekje	po	—
E	Rep. e shërbimit artizanatit dhe komunal	Riparim këpucësh	—	po
		Riparim, rrobaqepësi	—	po
		Berber	—	po
		Lavanteri	—	po
		Zyra e P.T.	—	po
F	Institucionet shëndetësore.	Farmacia	—	po
		Qendra shëndetësore	po	—
		Poliklinika	—	po
		Infermieri	po	—
		Stomatologji	—	po
G	Institucionet kulturore	Kom.Ekz. K.P. Lagjes	po	—
		Sallë leximi, lojëra	po	—
		Sallë mbledhje	po	—
H	Njësi tregtare tip klubi	Klube	—	po

Fig. 3

7) L. Lazimi, **Vep.cit,** f. 111.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

shtatjes së trajtimit të jashtëm të arkitekturës tradicionale. Në studimin urbanistik shpërndarja e objekteve është kryer duke marrë parasysh dhe shfrytëzimin e objekteve social-kulturore ekzistuese, të cilat përmbushin kënaqshëm kërkesat funksionale bashkëkohore, ose në rast të kundërt, është parashikuar rikonstruksioni i tyre në përputhje me kërkesat e sipërpërmendura. Këto konsiderata janë reflektuar në paraqitjen grafike të studimit dhe në tabelat përkatëse për çdo tip të objektit social – kulturor.

Në vijim do të përshkruajmë tipet e objekteve social-kulturore të pasqyruara në tabelën 1 (fig. 3), sipas specifikimeve të veçanta që paraqesin.

A) Ndërtesat arsimore dhe shëndetësore.

1) **Kopshtet dhe çerdhet**

Në shpërndarjen e kopshteve dhe çerdheve në qytet, nëpër njësitë urbanistike të lagjeve, i është dhënë përparësi vendndodhjes e krijimit të kushteve lehtësuese të banorëve. Sipas tabelës nr. 2 (fig. 4) jepen të dhënat për shpërndarjen e kopshteve dhe çerdheve sipas popullsisë së njësive, cilësimit të objektit, kapacitetit dhe rrezes së shërbimit (fig. 5). Në studim është parashikuar ndërtimi i kopshteve dhe çerdheve të reja, në ato raste kur ekzistueset nuk plotësojnë kërkesat funksionale bashkëkohore.

2) **Shkollat 8 vjeçare dhe të arsimit të mesëm të përgjithshëm**

Në vendosjen dhe shpërndarjen e shkollave 8 vjeçare jemi mbështetur në normat e projektimit, në përputhje me kushtet e qytetit. Përparësi i kemi dhënë rrezes së shërbimit, e cila do të krijojë vajtje-ardhje, të pa sforcuar të nxënësve. Për t'iu shërbyer njësive

Tab. 2

KOPSHTE, ÇERDHE

Njësi	Nr. popullsisë	Kopshte çerdhe		Cilësimi i objektit	Kapaciteti i fëmijëve	Rrezja në max e shërbimit në m.
1	725	Kopsht + Çerdhe		banesë ekzistuese përshtatje.	25 + 25	290 m
2	1202	»	»	ndërtim i ri ekzistues.	30	200 m
3	1700	»	»	ndërtim i ri	45 + 45	200 m
4	1000	»	»	banesë me përshtat. ndërtim ekzistues	40 40	230 m
5	1300	»	»	ndërtim i ri ndërtim i ri	45 45	250 m
6	1000	»	»	banesë me përshtat.	30 + 30	270 m
7	1000	»	»	ekzistues	30 + 30	280 m
8	1000	»	»	ekzistues përshtat. banese	45 + 45	220 m
9	1500	»	»	përshtat. e dy banesave.	30 + 30	240 m
10	940	»	»	përshtat. e banesave	30 + 30	250 m
11	772	»	»	» »	20 + 20	260 m
12	1000	»	»	përshtat. e dy banesave	30 + 30	220 m
13	1000	»	»	» »	30 + 30	200 m
14	1000	»	»	përshtat. e një banese.	30 + 30	230 m
15	1300	»	»	përshtat. e dy banesave.	45 + 45	230 m
16	1100	»	»	ndërtim ekzistues	30 + 30	250 m
17	1272	»	»	ndërtim i ri	45 + 45	230 m

Fig. 4

DO NOT COPY



Fig. 5

DO NOT COPY



Fig. 6

12-17, të cilat kanë vetëm një shkollë, kemi menduar të ndërtohen dy shkolla të reja, shkolla e sotme, e cila është e papërshtatshme nga ana funksionale dhe si vendndodhje do të përdoret për funksione të tjera shoqërore. Pjesën e qytetit, që po studjojmë, e kemi ndarë në pesë zona me nga një shkollë përkatëse (fig. 6). Tabela. 3 (fig. 7), paraqet njësitë të cilave iu shërbejnë shkollat, kapacitetin e nxënësve në bazë të popullsisë së zonës dhe rrezen e shërbimit. Qyteti në gjendjen e sotme ka një shkollë të mesme të arsimit të përgjithshëm. Për këtë arsye në njësinë 16 do të ndërtohet një shkollë, e cila do të kryejë funksionin e shkollës 8 vjeçare dhe të mesme me parametrat e treguara në tabelën 3 (fig. 6).

Tab. 3

SHKOLLAT 8 VJEÇARE DHE TË MESME

Zona	Nr. i popullsisë	Kapaciteti i nxënësve	Njësive që iu shërben	Cilësimi i shkollës	Rrezja e shërbimit
1	4000	450	13, 14, 12, 60% të (15), 50% të (11)	shkollë e re	400
2	3100	300	16, 17, 30% të (1), 40% të (15)	»	400
3	5000	500	3,2, 70% të (1), 50% të (5)	shkollë ekzistuese	450
4	5000	500	8, 9, 10, 50% të (7) 50% të (6) 50% të (11)	»	350
5	2300	220	4,50% të (5) 50% të të (7).	»	450
4	11150	500	1, 2, 3, 5, 16, 17, 15, 14, 12	shkollë e re	1 km
2	14335	800	11, 13, 10, 6, 8, 7, 4, 9	shkollë ekzistuese	900 m

Fig. 7

shërbimit dhe popullsisë së njësisë (bllokut). Ky rrjet tregtar është organizuar me të njëjtin kriter si tek objektet e mësipërme shoqërore, por me parësi që vendndodhja e tyre të jetë pranë rrjetit kryesor rrugor të qytetit. Në tabelën nr. 4 (fig. 8) jepen njësitë urbanistike të lagjeve, numri i popullsisë së tyre, disniveli maksimal i banesave nga njësia tregtare rrezja e shërbimit, cilësimi i njësisë, ndërtimi i ri, apo përshtatje banese sipas specifikës së zonës së vendndodhjes së saj (fig. 9).

B. REPARTET E TREGTIMIT USHQIMOR

Për përmirësimin e rrjetit të sotëm tregtar, studimi i kryer synon të krijojë një shpërndarje të këtyre njësive sipas normave urbanistike, në përshtatje me disnivelin e çdo njësie urbanistike, rrezes së

Rrjeti tregtar i tipeve C, D, H

Në vazhdim të plotësimit të rrjetit tregtar të qytetit muze llojet C të njësive tregtare janë të vendosura në raport me numrin e banorëve. Në njësinë urbanistike 16 do të vendosen njësi tregtare të cilat do t'i shërbejnë dhe njësive urbanistike 15 e 17. Për njësitë urbanistike 11, 12, 13, 14 me 3770 banorë, do të vendosen cigare shitës dhe kinkaleri në njësinë urbanistike 12. Në afërsi të këtyre njësive tregtare

DO NOT COPY

Tab. 4

RRJETI TREGËTAR B

Njësia	Nr. i popullsisë	Disniveli max nga njësia treg. në m.	Rrezja e shërbimit	Cilësimi i njësis
1	724	100 m	240	2 përshtatje banese
2	1202	15	180	ndërtim i ri
3	1700	60	220	ekzistuese
4	1000	35	205	përshtatje banese
5	1300	40	270	ekzistuese (ndër i ri
6	1000	78	200	» (zgjerim)
7	1000	30	170	ndërtim i ri
8	1000	100	180	» »
9	1500	40	200	ekzistuese + adap-tip banese.
10	940	35	180	» » »
11	772	60	170	përshtatje banese
12	1000	40	200	» »
13	1000	85	180	ndërtim i ri
14	1000	75	200	» »
15	1300	80	220	ekzistues ndërtim i ri.
16	1100	40	250	përshtatje + rikonstruksion
17	1272	50	200	ekzistuese + përshtatje.

Fig. 8

DO NOT COPY

do të ketë ëmbëltore dhe furrë pjekje të llojit D. Në njësitë 16, 12, 3, do të vendosen klube të tipit H, të cilët do të shërbejnë për blloqet përqark tyre (fig. 9), ndërsa për blloqet e tjera do të shërbejnë njësitë e qendrës dhe ato të vendosura në pjesën e re të qytetit.

E. REPARTET E SHËRBIMIT ARTIZANAL DHE KOMUNAL

Nga studimi i kryer, ky lloj shërbimi, duke u përqendruar në katër qendra kryesore (fig. 9), pranë të cilave do të vendoset dhe shërbimi i P.T., do të përmirësohet ndjeshëm.

Reparti 1 shërben për njësitë 1, 2, 3, e ndodhet në njësinë 2 (Ndërtimi i ri)
» 2 » » » 15, 16, 17 ndodhet në njësinë 16 (—»—)
» 3 » » » zonat 11, 12, 13 dhe në njësinë 12 (ekzistuese)
» 4 qendra e qytetit (ekzistuese).

F. INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Për përmirësimin e shërbimit mjeksor studimi parashikon 7 qendra shëndetësore, të shpërndara në bazë lagjeje me 3000-3500 banorë (fig. 10).

Në tabelën 5 (fig. 11) jepen njësitë ku janë vendosur këto qendra shëndetësore, blloqeve që iu shërbejnë, meqenëse ndodhen në brendi të qytetit muze ose pranë tij. Përveç këtyre qendrave, për të përmirësuar shërbimin farmaceotik të qytetit, duke u mbështetur në normat dhe kushtet specifike të qytetit, kemi parashikuar të vendoset një farmaci tjetër tek godina e shkollës «N. Frashëri», e cila do të shërbejë për lagjet: «Dunavat», «Manalat» dhe «Cfakë». Për përmirësimin e shërbimit stomatologjik, po në këtë godinë, do të vendoset një klinikë dentare për largjet e mësipërme.

Qyteti do të ketë dy poliklinika (fig. 10), njëra

DO NOT COPY



Fig. 9

DO NOT COPY



Fig. 10

Tab. 5

INSTITUCIONET SHËNDETËSORE

Nr. qendrave	Njësia ku ndodhet qendra mjek-sore	Cilësimi i qendrës	Njësive që iu shërben
		me përshtatje banese	9,8,10
1	9	»	17,50% të (6) 50% të (4)
2	6	»	50% të (4), 5
3	4 — 5	»	1, 2, 3
4	1	»	16, 17
5	16 — 17	»	11, 12, 13, 4
6	12	»	14, 15
7	14		

është poliklinika ekzistuese dhe një tjetër do të ngrihet në ish godinën e shkollës «N. Frashëri».

G. INSTITUCIONET KULTURORE

Pjesa e qytetit, që është marrë në studim, ndahet në 6 lagje, të cilat do të kenë dhe kështillin popullor të tyre. Për të plotësuar nevojat e banorëve në aspektin e aktiviteteve kulturore dhe argëtuese ato do të pajisen dhe me salla leximi, sallë lojërash, sallë mbledhje etj.

Këto godina për secilën lagje do të vendosen pranë 6 qendrave shëndetësore, duke zënë një vendndodhje afërsisht në qendër të lagjeve (fig. 10).

Ky studim modest me një prespektivë 10 vjeçare paraprin studimet e ardhshme për qytetin muze të Gjirokastrës, siç janë: organizimi i shesheve të gjelbërimit dhe të lojërave për fëmijë, organizimi i qarkullimit rrugor nëpër qytetin — muze dhe në periferi të tij dhe studimi i qendrës administrative e tregtare të tij.

Studimi ynë synon të zgjidhë me përparësi problemin e mbrojtjes së vlerave urbane të qytetit muze të Gjirokastrës, duke mos e shkëputur këtë nga aspekti ekonomik.

Këto studime dhe më tej realizimi i tyre do t'i japin qytetit muze të Gjirokastrës një frymëmarrje të re, në mënyrë që ai të jetojë më mirë me kërkesat e jetës së sotme.

DO NOT COPY

Fig. 11

QYTETI - MUZE I GJIROKASTRES

SHK. 1 : 5000



DOKUMENT

COPY

Latif LAZIMI Agron DORACI

DO NOT COPY

PROBLÈMES DE LA PROTECTION DES VALEURS URBAINES DE GJIROKASTRA

RESUME

L'activité si variée sur la restauration de cette ville-musée a été toujours précédée et accompagnée de projets élaborés par des spécialistes ainsi que par de nombreux travaux scientifiques et éditions traitant ce sujet.

Le contraste qui s'approfondit davantage entre l'ancienne ville et le nouveau mode de vie pose à résoudre un autre aspect important de la sauvegarde de l'héritage culturel de Gjirokastra, celui du fonctionnement de l'espace musée dans l'anvenir en trouvant une solution favorable à l'adoucissement de cette contradition.

Actuellement, la ville de Gjirokastra, du point de vue administratif, est divisée en 12 unités urbaines avec en tout 26.000 habitants. Cet article porte sur la zone musée, la zone protégée, la zone interdite aux nouvelles constructions et une partie de la zone libre.

La population de la zone étudiée atteint 75% de la population de la ville, dont 30% habitent aux zones musée et protégée, 30% à la zone libre avec des habitations privées, et 15% à l'autre partie de la zone libre. Ces zones, du point de vue de l'étendue urbaine sont liées organiquement l'une à l'autre. La partie N-E où se développe la nouvelle ville n'est pas comprise dans cette étude. Un autre problème qui se rapporte à la perspective de cette étude est celui de la croissance de la population dans les zones en question.

Le problème essentiel est d'assurer aux habitants de cette ville l'amélioration des conditions de vie, conforme aux nouvelles exigences de la vie actuelle, tout en conservant les valeurs urbanistiques et architectoniques de la ville musée.

A des fins d'étude fut utilisée la division existante de la ville en quartiers. Chaque quartier fut divisé en unités urbaines avec environ 1000 habitants. La répartition des divers objets socio-culturels dans les unités, les groupes des unités et les groupes des quartiers, s'effectua selon les normes urbanistiques contemporaines conforme aux conditions concrètes de la ville. Les services socio-culturels dont a besoin une unité urbaine de la ville-musée pour satisfaire aux exigences de la vie contemporaine, en rapport avec le nombre des habitants dans ces unités, sont reflétés dans le tableau nr. 1 (fig. 3). L'aménagement de ces objets dans la zone de la ville musée doit s'en tenir aux critères déjà connus, en adaptant les monuments de la deuxième catégorie, sans nuire à la composition de volume ou au traitement extérieur. Ainsi de pair aux monuments de la première catégorie transformés en musées, il y aura d'autres qui seront adaptés en crèches, en jardins d'enfants, en salles de bibliothèque, ayant toujours en vue que leur novuelle fonction ne nuise pas à leurs valeurs architectoniques et constructives. L'aménagement des objets prévus par l'étude, en dehors des limites de la zone protégée et celle musée, toujours dans l'ancienne partie de la ville, suivra les critères déjà mentionnés sur l'adaptation des habitations existantes. Dans le cas où la solution fonctionnelle exige une nouvelle construction, la composition des volumes doit s'harmoniser avec l'architecture traditionnelle de la ville musée. Dans l'étude, on a pris en considération l'utilisation des objets socio-culturels existants qui satisfont aux exigences fonctionnelles contemporaines ou dans le cas contraire, on a prévu leur reconstruction conforme aux exigences fonctionnelles et au traitement architectonique extérieur. Ces considérations sont reflétées à la présentation graphique de l'étude et aux tableaux respectifs pour chaque type d'objet social-culturel. L'étude prévoit également une perspective décennale minimale de la croissance de la population dans la zone étudiée.

Ci-dessous nous allons décrire les types des objets socio-culturels, données au tableau n. 1 (fig. 3) selon les spécificités qu'ils représentent.

A) Les constructions des services sanitaires et enseignants: 1) Les jardins d'enfant et les crèches (fig. 4.5); 2) Les écoles de huit ans et les écoles secondaires (fig. 6;7).

B) Les unités du commerce alimentaire et le réseau commercial des types C, D, H (fig. 8,9).

E) Les unités du service artisanal et communal (fig. 9)

F) Les institutions sanitaires (fig. 10,11).

G) Les institutions culturelles (fig. 10).

Cette étude modeste précède les études futures sur la ville musée de Gjirokastra, telles: l'aménagement des surfaces vertes et celles reservées aux jeux d'enfants, l'organisation de la circulation dans la ville-musée et ses alentours ainsi que l'étude de son centre administratif et commercial.

En total, ces études ainsi que leur application donneront plus d'espace à la ville, lui permettront de vivre mieux dans tous les aspects de la civilisation urbaine contemporaine.

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Guntram KOH

NJË PORTRET VAJZE I PERIUDHËS PERANDORAKE ROMAKE NË BERAT

Në Shqipëri, veçanërisht në Apoloni, Butrint dhe Durrës janë zbuluar një numër i madh portretesh të periudhës perandorake. Ndër to tërheq vëmendjen një kokë (Fig. 1 – 5), sot në Muzeun Arkeologjik në Berat[1]. Ajo është shkëputur nga një statujë ose bust dhe ndonëse hunda, veshët, faqja e djathtë kanë pësuar goditje dhe në disa vende është ngrënë, në përgjithësi, ende ruhet mirë, sa dallohen në mënyrë të qartë gjallëria dhe cilësia e punimit. Koka pak e ulur, e kthyer në të djathtë, paraqet një person të ri. Kur e vështron përpara të shkon mendja te një djalosh dhe si i tillë është marrë[2], por kur vështrohet nga anët dhe nga prapa dallohet një gërshet i thurur, pra s'ka dyshim se kemi një kokë vajze.

Sipërfaqja e fytyrës e punuar rrafshët gjallërohet lehtësisht me të ulura dhe të ngritura fine. Goja pak e futur dhe ndarja e buzëve është punuar me daltë. Sytë janë relativisht thellë, qepallat janë të buta, të plota dhe qerpikët të kthyer lehtë. Irisi dhe pupila nuk jepen me pikim ose çarje. Flokët e shumtë, ngjeshur pas kokës, përbëhen nga tufëza të holla, relativisht të shkurtëra dhe pak të harkuara, të cilat vendosen palë si shtresa të veçanta. Mbi syrin e majtë vërehet një karficë, që mund të ndiqet sipër kokës deri në zona më të largëta. Tufëzat e veçanta me punim të lehtë dalte të shkëputura prej njëra-tjetrës janë dhe në vetvete të nëndara. Flokët rrethojnë fytyrën me një kornizë të harkuar, fare të thjeshtë. Vetëm para veshëve shihet një kaçurrel i vogël. Prapa kokës, flokët e gjatë lidhur në një gërshet të hollë thurur plot mjeshtëri lëshohen poshtë. Gërsheti nuk mbështetej mbi qafë, por binte lirisht në të.

Koka jep të dhëna të mjaftueshme për datimin. Flokët e ngjeshur pas kokës, me tufëzat e krehura, të sjella përpara, që e rrethojnë si hark fytyrën, i gjejmë te portretet e burrave dhe të rinjve të kohës së Trajanit, veçanërisht në fazën e hershme. Për krahasim na shërbejnë dhe portrete të hershme të perandorit Trajan, te të cilat masa e flokëve jepet relativisht shumë e ngjeshur pas kokës, ndërsa në ato

1) C. Patsch – Das Sandschak Berat in Albanien (1904) 160-161. Nr. 16. Fig. 131-132, Berat, Muzeu Arkeologjik, Inv. 4788. Lartësia 0,245 m. Nga Apolonia. Mermer relativisht kokërr imët, lehtësisht i zverdhur.

2) L'art albanaise a travers les siecles, Paris, Petit Palais 1974-75 (Paris 1974) Nr. 249: L'arte albanese nei secoli, Ekspozitë në Romë 1985 (Romë 1985) 91. Nr. 348 (Bëhet fjalë për një «Gërshet Isisi», që mund të mbahej nga të rinjtë) V. Von Gonzenbach, kërkime për sakrifica djemsh në kultin e Isisit në periudhën perandorake romake (Bon 1957) 55 e më tej Tab. 2,5; E. Simon, në: Eikones, Studien zum griechischen und romischen Bildnis, kushtuar H. Jucker-it (Bern 1980) 173 e më tej Tab. 59 – Koka në Aleksandri nuk i përket këtij grupi, për shkak të gjerësisë së gërshetit të mesëm dhe të ondulacioneve në anët ajo paraqet një vajzë: N. Bonacasa, Archeol Classica 20, 1968, 274 e më tej, Tab. 112/13, 114; 1; Simon dhe më lart 175.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

të mëvonshmet jepet më e trashë, shumë më e ngritur dhe me të çara më të thella, për të ndarë më mirë tufëzat e veçanta[3]. Një sërë portretesh private lidhen me portrete të hershme të perandorit[4].

Në kokën e vajzës së Beratit, tufëzat e flokëve nuk janë aq të gjata, si në portretet e perandorit apo dhe në portretet private. Edhe veçori të tjera të portretit, si shprehja disi e sertë, gërsheti që bie mbi qafë[5] dhe kaçurreli i vogël para veshit[6], kanë paralele në këtë kohë. Pra, janë të gjitha gjasat që koka të datohet në periudhën e hershme të perandorit Trajan (në fuqi në vitet 98 – 117 e.s), rreth viteve 100 – 110 e.s.

Në Apoloni janë gjetur një numër domethënës

3) K. Fittschen – P. Zanker, Katalog der roemischen Portraets in den capitolinischen Museen und anderen kommunalen Sammlungen der Stadt Rom I (Mainz 1985) 39 e më tej. Nr. 39. 40 Tab. 41-43 (1. Typus), 40 e më tej. Nr. 41, 42 Tab. 44-47 (Tipa të mëvonshëm).

4) G. Daltrop, Die stadtroemischen maenlichen Privatbildnisse trajanischer und hadrianischer Zeit (Muenster 1958) 23 e më tej Fig. 5 e më tej; P. Zanker, in: Eikones (shih më lart ref. 2) 196 e më tej. Tab. 65 e më tej.

5) Ai gjendet p.sh. te Plotina, krs. Flitschen – Zanker. III. (Mainz 1983) 8 e më tej Nr. 7. Tab. 9 (krs p.sh. edhe 59 e më tej. Nr. 79 Tab. 99).

6) Flitschen – Zanker III. 59 e më tej Nr. 79 Tab. 99; Nr. 80 Tab. 100, Nr. 82 Tab. 103.

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

portretesh të shkëlqyera të periudhës së perandorisë romake[7]. Ato paraqesin probleme të ndryshme, sepse në territorin e Shqipërisë nuk kishte mermer dhe traditë për punimin e tij. Peizazhe, relieve dekorative, altare varri, sarkofagë, portrete perandorësh dhe shumë skulptura të tjera prej mermeri mund të jenë importuar në gjendje plotësisht të përfunduar.[8] Por, portretet e personave privatë, si rregull, punohen në vend ose në afërsi. Pra, në Apoloni duhet të kenë ekzistuar punishte skulpture dhe bile me nivel të lartë artistik, ku janë përfunduar një sërë portretesh. Megjithëse deri tani, nga shumica e objekteve të gje-

7) Portretet e kohës perandorake romake të gjetura në Shqipëri nuk janë botuar deri ani të përmbledhura. Citojmë këtu vetëm disa shembuj: **Shqipëria Arkeologjike** (Tiranë 971) Tab. 86. 88-91, A. Baçe – N. Ceka, Monumentet (22) 1981, 43 N. Ceka, Apolonia Ilirisë (Tiranë 1982) 109; Tabelë me ngjyra para f. 217; 223; Tab. me ngjyra pas f. 224; 25, 226. S. Islami, Les Illyriens (Tirana 1985) Fig. 49-51: L'arte albanese (shih lart ref. 2) 0 ff. Nr. 345. 346, 349-351, 353-355.

8) Një shembull veçanërisht i bukur është statueta e Athena Parthenos nga Apolonia, cila është e nënshkruar nga athinasi Euhemeros: Shqipëria Arkeologjike (Tiranë 1971) ab. 90; P.R. Franke, Albanien in Altertum. Sondernummer Antike Welt 1983, 45 Fig. 91.

tura në Apoloni mund të përcaktohet se skulptorët e atjeshëm nuk i përkasin traditës qytetare romake, por asaj lindore dhe madje, një pjesë, pikërisht asaj atikase. Fytyrat janë shumë më shprehëse se ç'mund të priteshin në Romë, flokët më të thjeshtësuar dhe punimi i kaçurrelave nuk është aq preciz[9]. Gjallëria e sipërfaqes së fytyrës dhe pasuria e detajeve te flokët e kokës në fjalë, tregojnë se ajo nuk i përket traditës qytetare romake, por asaj greke të punimeve me dorë. Përfundime më të sakta do të japë kërkimi e zbulimi në Apoloni e gjetkë në Shqipëri i



Fig. 5



Fig. 6

portreteve dhe skulpturave të tjera prej mermeri të periudhës perandorake romake.

Koka ka të ngjarë t'i përkasë një statuje të veshur, për tipin e së cilës s'mund të thuhet asgjë. Mosha e vajzës është vështirë të përcaktohet, ndoshta mund të ketë qenë rreth 14 vjeç. Zor se mund të bëhet fjalë për një statujë nderi të ekspozuar në një vend publik. Pak të ngjarë ka që vajza të

9) Për skulpturën provinciale të portretit në periudhën e perandorit në Greqi: A. Giuliano, La cultura artistica delle province della Grecia in eta Romana (Romë 1965) 52 ff. 72 ff. C.C. Vermeule, Roman Imperial Art in Greece and Asia Minor (Cambridge 1968) 169 e më tej; P. Zanker Provinzielle Kaiserportraets (Muenchen 1983) 26 e më tej dhe passim.

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 7

ketë qenë sakrifikuar për ndonjë shenjt. Në radhë të parë, si dhe pjesa dërmuese e portreteve të fëmijëve dhe të rinjve, mund të konsiderohet një statujë varri, që ndodhej në varrezën e një familjeje të pasur ose dhe në shtëpinë e saj[10]. Në Apoloni janë zbuluar mbetjet e një tempulli varrimi, ku u gjetën dy portrete dhe pjesë të një statuje të tretë[11]. Për përcaktimin e kokës në Berat si të një statuje varri flet edhe një farë trishtimi, ndonëse i përmbajtur, që haset shpesh në portretet e fëmijëve.[12]

Koka meriton një vëmendje të veçantë për modelin e flokëve, sepse në fillim mund të merret si prerje flokësh karakteristike për të rinjtë dhe burrat, por gërsheti prapa provon se kemi të bëjmë me një portret vajze. Mund të përmenden edhe një sërë ra-



Fig. 8

10) Për përdorimin fillestar të portreteve të fëmijëve: W.B. Gercke, Untersuchungen zum roemischen Kinderportraet (Diss. Hamburg 1968) 154 e më tej: K. Fittschen, Boietino dei Musei Comunali di Roma 32, 1985, 13 e më tej.

11) P.C. Sestieri, Bolletino del Museo dell'Impero Romano 13, 1942, 3 e më tej 127 e më tej: Homann-Wedeking, Archeol. Anzeiger 1942, 364 e më tej.

12) Për këtë tregon së fundi Fittschen (shih më lart, ref. 10) 21.

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10

stesh paralele, pikërisht nga koha e Trajanit, në të cilat kokat kanë një model flokësh për të rinjtë ose burrat dhe vetëm nga detaje të ndryshme mund të kuptohet se bëhet fjalë për një vajzë. Në muzeun e Manisës ruhet statuja e plotë (Fig. 6-9)[13] e një vajze me flokë të gjatë, të lëshuar përpara dhe një gërshet, që i bie mbi qafë. Hollësitë janë vërtet të ndryshme nga ato të kokës në Berat, por paraqitja e përgjithshme është shumë e ngjashme me të. Në statujën e Artemisit që vrapon, në Fondi, sikur koka (tani fatkeqësisht ka humbur) të gjendej veças, do të ishte marrë për një të ri, për shkak të modelit të flokëve, por lidhja me trupin dëshmon se kemi të bëjmë me një vajzë.[14]

Një sërë skulpturash kokash të rrumbullakëta, të cilat na kanë arritur të veçuara, do të merreshin për koka djemsh po të shiheshin vetëm nga përpara. Vështrimi nga anët ose nga prapa le të kuptohet

13) J. Inan – E. Rosenbaum, Roman Early Byzantine Portrait Sculpture in Asia Minor (London 1966) 162 Nr. 212 Tab. 115, 3; 117, 3-5; Gercke (shih. më lart ref. 10) 74 e më tej. Nr. FM. 34.

14) Fondi, Municipio: H. Wrede, Consecration in Forman Deorum. Vergoettlichte Privatpersonen in der roemischen Kaiserzeit (Mainz 1981 223 Nr. 84 Tab. 11, 1-2.

gabimi, si me kokën në Berat, qoftë nga modeli i flokëve, qoftë nga lobet e veshit të shpuara për vathë. Përmendim këtu një kokë në Zvicër (pronësi private), e cila është krijuar në kohën e Julius-Klaudiusit (Fig. 10-11)[15], kokën e një vajze, paraqitur si Ceres në Galeria Borghese në Romë[16], dhe një kokë në Aquilea[17], që të dyja të kohës së Trajanit.



Fig. 11



Fig. 12

DO NOT COPY

15) H/Jucker – D. Willers, Gesichter, Griechische and roemische Bildnisse aus Schweizer Privatbesits (Bern 1983) 86 e më tej. Nr. 33.

16) Fittschen (shih. më lart ref. 10, 19 e më tej me shënimin 12, 23, fig. 11.

17) Aquilea, Mus. Arch. Inv. 2628, Gercke (shih më lart ref. 10, 61, Nr. FM 19, V.S.M. Scrinari, Museo Archeologico di Aquilea, Catalogo delle Sculture Romane (Roma 1972) 79 Nr. 239, Fig. 239 – Më tej mund të përmenden: Vatikan Inv. 1528: W. Amelung, Die Sculpturen des Vatikanischen Museums II (Berlin 1908) 442 Nr. 188 Tab. 46 – Amsterdam, Allard Pierson Museum, Inv. 7870: G.A.S. Snijder, in: Antike Plastik, W. Amelung zum 60, Geburtstag (Berlin 1928) 239 e më tej.

C.S. Poger, Katalog der griechischen und roemischen Skulptur, der steinerhen Gegenstoende und der Stuckplas tik im Allard Pierson Museum zu Amsterdam 1942) 55 Nr. 109. Tab. 26, Gercke (shih. më lart ref. 10) 66 Nr. FM 25 Alexandria: shih më lart shën. 2.

DO NOT COPY



Fig. 13



Fig. 14

Më vështirë është me relievet, sepse në to veçoritë e modelit të flokëve në pjesën e prapme të kokës nuk dallohen.

Në një gur varri në Romë, në Museo Nazionale, fustani disi i shkarë nga supi na tregon se kemi të bëjmë me një vajzë, e cila na kujton Afërditën. Mbishkrimi tregon se vajza quhet Ammaea Urbana (Fig. 12-14)[18]. Nga modeli i flokëve më lehtë do të supozohej për paraqitjen e një djali. Mund të përmendim dhe gurë varri që ndodhen në Paris dhe Leiden, si dhe relievin e varrit të një Agrippine në Malibu (Muzeu Getty), punuar më 130-140 e.s, në të cilin fëmija e paraqitur mund të merrej për një të ri[19], por mbishkrimi dhe paralelizmat, ashtu si edhe

18) Romë, Museo Nazzionale Romano, Inv. 39128: A. Giuliano, Museo Nazionale Romano. Le Sculture 7 (Roma 1984) 77 f. Nr. IV 1; Fittschen (shih. më lart ref. 10) 19 e më tej fig. 12; D.E.E. Kleiner, Roman Imperial Funerary Altars with Portraits (Romë 1987) 174 e më tej Nr. 52 Tab. 32, 3-4.

19) Paris, Louvre MA 1443: Wrede (shih më lart shën. 14) 264 e më tej Nr. 183, Tab. 26, 1-2, Kleiner 10 e më tej Nr. 15. Tab. 10, 3-4, – Leiden, Rijksmuseum van Oudheden: F.L. Bastet – H. Brunstig, Crpus Signorum Classicorum Musei Antiquarii Lugduno-Batavi



Fig. 15

koka në Berat, na sigurojnë se është paraqitur një Agrippinë e vogël, pra një vajzë. Krahas statujës në Manisa, në Azinë e Vogël, përmendim edhe relieve varri në Palmirë, Bordo dhe Grac, në të cilat vajzat i kanë flokët të krehura përpara, siç e gjenim normalisht te të rinjtë dhe burrat.[20] Ky model flokësh siç mund të shihet në një sarkofag në Palermo (Fig. 15) mbahet edhe më vonë, të paktën deri në fund të shekullit II e.s. Përsëri, vetëm mbishkrimi na tregon se është paraqitur një vajzë[21]. Modeli i flokëve të krehura mbi ballë është përdorur pra edhe për vajza dhe madje ka qenë i përhapur në pjesë të gjera të perandorisë romake, veçse ky fakt, në përgjithësi, bie fare rrallë në sy.

Përdorimi i të njëjtit model flokësh si për djemtë edhe për vajzat s'është i habitshëm. Edhe sot, ganjëherë fëmijët nuk dallohen nga modeli i flokëve. Pra, si mund të mbanin vajzat e vogla ose pak më të rritura modele aq të komplikuara e të kushtueshme flokësh, siç ishte e zakonshme për zonjat romake në kohën e Flaviusit, të Trajanit dhe më vonë, të cilat ndiqnin modën e përcaktuar nga perandoreshat.[22]

Si përfundim, mund të thuhet se koka në Berat i përket portreteve relativisht të rralla të vajzave të reja, të periudhës perandorake romake. Ajo duhet të ketë qenë pjesë e një statuje varri dhe të jetë punuar në Apoloni rreth viteve 100-110 e.s., madje në një punishte të traditës greke, e cila nxirrte punime shumë cilësore. Modeli i flokëve, thuajse i njëjtë me atë të djemve ka paralele sidomos te vajzat e kohës së Trajanit. Në sajë të punimit dhe veçorive të modelit të flokëve koka e Beratit bën pjesë në portretet më të bukura të periudhës perandorake romake, zbuluar deri tani në Shqipëri.

DO NOT COPY

(Zutphen 1982) 129 Nr. 234 Tab. 65, 2, 66, 1; Kleiner 184 e më tej Nr. 59 Tab. 36,3 Malibu, The J. Paul Getty Museum, Inv. 71, AA. 456: J. Chamay-Frel-J.-L. Mayer, Le Monde des Cesars Portraits Romains (Genf 1982) 166 e më tej; J. Frel, Getty Museum Journal 12, 1984, 75 Nr. 7.

20) Palmyra, Museum Inv. B. 1986/7078: Land des Baal. Syrien-Forum der Voelker (Mainz 1982) 184 e më tej Nr. 175, K. Tanabe, Sculptures of Palmyra I (Tokyo 1986) 33 Tab. 271 – Bordeaux, Musee Archeol.: E. Esperandieu, Recueil General des Bas – Reliefs dela Gaule Romain II (Paris 1908) 192 Nr. 1193, F. Braemer, Les steles funeraires a personnages de Bordeaux (Paris 1959) 24 e më tej Nr. 2 Tab. 1 – Graz, Landes-museum: W. Modrijan-E. Weber, Die Roemersteinsammlung im Eggenberger Schlosspark (Graz 1981) 8 e më tej Nr. 253 – Më tej përmendim basorelieve lokale të pabotuara në Nocera Inferiore, Museum (Campanien) dhe Volos, Museum Greqi.

21) Palermo, Museo Nazionale: V. Tusa, I sarcofagi romani in Sicilia (Palermo 1957) 144 e më tej Nr. 67 Tab. 82 – 83.

22) Për modelet e kushtueshme të flokëve të epokës shih për shembull Fittschen – Zanker (shih më lart shën. 3) Tab. 7-10, 79-86.

Guntram KOCH

DO NOT COPY

EIN KAISERZEITLICHES MÄDCHENPORTRÄT IN BERAT

In Albanien ist eine große Anzahl an kaiserzeitlichen Porträts zu Tage gekommen, und zwar vor allem in Apollonia, Buthrotum und Dyrrachium. Unter ihnen ragt ein Kopf heraus, der in Apollonia gefunden wurde und jetzt im Archäologischen Museum in Berat ausgestellt ist (Abb. 1-5)[1]. Er ist von einer Statue oder Büste abgebrochen, an einigen Stellen (Nase, Ohren, rechte Wange) bestoßen und außerdem teileise beriebt, ist aber insgesamt so gut erhalten, daß die Lebendigkeit und Qualität der Ausführung ausgezeichnet zu erkennen sind. Der Kopf ist zu seiner rechten Seite gedreht und leicht geneigt. Er gibt eine jugendliche Person wieder. Wenn man ihn von vorn betrachtet, würde man meinen, daß es sich um einen jungen Mann handelt; als solcher ist er auch schon angesprochen worden;[2] in der Seiten- und Rückansicht sieht man aber, daß ein geflochtener Zopf vorhanden ist, es ist also ein Mädchen dargestellt.

Die Oberfläche des Gesichtes ist glatt gespannt, aber doch durch feine Hebungen und Senkungen zart belebt. Der Mund ist weich eingebettet, die Trennung der Lippen mit dem Meißel ausgeführt. Die Augen liegen verhältnismäßig tief, die Lider sind weich und wulstig, die Brauen wölben sich leicht vor. Iris und Pupille sind nicht durch Bohrungen oder Ritzungen angegeben. Die Haare liegen sehr eng am Kopf an und bestehen aus dünnen, relativ kurzen, leicht geschwungenen Strähnen, die sich in einzelnen Lagen übereinanderschieben. Über dem linken Auge ist eine Gabel vorhanden, die sich oben auf dem Kopf auch in den weiteren Zonen verfolgen läßt. Die einzelnen Strähnen sind mit feiner Meißelarbeit voneinander abgesetzt und jeveils noch unterteilt. Die Haare rahmen das Gesicht mit einem recht glatten, bogenförmigen Abschluß, nur vor den Ohren stößt eine kleine Locke etwas nach unten. Am Hinterkopf sind die Haare lang belassen und zu einem dünnen, kunstvoll geflochtenen Zopf zusammengenommen, der nach unten herunterfiel. Er lag am Hals nicht auf, sondern war dort frei gearbeietet.

Der Kopf gibt genügend Hinweise, die eine Datierung ermöglichen. Das eng anliegende Haar mit den nach vorn gekämmten Strähnen, die das Gesicht bogenförmig umrahmen, findet sich bei Männer- und Jungenporträts der trajanischen Zeit, und zwar, wie es scheint, vor allem der frühen Phase. Zu vergleichen sind frühe Porträts des Kaisers Trajan, bei denen die Haarkappe noch relativ eng anliegt, während sie bei den späteren dicker wiedergegeben ist, sich stärker vom Kopf abhebt und tiefere Rillen zeigt, die die einzelnen strähnen schärfer unterteilen.[3] Eine Reihe von Privatporträts läßt sich an die frühen Bildnisse des Kaisers anschließen.[4] Beim Kopf in Berat sind allerdings die Strähnen nicht so lang, wie das beim Bildnis des Kaisers und auch in der Regel bei den Privatporträts der Fall ist. Dennoch spricht nichts dagegen, das Stück in die frühe Zeit des Kaisers Trajan (Regierungszeit 98 – 117 u.Z.), also etwa die Jahre 100 – 110 u.Z. zu datieren. Auch andere Eigenarten des Kopfes, wie der etwas herbe Ausdruck, der im Nacken herabfallende Zopf[5] und die kleine Locke vor den Ohren,[6] haben Parallelen in dieser Zeit.

In Apollonia ist eine bedeutende Zahl von vorzüglichen Porträts der römischen Kaiserzeit gefunden worden.[7] Sie stellen verschiedene Probleme. Denn im Gebiet Albaniens ist kein Marmor vorhanden, und es bestand keine Tradition seiner Bearbeitung. Idealplastik, dekorative Reliefs, Grabaltäre, Sarkophage, Porträts von Kaisern und viele andere Skulpturen aus Marmor können in fertig ausgearbeitetem Zustand importiert worden sein[8]. Porträts privater Personen werden aber in der Regel am Orte selbst oder in der Nähe ausgeführt worden sein. Es muß also in Apollonia Bildhauerwerkstätten, und zwar auch solche mit hohem künstlerischem Niveau, gegeben haben, die Porträts angefertigt haben. Obwohl bisher die meisten Funde aus Apollonia schlecht oder gar nicht zugänglich sind, läßt sich feststellen, daß die dortigen Bildhauer nicht in stadtrömischer, sondern in östlicher, und zwar teilweise wohl in attischer Tradition standen. Die Gesichter sind vielfach lebendiger, als man das in Rom erwarten würde, die Haare sind allerdings stärker vereinfacht und die Führung der Locken ist nicht so präzise[9]. Beim hier behandelten Kopf sprechen die Lebendigkeit der Oberfläche des Gesichtes und der Reichtum an Details im Haar dafür, daß das Stück nicht in stadtrömischer, sondern in griechischer Hand-

werkstradition steht. Genauere Aufschlüsse wird eine Untersuchung der in Apollonia und im sonstigen Albanien gefundenen Porträts sowie der anderen Marmorskulpturen der römischen Kaiserzeit ergeben.

Der Kopf wird zu einer Gewandstatue gehört haben, über deren Typus sich allerdings nichts sagen läßt. Das Alter des Mädchens ist schwer zu schätzen, vielleicht war est etwa vierzehn Jahre alt. Um eine Ehrenstatue, die irgendwo in der Öffentlichkeit aufgestellt war, wird es sich kaum gehandelt haben. Möglich wäre, daß das Mädchen ein Weihgeschenk in einem Heiligtum gewesen ist, aber in erster Linie kommt – wie wohl beim überwiegenden Teil der Porträts von Kindern und Jugendlichen – nur eine Grabstatue in Frage, die sich in oder bei der Grabanlage einer reichen Familie oder auch in ihrem Haus befunden hat.[10] Reste eines Grabtempels, in dem zwei Porträts und Teile einer dritten Statue zu Tage kamen, sind in Apollonia aufgedeckt worden.[11] Für die Zweckbestimmung des Kopfes in Berat als Grabstatue spricht auch, daß er eine gewisse, wenn auch zurückhaltende Traurigkeit zeigt, wie sie häufig bei den Porträts von Kindern zu finden ist.[12]

Besondere Aufmerksamkeit beansprucht der Kopf wegen der Frisur, denn er hat einen für Jungen und Männer charakteristischen Schnitt der Haare, wie man zunächst annehmen möchte, aber einen Zopf, der ihn als Porträt eines Mädchens ausweist. Es läßt sich eine Reihe von Parallelen nennen, und zwar vor allem aus trajanischer Zeit, bei denen Köpfe eine Jungen-oder Männerfrisur haben und nur an verschiedenen Details zu erkennen ist, daß es sich um Mädchen handelt. Eine vollständige Statue ist im Museum in Manisa erhalten (Abb. 6-9);[13] das Mädchen hat längere Strähnen, die nach vorn gekämmt sind, und einen Zopf, der im Nacken herabfällt. Die Einzelheiten sind zwar anders als beim Kopf in Berat, die Gesamtanlage geht mit ihm aber eng überein. Bei der Statue einer laufenden Artemis in Fondi ist der Kopf jetzt leider verloren; man hätte ihn, wenn er allein gefunden wären, wegen der typischen Männerfrisur sicher für den eines Jungen gehalten, die Verbindung mit dem Körper beweist aber, daß es sich um ein Mädchen handelt.[14] Eine Reihe von allein erhaltenen rundplastischen Köpfe würde man ebenfalls für die von Jungen halten, wenn man sie nur von vorn sieht, erst in der Seiten- und Rück- ansicht ergibt sich, wie beim Kopf in Berat, an der Frisur oder beispielsweise an den Ohrläppchen, die für Ohrringe durchbohrt sind, daß es sich um Mädchen handelt. Angeführt seinen ein Kopf in Schweizer Privatbesitz,der in julisch-claudischer Zeit entstanen ist (Abb. 10-11),[15] der Kopf eines Mädchens, das als Ceres dargestellt ist, in der Galleria Borghese in Rom,[16] und ein Kopf in Aquileia,[17] beide aus trajanischer Zeit. Schwieriger wird es bei Reliefs, da dort Besonderheiten der Frisur am Hinterkopf nicht zu erkennen sind. Bei einem Grabaltar in Rom, Museo Nazionale, weist das etwas von der Schulter gerutschte Gewand, das auf Aphrodite anspielt, auf eine Mädchen, Gewißheit haben wir hier durch die Inschrift, die eine Ammaea Urbana nennt (Abb. 12-14);[18] bei der Frisur hätte man eher vermutet, daß ein kleiner Junge abgebildet ist. Anschließen lassen sich Grabaltäre in Paris und Leiden sowie das schon um 130 40 u.Z. entstandene Grabrelief einer Agrippina in Malibu, Getty-Museum, bei dem man das dargestellte Kind auch für einen Jungen halten würde;[19] die Inschrift und die Parallelen, unter ihnen der Kopf in Berat, sichern aber, daß die kleine Agrippina, also ein Mädchen, abgebildet ist. Neben der Statue in Manisa in Kleinasien seien noch Grabreliefs in Palmyra, Bordeaux und Graz angeführt, bei denen die Mädchen die Haare in einer Weise nach vorn frisiert haben, wie sie sich in der Regel bei Männern und Jungen findet.[20] Diese Frisur hält sich auch weiter, zumindest bis an das Ende des 2. Jhs. u.Z., wie man auf einem Sarkophag in Palermo sehen kann (Abb. 15); wiederum zeigt nur die Inschrift, daß ein Mädchen dargestellt ist.[21] Die Frisur mit den in die Stirn gekämmten Haaren ist also auch für Mädchen verwandt worden, und zwar räumlich weit verbreitet im römischen Reich; insgesamt tritt sie aber recht selten auf.

Es braucht nicht zu verwundern, daß eine Jungenfrisur auch für Mädchen benutzt worden ist. Auch heute sind Kinder manchmal an ihrer Frisur nicht zu unterscheiden, und wie sollten wohl die kleineren und größeren Mädchen so komplizierte und aufwendige Frisuren tragen, wie sie in flavischer trajanischer und auch noch späterer Zeit bei den römischen Damen üblich waren, die der durch die Kaiserinnen bestimmten Mode folgten?[22]

Zusammenfassend läßt sich also feststellen, daß der Kopf in Berat zu den relativ seltenen kaiserzeitlichen Porträts junger Mädchen gehört. Er dürfte zu einer Grabstatue gehört haben und um 100 – 110 u.Z. in Apolonia gearbeitet worden sein, und zwar in einer Werkstatt, die in griechischer Bildhauertradition stand und sehr qualitätsvolle Arbeiten hervorbrachte. Für die ungewöhnliche Frisur, die man zunächst für die eines Jungen halten würde, gibt es bei Mädchen vor allem der trajanischen Zeit Parallelen. Wegen der feinen Ausführung und der Besonderheiten der Frisur gehört der Kopf in Berat zu den schönsten

PHOTOCOPY

kaiserzeitlichen Porträts, die bisher in Albanien gefunden worden sind.

Der Verf. dankt dem Kultusministerium und dem Institut für Denkmalpflege in Tirana für die Einladung nach Albanien im Juni 1987.

1) C. Patsch Das Sandschak Berat in Albanien (1904) 160-161 Nr. 16 Abb 131-132. Berat, Archäologisches Museum Inv. 4788. Höhe 0,245 m. Aus Apollonia. Relativ feinkörniger Marmor, leicht gelblichbraun verwittert.

2) L'Art Albanais a travers les siècles, Paris, Petit Palais 1974-75 (Paris 1974) Nr. 249; L'arte albanest nei secoli, Ausstellung Rom 1985 (Rom. 1985) 91 Nr. 348. – Es handelt sich nicht um einen »Isis-Zopf«, der von Jungen getragen werden kann. V. von Gonzenbach, Untersuchungen zu den Knabenweihen im Isiskult der römischen Kaiserzeit (Bonn 1957) 55 ff. Taf. 2,5; E. Simon, in: Eikones. Studien zum griechischen und römischen Bildnis, H. Jucker gewidmet (Bern 1980) 173 ff. Taf. 59. – Der Kopf in Alexandria gehört nicht zu dieser Gruppe, er stellt wegen der Breite des Mittelzopfes und der Welle an den Seiten in Mädchen dar: N. Bonacasa, Archeol. Classica 20, 1968, 274 ff. Taf. 112/13. 114,1; Simon a.O. 175.

3) K. Fittschen – P. Zanker, Katalog der römischen Porträts in den capitolinischen Museen und andtren kommunalen Sammlungen der Stadt Rom I (Mainz 1985) 39 f. Nr. 39. 40 Taf. 41 – 43 (1. Typus); 40 ff. Nr. 41. 42 Taf. 44 – 47 (spätere Typen).

4) G. Daltrop, Die stadtrömischen männlichen Privatbildnisse trajanischer und hadrianischer Zeit (Münster 1958) 23 ff. Abb. 5 ff.; P. Zanker, in: Eikones (siehe oben Anm. 2) 196 ff. Taf. 65 ff.

5) Er findet sich beispielsweise bei Plotina, vgl. Fittschten-Zanker a.O. III (Mainz 1983) 8 f. Nr. 7 Taf. 9 (vergleiche zum Beispiel auch 59 f. Nr. 79 Taf. 99).

6) Fittschen-Zanker a.O. III 59 ff. Nr. 79 Taf. 99; Nr. 80 Taf. 100; Nr. 82 Taf. 103.

7) Die in Albanien gefundenen kaiserzeitlichen Porträts sind bisher noch nicht zusammenfassend publiziert worden; hier sei nur verwiesen auf einige Beispitele: Shqipëria Arkeologjike (Tirana 1971) Taf. 96. 88 – 91; A. Baçe – N. Ceka, Monumentet 22, 1981, 43; N. Ceka, Apolonia e Ilirisë (Tirana 1982) 109; Farbtafel vor S. 217; 223; Farbtaf, nach S. 224; 225. 226; S. Islami, Les Illyriens (Tirana 1985) Abb. 49 – 51; L'Arte albanese (siehe oben Anm. 2) 90 ff. Nr. 345. 346. 349 – 351. 353 – 355.

8) Ein besonders schönes Beispiel ist die Statuette der Athena Partenos aus Apollonia, die von dem Athener Euhemeros signiert ist: Shqipëria Arkeologjike (Tirana 1971) Taf. 90; P. R. Franke, Albanien im Altertum. Sonternummer Antike Welt 1983, 45 Abb. 91.

9) Zur provinziellen Porträtplastik der Kaiserzeit in Griechenland: A. Giuliano, La cultura artistica delle province della Grecia in età Romana (Rom. 1965) 52 ff. 72 ff.; C. C. Vermeule, Roman Imperial Art in Greece and Asia Minor (Cambridge 1968) 169 ff.; P. Zanker, Provinzielle Kaiserporträts (München 1983) 26 ff. und passim.

10) Zur ursprünglichen Verwendung der Porträts von Kindern: W. B. Gercke, Untersuchungen zur römischen Kinderporträt (Diss. Hamburg 1968) 154 ff.; K. Fittschen, Bolletino der Musei Comunali di Roma 32, 1985, 13 ff.

11) P. C. Sestieri, Bulletino del Museo dell' Impero Romano 13, 1942, 3 ff. 127 ff.; E. Hommann-Wedeking, Archäol. Anzeiger 1942, 364 ff.

12) Darauf weist zuletzt Fittschen a.O. (s. oben Anm. 10) 21 hin.

13) J. Inan – E. Rosenbaum, Roman and Early Byzantine Portrait Sculpture in Asia Minor (London 1966) 162 Nr. 212 Taf. 115, 3; 117, 3 – 5; Gercke a.O. (siehe oben Anm. 10) 74 f. Nr. FM 34.

14) Fondi, Municipio: H. Wrede, Consecratio in Forman Deorum. Vergöttlichte Privatpersonen in der römischen Kaiserzeit (Mainz 1981) 223 Nr. 84 Taf. 11, 1 – 2.

15) H. Jucker – D. Willers, Gesichter. Griechische und römische Bildnisse aus Schweizer Besitz (Bern 1983) 86 f. Nr. 33.

16) Fittschen a.O. (siehe oben Anm 10) 19 ff. mit Anm. 12; 23 Abb. 11.

17) Aquileia, Mus. Arch. Inv. 2628; Gercke a.O. (siehe oben Anm. 10) 61 Nr. FM 19;

DOKUMENTATION

V. S. M. Scrinari, Museo Archeologico di Aquileia. Catalogo delle Sculture Romane (Rom 1972) 79 Nr. 239 Abb. 239. – Weiterhin lassen sich nennen: Vatikan Inv. 1528: W. Amelung, Die Sculpturen des Vaticanischen Museums II (Berlin 1908) 442 Nr. 188 Taf. 46. – Amsterdam, Allard Pierson Museum, Inv. 7870: G. A. S. Snijder, in: Antike Plastik, W. Amelung zum 60. Geburtstag (Berlin 1928) 239 ff.; C. S. Ponger, Katalog der griechischen und römischen Skulptur, der steinernen Gegenstände und der Stuckkplastik im Allard Pierson Museum zu Amsterdam (Amsterdam 1942) 55 Nr. 109 Taf. 26; Gercke a.O. (siehe oben Anm. 10) 66 Nr. FM 25. – Alexandria: siehe oben Anm. 2.

18) Rom, Museo Nazionale Romano, Inv. 39128: A. Giuliano, Museo Nazionale Romano. Le Sculture I 7 (Rom 1984) 77 f. Nr. IV 1; Fittschen a.O. (siehe oben Anm. 10) 10 ff. Abb. 12; D. E. E. Kleiner, Roman Imperial Funerary Altars with Portraits (Rom 1987) 174 f. Nr. 52 Taf. 32, 3 – 4.

19) Paris, Louvre MA 1443: Wrede a.O. (siehe oben Anm. 14) 264 f. Nr. 183 Taf. 26, 1 – 2; Kleiner a.O. 19 ff. Nr. 15 Taf. 10, 3 – 4. – Leiden, Rijksmuseum van Oudheden: F. L. Bastet – H. Brunstig,Corpus Signorum Classicorum Musei Antiquarii Lugduno-Batavi (Zutphen 1982) 129 Nr. 234 Taf. 65, 2; 66, 1; Kleiner a.O. 184 ff. Nr. 59 Taf. 36, 3 – Malibu, The J. Paul Getty Museum, Inv. 71.AA.456: J. Chamay – J. Frel – J.-L. Mayer, Le Monde des Cesars. Portraits Romains (Genf 1982) 166 f.; J. Frel, Getty Mustum Journal 12, 1984, 75 Nr. 7.

20) Palmyra, Museum Inv. B 1986/7078: Land des Baal. Syrien – Forum der Völker (Mainz 1982) 184 f. Nr. 175; K. Tanabe, Sculptures of Palmyra I (Tokyo 1986) 33 Taf. 271. – Bordeaux, Musée Archéol.: E. Espérandieu, Recueil Général des Bas-Relitfs de la Gaule Romaine II (Paris 1908) 192 Nr. 1193; F. Braemer, Les stèles funéraires a personnages de Bordeaux (Paris 1959) 24 ff. Nr. 2 Taf. 1. – Graz, Landesmuseum: W. Modrijan – E. Weber, Die Römersteinsammlung im Eggenberger Schloßpark (Graz 1981) 8 f. Nr. 253. – Weiterhin sind unpublizierte lokale Grabreliefs in Nocera Inferiore, Museum (Campanien), und Volos, Museum (Griechenland), anzuführen.

21) Palermo, Museo Nazionale: V. Tusa, I sarcofagi romani in Sicilia (Palermo 1957) 144 f. Nr. 67 Taf. 82 – 83.

22) Zu den aufwendigen Frisuren der Zeit siehe zum Beispiel Fittschen-Zanker a.O. (siehe oben Anm. 3) Taf. 7 – 10. 79 – 86.

Abbildungsunterschriften

Abb. 1 – 5 Kopf eines Mädchens, Berat
6 – 9 Statue eines Mädchens, Manisa
10 – 11 Kopf eines Mädchens, Privatbesitz
12 – 14 Grabaltar der Ammaea Urbana, Rom
15 Porträt der Volusia Longina auf einem Sarqophag, Palermo

DO NOT COPY

DO NOT COPY

DO NOT COPY

Sotir KOSTA
Uliam ÇIKOPANO

MOZAIKU I BAZILIKËS PALEOKRISTIANE NË TEPE TË ELBASANIT. VLERAT DHE RESTAURIMI[1]

Në vitin 1968, gjatë punimeve bujqësore në kodrën me ullishta mbi urën e Zaranikës në të hyrë të Elbasanit, u zbuluan mbetje muresh të vjetra (fig. 1). Menjëherë nisën gërmimet arkeologjike, të cilat vazhduan edhe në vitin 1969[2]. Gërmimet e vitit 1969 nxorrën në dritë tërësisht rrënojat e një bazilike paleokristiane (fig. 2). Bazilika me absidë gjysmë rrethore orientohej nga lindja[3]. Nga ndërtimi i parë dallohen qartë gjurmët e nefit qendror (9 m x 5,30 m), që ndahej nga aniatat veriore e jugore (secila 16,35 x x 2,15 m) me dy arkada mbi pilastra. Disa fragmente kolonash të vogla tregojnë se për ndriçimin e anijatës qendrore kishte dritare dyshe. Bazilika e cila shërbente si kishë varrezë e Skampinit pësoi në kohë disa ndryshime e plotësime në aspektin arkitektonik. Kështu, u mbyllën hapësirat midis pilastrave që ndanin sallën qendrore me anijatat dhe rreth bazilikës u ndërtuan mjedise të reja ndihmëse. Në anën lindore të nefit qendror, për të ndarë ambientin e altarit, ndërtohet një ikonostas i gurtë, me kolona e kapitele të gdhendura sipas kërkesave të kohës. Ndërtime shtesë janë bërë edhe në anën perëndimore të bazilikës duke krijuar një ekzonarteks për funksione varrimi, që ngjan me rindërtimin e shekullit VI në Kalanë e Skampinit (porta lindore e saj).



Fig. 1

Gjurmët e një kapele të vogël me gur e llaç balte, në vendin ku ka qenë altari, tregojnë se këto ndërtime janë kryer mbase «... pas tërmetit të vitit 519, kisha ish rrënuar dhe nuk funksiononte më». Ndërkohë, brenda kalasë së Skampinit ishte ngritur Katedralja e Shën Pjetrit dhe Bazilika e Tepesë nuk pëson më rindërtime...[4]

1) Emrin «tepe» që don të thotë «kodër» e ka marrë që nga koha e pushtimit turk.

2) Gërmimet e v. 1968 u kryen nën udhëheqjen e arkeologut N. Ceka (atëhere, punonjës i Muzeut Historik të Elbasanit). Ndërsa ato të vitit 1969 drejtoheshin nga A. Meksi arkitekt-restaurator pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës.

3) A. Meksi, N. Ceka, «Bazilika paleokristiane në Tepe – Elbasan» Buletin Arkeologjik, Tiranë 1972, f. 184.

4) N. Ceka – A. Meksi, Vepër e cituar, f. 188.

DO NOT COPY



Fig. 2

* * *

Mozaiku zbukuronte vetëm sallën qendrore të kishës (anijatën qendrore fig. 7). Ai ishte konceptuar si një tërësi motivesh gjeometrike (rrathë, që ndërpriten apo takohen në perimetrinë e tyre, rombe, rozeta katër a më shumë petaleshe, trekëndësha, gërsheta, luspa, etj). Këto motive të gërshetuara harmonishëm, të orientuara nga parimet e simetrisë janë shpërndarë në katër panela të barabarta dy e nga dy. Ata rrethohen dhe ndahen nga njëri-tjetri nga pllaka shtufi.

Panelet e anës perëndimore, secili me përmasa 5 m x 1,70 m, kanë koncept kompozicional dhe motive të njëjta. Një buzinë gërsheti e gjerë 20 cm i kufizon ata anash dhe i ndan në katër pjesë. Dy pjesë nga ana e murit perëndimor kanë të njëjtin motiv, që përsëritet në të gjithë fushën, atë të rrathëve që ndërpresin barabar njëri-tjetrin, në katër pika të perimetrit (fig. 8). Nga ndërprerja e çdo katër rrathëve të tillë, me diametër 25 cm, krijohet një lule katërpetalëshe, e cila është pikturuar me gurë gëlqerorë të bardhë. Ndërsa figura e rombit me brinjë të harkuara, që krijohet brenda rrathëve, është mbushur me gurë të kuq prej balte të pjekur. Një brez tregurësh i bardhë e lidh zbukurimin e rrathëve me buzinën e gërshetit, e cila është formuar me tri radhë gurësh të bardhë, të kuq e të zinj. Pas buzinës, vërehet përsëri një rrip tregurësh i bardhë, i cili mbyll gjithë panelin e anës perëndimore. Dy pjesët e tjera të paneleve perëndimorë, ata në lindje të tij, kanë po ashtu, motive e përmasa të njëjta. Sipërfaqen katërkëndëshe të tyre e kufizon brezi i gërshetit njësh. Pas tri rreshtave të bardha, në të katër qoshet e sipërfaqes së

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

këtij katërkëndëshi janë formuar katër trekëndësha këndrejtë, hipotenuzat e të cilëve formojnë një romb. Brenda trekëndëshave, nga këndi i drejtë, dalin zambakë trigjethesh. Në qendër të rombit me brinjë të barabarta, rreth 1,10 m, është pikturuar një rozetë tetëpetalëshe me diametër 70 cm.

Panelet e anës lindore janë të barabarta në përmasa (secili 3,50 x 1,70 m) dhe kanë të njëjtat motive, me përjashtim të një skene të eukaristisë tepër e fragmentuar, vendosur në një sipërfaqe katërkëndëshe 1,5 m x 0,70 m, në anën lindore të këtyre paneleve. Në panelin e anës verilindore vërehet i fragmentuar një mbishkrim, nga i cili kanë mbetur 4 gërmat e fundit (fig. 9). Në secilin nga këta panele, veç katërkëndëshit për skenat e eukaristisë dhe gërmave, janë pikturuar dy rrathë me diametër 1,05 m, brenda të cilëve ka katrorë. Të dy katrorët e anës perëndimore, të rrethuar me motivin e gërshetit, në qendër kanë një katror të vogël me brinjë 40 cm, të formuar nga katër breza gurësh, dy të bardhë e dy të zinj. Në qendër, në një fushë gurësh të bardhë, është pikturuar një kryq me gurë të zinj. Dy radhë gurë-tullë të kuq e të zinj formojnë katrorë me brinjë të dhëmbëzuara. Në qendër të kryqit të zi është vendosur një kubik i bardhë. Gërsheti, i pikturuar me gurë okër, lejla e konture bardhë e zi qëndron mbi një sfond gurësh të zinj.

Katrori i madh dhe rrethi kanë si kufi breza tregurësh të bardhë. Një brez tjetër me kubikë tulle të kuq formon rrethin e madh. Kjo buzinë e kuqe ndërpritet në katër pika të barabarta nga figurat e gjashtë katrorëve. Hapësirat midis brinjëve të katrorëve të mëdhenj dhe rrathëve janë mbushur me gurë ngjyrë okër e lejla.



Fig. 5



Fig. 6

DO NOT COPY



Fig. 8



Fig. 9



Fig. 10



Fig. 11

DO NOT COPY



Fig. 12



Fig. 13

Në dy rrathët e anës lindore, fusha e katrorëve ka figurën e luspave të vizatuara me nga dy breza dygurësh të zinj e të bardhë. Luspat në qendër janë mbushur me kubikë tulle të kuq, që ndërpriten pas çdo radhe të pjerrtë nga gurë ngjyrë lejla dhe okër. (fig. 10).

Në katrorët e vegjël të vendosur në qoshet e paneleve lindore ka lule katër fletëshe, të pikturuara diagonal dy e nga dy me kubikë tulle të kuq e të zinj (fig. 11).

Në dy katrorët e qosheve veriore, në sfondin e gurëve të bardhë, është formuar një rreth dygurësh të zinj, brenda të cilit ndodhet një romb i bardhë, me brinjë të harkuara drejt qendrës së rrethit. (fig. 12). Hapësirat midis harqeve të rombit dhe harkut të brendshëm të rrethit të zi janë mbushur me kubikë tulle të kuq.

Midis rozetave katërpetalëshe krijohet një katërkëndësh, brinjët më të gjata të të cilit formohen me kubikë tulle të kuq dy radhësh (fig. 12). Hapësirat midis harqeve të kuqe mbushen me gurë lejla, ndër-



Fig. 14

sa dy brinjët e vogla, që kufizojnë rozetat me kubikë tulle të kuq mbushen me gurë lejla. Kufijtë e fundit të harqeve, që dalin nga brinjët e paneleve, takohen me një brez tregurësh të zinj e pas këtij me një tjetër të bardhë. Hapësirat midis brezit të zi të drejtë mbushen me gurë lejla. Para tyre ka një brez të bardhë që lidhet me atë të harkut, e mandej një tjetër brez me gurë okër.

DO NOT COPY



Fig. 15

Skena e eukaristisë trajtuar me një mënyrë të lirë ka qenë pikturuar në një sfond gurësh të bardhë. Aty këtu duken gjurmë gjethesh të pikturuara me kubikë tulle të kuq, pa konturime. Degët e bimës janë të pikturuara me gurë të zinj. Për këtë skenë s'mund të flitet më gjatë, për shkak të shkallës së madhe të dëmtimit të saj (fig. 13).

Mozaiku i Bazilikës së Tepesë paraqet mjaft interes. Në të dallohet qartë përpjekja për të gërshetuar me saktësi elementet gjeometrike. Ngjyrat që mbushin sipërfaqet brenda figurave gjeometrike lehtësojnë leximin e mjeteve shprehëse.

Të gjitha ngjyrat: e zeza, grija, okra, e kuqja e tullës, e bardha dhe lejlaja janë në harmoni. Akoma më shumë e ngre vlerën dekorative mos përdorimi i kufizimeve njëvijëse. Teknika e radhitjes së drejtpërdrejtë të kubikëve, përgjithësisht me madhësi 1 cm², ka lehtësuar ndjeshëm mbylljen e dekoracionit. Në këtë vështrim spikat karakteri polikrom, thjeshtësia në stilizimin e figurës gjeometrike.

Gjendja para punimeve të restaurimit. Mozaiku, duke u gjendur afër sipërfaqes së tokës (rreth 20 cm thellë), veç veprimit të agjentëve atmosferikë, ka qenë shpesh nën goditje të ndryshme shkatërrimtare, nga të cilat punimi i tokës ka qenë thuajse i vazhdueshëm. Bimësia e egër dhe e butë e llojeve të ndryshme ka shkatërruar strukturën e mozaikut.

Edhe gjysma e sipërfaqes së mozaikut që ruhej trashëgonte plagët e vjetra. Gurët ishin zhvendosur, thuajse, krejtësisht nga shtrati mbajtës (nukleusi) e një pjesë e tyre qëndronin larg vijave të dekorit. Rrënjët e një ulliri, i cili u hap gjatë gërmimeve arkeologjike të vitit 1969, kishin shkaktuar dëme të mëdha. Kubikët me ngjyrë okër, një pjesë e gurëve gëlqerorë dhe shtufi paraqisnin probleme konservimi. Ata ishin djegur nga koha e kishin çarje dhe shpërbërje të patinës origjinale. Struktura e llaçit (në të dy shtresat) kishte pësuar çarje e shembje të theksuara (fig. 14).

Kudo vëreheshin çarje, shembje, plasaritje e zhvendosje nga nukleusi. Muri i anës jugperëndimore thuajse mungonte krejtësisht, ndërsa altari dhe dyshemeja e absidës nuk ruheshin. Në pllakat e shtufit, që formonin brezat kufizues të paneleve të mozaikut, dukeshin qartë shpërbërje të shumta.

Ndërhyrjet restauruese[5]. Mozaiku paraqiste nevojën për punime restauruese. Sipërfaqja e mozaikut duhet të shkulej e të vendosej përsëri në vendin e vet. Mbas heqjes së barërave përforcuam kubikët e zhvendosur nga shtrati mbajtës me llaç të dobët (pa çimento). Kjo masë paraprake na dha mundësi të kryenim pastrimin e sipërfaqes së mozaikut dhe ngjitjen e bezeve.

Fragmentet e shkulura do t'i rivendosnim brenda kohës së ekspeditës. Pas shkuljes u vu re se llaçi, përgatitur disi dobët, ndahej lehtë nga shtresa e kubikëve. Gëlqerja nuk kishte sasinë dhe cilësinë e duhur për lidhje. Heqja me lehtësi e nukleusit sidomos në panelin e parë (në atë me fragmentin e inicialeve) evidentoi fare qartë shtresën niveluese të rudusit (atë e ruajtëm si dëshmi gjatë rivendosjes). Vëzhgimet mbi stratigrafinë e mozaikut të shkulur treguan se mjeshtrat kishin ndjekur traditën. Menjëherë pas tabanit të tokës kishin ndërtuar, për drenazhim, një shtresë me mbeturina tullash e tjegullash të niveluara me llaç gëlqereje të ashpër, të trashë 3-4 cm, mbi të cilën vendosej një shtresë e dytë, rreth 5-6 cm me pluhur tulle, gëlqere të vjetëruar e rërë, ku ishin fiksuar kubikët (fig. 15).

Fragmentet e shkulura e të pastruara u formuan në pllaka më vete, 4 cm të trasha e secila me armaturë metalike. Drejtpërsëdrejti mbi kubikët u hodh një shtresë llaçi bastard e markës 70 kg/cm². Në përmbajtjen e këtij llaçi provuam të përdorim edhe një pjesë nga llaçi harasan origjinal, i cili, me pluhur të ri tjegulle, pluhur granili të bardhë e pak çimento të bardhë e gëlqere, mundësoi lidhjen e mirë të kubikëve. Llaçi i ri i përdorur në bërthamë të strukturës së mozaikut të kujton në një farë mase llaçin e vjetër. Rivendosja e mozaikut u krye në vendin origjinal duke respektuar kuotat dhe pjerrësinë e sipërfaqes.

Rivendosja e fragmenteve të zhvendosura u krye mbi një shtresë të freskët llaçi bastard të markës 50, me trashësi rreth 2 cm. Pas 4-5 ditësh, fragmenteve të restauruara iu hoq një shtresë e hollë llaçi (rreth 2 mm), që të krijohej një vështrim tërësor i veprës, një perceptim harmonik (fig. 16, 17, 18).

Me rëndësi ishin edhe punimet e zhvendosjes dhe rivendosjes së të gjitha brezave me pllaka shtufi. Copat e dëmtuara u shkulën dhe u vendosën sipas parimit të lëvizjeve të drejtpërdrejta, të orientuara nga numrat që i viheshin çdo cope. Boshllëqet u mbushën me llaç bastard (me pak çimento).

Duke ndjekur gjurmët e murit jugor dhe atij perëndimor, si dhe mbetjet e një pragu, realizuam ngritjen e tyre, e cila do të shërbente për perceptimin e

5) Punimet restauruese u kryen në vitet 1976-1980 nga Dega e Monumenteve të Kulturës Tiranës nën drejtimin e autorëve.

Do not copy

DO NOT COPY



Fig. 16



Fig. 17

arkitekturës dhe si mbrojtëse e mozaikut. Meqenëse mozaiku gjendej nën influencën e drejtëpërdrejtë të natyrës, ndryshimeve atmosferike etj, sipërfaqja e tij u mbulua me një shtresë rëre lumi të larë, rreth 15 cm të trashë.

* * *

Mozaiku i dyshemesë së bazilikës paleokristiane



Fig. 18

të Tepesë është dëshmi e ndjekjes së traditës. Prania e mjaft elementeve të skulpturës dekorative në gur tregon qartë bashkëjetesën e dy arteve, ndër të cilët shkëlqimin më të madh e kishte mozaiku. Mjeshtrat mozaicistë kanë njohur mirë konceptet kompozicionale, teknikën dhe materialet e kohës. Motive të tilla, si: rrathët e ndërthurur (të mëdhenj e të vegjël), katrorët e katërkëndëshat, luspat, lulet katërfletëshe, të përdorura bashkarisht ndihmojnë që të krijohen përfytyrime të goditura zbukurimesh.

Për t'u vënë në dukje, në panelet e mozaikut të Elbasanit, është harmonizimi i ngjyrave dhe sidomos përdorimi me shije i kubikëve në ngjyrë të kuqe dhe vjollcë.[6] Pjesët e skulpturës dekorative-arkitektonike, kolona me kanelyra përdredhëse, kapitelet korintike e kompozite, korniza, parapetet etj, që zbukurojnë mjedisin lindor të Bazilikës (altarin, ikonostasin) janë gdhendur me mjeshtëri. Ato të kujtojnë krijimet e fillimeve të arkitekturës paleokristiane, tek e cila si edhe në artet e tjera duken frymëzime nga zhvillimet kulturore të antikitetit të vonë.

Përdorimi i pllakave të shtufit rreth katër paneleve të mozaikut krijojnë imazhin e një kryqi të hirtë, me aksin e zgjatur nga ana perëndimore e sallës, që përbën një rast të veçantë.

Ndërhyrjet restauruese patën qëllim mënjanimin e mëtejshëm të dëmtimeve dhe evidentimin e vlerave të mozaikut. Përdorimi i llaçit bastard, shmangia e pranisë së çimentos në shtresën e nukleusit (bërtha-

6) S. Anamali – S. Adhami, Mosaiques de l'Albanie (broshurë) Tiranë 1974, f. 13.

mës) do të lejojë të punohet pa vështirësi në mozaik.

Mendohet që mozaiku të jetë ndërtuar gjatë gjysmës së dytë të shek. V të erës sonë. Tërmeti i vitit 518, bashkë me muret e çatinë shkatërroi rëndë edhe shtrojen me mozaikë. Skampini ndërkohë, siç vërejtëm më lart, ka katedralen e Shën Pjetrit, e cila përmendet në vitin 519.[7]

Të dhënat e përftuara nga studimi paraprak arkeologjik e arkitektonik, si dhe nga punimet restauruese mund të thellohen më tej nëpërmjet sondazheve në vetë monumentin dhe studimit krahasues me monumente të tjera.

DO NOT COPY

7) A. Meksi, **Arkitektura paleokristiane në Shqipëri,** Monumentet 2/1985, f. 17.

Sotir KOSTA
Uliam ÇIKOPANO

DO NOT COPY

LA MOSAÏQUE DE LA BASILIQUE PALEOCHRETIENNE À TEPÉ D'ELBASAN. LES VALEURS ET SA RESTAURATION

RESUME

En 1968, au cours des travaux agricoles, sur une colline plantée d'oliviers, à l'entrée de la ville d'Elbasan furent découvertes les traces d'une ancienne construction.

Les fouilles archéologiques effectuées en 1969 mirent au jour la planimétrie complète d'une basilique paléochrétienne avec quelques pièces annexes. La nouvelle fonction de la basilique comme église-cimetière, apporta quelques changements et complètements du point de vue architectonique. Les espaces entre les pilastres qui séparaient la salle centrale des nefs furent murés et d'autres pièces annexes furent construites.

La mosaïque décorait seulement la nef centrale de l'église. Elle était conçue comme un ensemble de motifs géométriques (cercles qui s'entrecoupent ou qui se joignent à leur périmètre, losanges, rosaces, triangles, tresses, écailles etc) ces motifs, entremêlés de façon harmonique, selon les principes de la symétrie, sont répartis en quatre panneaux deux à deux égaux.

Deux fragments, ceux du côté du mur occidental représentent le même motif qui se répète, celui des cercles qui s'entrecoupent au milieu. Les deux autres fragments de panneaux occidentaux représentent également des motifs à dimensions égales. Leur superficie quadrangulaire est entourée d'une bande représentant une tresse. A l'intérieur de trois lignes blanches, aux quatre coins de sa superficie quadrangulaire il y a quatre triangles réctangles dont les hypoténuses forment les côtés d'un losange. A l'intérieur des triangles li y a des lis à trois feuilles.

Les panneaux du côté oriental sont à dimensions égales (chacun 3,50 x 1,70 m) et représentent les mêmes motifs, à part la scène d'eucharistie qui occupe une superficie quadrangulaire aux dimensions 1,50 m x 1,70 m à l'Est de ces panneaux. Au panneau du côté N-E sont conservés des fragments de mosaïque et des traces d'initiales.

Aux petits carreaux réalisés aux coins de chacun des panneaux orientaux, il y a des fleurs à quatre feuilles.

L'état de la mosaïque avant sa restauration. Après les fouilles archéologiques, le monument et particulièrement la mosaïque, se présentait assez endommagé. La dense végétation avait détruit la structure de la mosaïque. Les tesseles étaient détachées du lit de pose et une partie d'elles se trouvait loin des lignes du décor. Il fallait entamer une profonde intervention de restauration.

Les intérventions de restauration. Il fallait immédiatement procéder à une profonde intérvention de restauration. Il fallait déposer la mosaïque.

Après la dépose, on remarque que la couche du mortier d'une faible qualité se détachait facilement des tesseles. Ce fait aida à mettre bien en évidence la couche de nivellement du rudus qui servirait de preuve pendant la remise à sa place.

Les fragments détachés et bien nettoyés furent aménagés en panneau d'une épaisseur de 4 cm renforcés d'une armature métallique. Directement sur les tesseles on coula une couche de mortier bâtard.

On essaya d'utiliser dans ce mortier une partie du mortier original.

L'installation des fragments utilisés se réalisa sur une couche de mortier bâtard à une épaisseur de 2 cm.

La mosaïque du plancher de cette basilique montre que les maîtres de mosaïque ont bien connu les concepts compositionnels, la technique et les matériaux de l'époque.

Il est à remarquer dans cette mosaïque l'harmonie des couleurs et surtout le gôut dans le choix des tesseles rouges ou violettes. Les parties de la sculpture décorative architectonique de la basilique sont gravées avec maéstria. Elles nous rappellent les débuts des créations de l'architecture paléochretienne.

Les profondes intérventions de restauration visèrent à remédier à l'état endommagé et à mettre en évidence les valeurs de la mosaïque. L'utilisation du mortier bâtard dans la couche du nucleus rend possible une intervention future.

On pense que la mosaïque a été réalisée au cours de la deuxième moitié du IVe sc de notre ère. Le tremblement de terre en 522 causa un endommagement considérable à la mosaïque.

MOZAIKU I BAZILIKES Apres - ELBASAN

0 0.5 1m

DO NOT COPY

DO NOT COPY

monumentet

Gazmend MUKA

TË DHËNA TË REJA NGA RESTAURIMI I PIKTURËS NË KATEDRALEN «FJETJA E SHËN MËRISË» BERAT

Qyteti muze i Beratit përveç tri kishave bizantine[1] ruan edhe mjaft kisha të periudhave të mëvonshme. Ndërmjet tyre spikat katedralja e Shën Mërisë, ngritur në pjesën më të lartë të lagjes «Kala». Kjo faltore, rindërtuar në vitin 1797,[2] vlerësohet si nga madhësia ashtu edhe nga niveli i ndërtimit si monumenti më përfaqësues i arkitekturës pasbizantine për qytetin e Beratit.

Prej vitesh Katedralja «Fjetja e Shën Mërisë» është kthyer në muze dhe mban emrin «Onufri», njërit prej kryemjeshtrave të pikturës shqiptare të shek. XVI. Në mjediset ndihmëse njëkatëshe në anën veriore dhe dykatëshe në atë perëndimore janë ekspozuar vepra arti të gjinive dhe shekujve të ndryshëm. Naosi paraqet një bazilikë tri nefëshe të mbuluar me qemerë e kupola, nga të cilat vetëm njëra është mbuluar me pikturë murore. Në ikonostasin e gdhendur me mjeshtëri e të praruar me ar janë të ekspozuara ikonat e Johan Çetirit[3]. Kthina e altarit përbëhet nga bema me absidë rrethore në brendi dhe pesëfaqëshe në anën e jashtme, e gjitha e pikturuar në teknikën e afreskut, nga protezisi me disa nike e kamare dhe nga diakonikoni me një nike në murin lindor. Ndriçimin ajo e merr nga një dritare në murin jugor.

Qëllimi i këtij shkrimi është të japë restaurimin e pikturës murore në absidë dhe disa të dhëna historike mbi vlerësimin artistik dhe historik të saj.

Në qendër të pikturës murore kemi dritaren e absidës të mbyllur në anën e jashtme. Piktura murore, inkuadruar në nëntë ndarjet e stukorelievit shtrihet në 7 m gjatësi dhe 2,5 m lartësi. Skenat simetrike janë me gjerësi 0,8 m. Në to vërejmë 8 silueta të etërve të kishës. Figurat kanë aureola në teknikën e stukorelievit të incizuar, fakt që flet për një pikturë të vonshme, pasbizantine. Sfondi pas etërve ndahet në tri pjesë, nga fundi deri në gju me ngjyrë kafe të errët, nga gjuri deri tek bërryli në gri të ngrohtë në nuancë jeshile dhe nga bërryli e lart në blu të thellë. Poshtë figurave frizi i pikturuar me një ornament të lakuar floreal me dimensione 7 x 0,4 m ishte vende-vende i dukshëm. Piktura murore me figura është mbuluar nga verniku i dekompozuar në gjithë gjatësinë e saj (fig. 1, 2, 3). Veçanërisht, në shtresa të trasha paraqitej në krahun e djathtë, në pjesën e sipërme. Ajo paraqitej e nxirë edhe prej blozës, si pasojë e tymrave të temjanit gjatë shërbesave fetare. Në krahun e majtë, në mesin e figurave, kishte rënie të pelikulit të ngjyrës dhe verniku ishte në shtresë të hollë. Në gjendjen ekzistuese figurat nuk perceptoheshin.

Degradimi i vernikut dhe bloza paraqiteshin zona-zona, duke krijuar plane të ndryshme (Fig. 4).

Në ndarjen qendrore të pikturës, ku ndodhet dritarja e absidës, lart, kemi një grumbull të madh verniku të nxirë dhe poshtë një mbivënie gëlqereje

1) A. Baçe, A. Meksi, E. Riza, «Berati, historia dhe arkitektura» f. 50.

2) Po aty, f. 61.

3) Piktor i mesjetës shqiptare, shek. XVIII-XIX.

DO NOT COPY



Fig. 1



Fig. 2

dhe bojë vaji blu në gri. Frizi me motive floreale vjen pa vernik, por me prani të blozës. Në stukoreliev vërejmë lyerje me bojë vaji blu në gri (skica 1). Në ndarjen e figurës së tretë nga e katërta (nga e djathta në të majtë) dhe të figurës së pestë nga e gjashta (skica 1) mungojnë kokat e dy kapiteleve, ndërsa në pjesën më të sipërme të harkut, në skenën e dytë, të tretë, të pestë dhe të gjashtë mungojnë pjesë të ornamenteve plastike. Korniza që mbyll stukorelievin, i cili ndan pjesën e sipërme të pikturës së absidës nga e poshtmja, shfaqej me dëmtime të shumta mekanike. Në skenën qendrore kemi dëmtim të çrregullt të stukorelievit vertikal me kanelyra (fig. 5), 30 cm në të majtë dhe 50 cm në të djathtë. Poshtë saj, vumë re një trajtim jo të mirë konsolidues në llaç. Në pjesën e poshtme të figurës pesë kemi një trajtim të vjetër plombimi mbi pikturë, mjaft të ashpër e të lyer me bojë vaji blu në gri (fig. 6).

Nga sondazhet e kryera në pjesën e poshtme të pikturës, punuar në teknikën e afreskut, brenda njëkornizimi në stukoreliev, dalluam dy piktura murore të mbivëna, të cilat duken qartë në cepin e majtë të frizit me motive floreale (fig. 7), në një dëmtim mekanik në formë trekëndëshi te figura e dytë dhe në dy faqet e brendshme vertikale të dritares së absidës (fig. 8). U vu re se buzët e intonakos ku është realizuar piktura e mëvonshme kalojnë mbi stukoreliev.

Piktura murore e absidës, duke qenë e ekspozuar brenda Muzeut të Artit Mesjetar «Onufri» paraqiste probleme restaurimi, sepse si dëshmi e vetme e pikturës murore të naosit të Kishës «Fjetja e Shën Mërisë», ajo nuk mund të rrinte në muze në gjendjen fizike që paraqitej dhe e dyta, duhej hedhur dritë mbi historikun e saj, kohën e krijimit e vlerat artistike.

Përpara se të fillonim ndërhyrjen restauruese u siguruam për gjendjen e lagështisë së monumentit,

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4



Skëma 1

DO NOT COPY



Fig. 5



Fig. 6



Fig. 7

i cili nuk paraqiste rreziqe nga prania e lagështisë nga jashtë, si pasojë e një drenazhimi të mirë, kryer vite më parë në pjesën e jashtme të absidës. Lagështia e ajrit në interierin e katedrales, matur rregullisht 3 vjetët e fundit në termohidrometër, gjatë gjithë stinëve, paraqitej me mesatare, në dimër te shifrat 95% dhe në verë 80-90%. Amplituda e lëvizjes së saj në kohë paraqitej konstante, duke mos krijuar mundësinë e presioneve të variueshme në sipërfaqen e pikturës, të cilat do ndikonin në dëmtimin e saj të shumëformshëm. Lagështia e lartë, por konstante, në interierin e naosit të katedrales, është bashkudhëtare e objekteve të vendosura, duke u ruajtur atyre vazhdimisht një mjedis të njëtrajtshëm. Për të parë shtresëzimin dhe përmbajtjen elementare u kryen analizat e shtratit pikturor në të dyja pikturat murore të mbivëna.

Në bashkëpunim me kimisten e I.M.K. u kryen sondazhe për pastrimin e pikturës nga bloza dhe verniku i degraduar, në figurën e parë nga e majta. Pas disa provave u procedua me sukses pastrimi me ace-



Fig. 8



Skëma 2



Skëma 3

DO NOT COPY

ton dhe terpentinë. Teknikisht vumë re se piktura e vjetër, nën të, është realizuar mbi një shtrat pikturor të përbërë prej dy shtresash: 1) shtresës mbajtëse në smërç ngjyrë gri me trashësi 1,5 cm, 2) shtresës së dytë përbërë prej gëlqereje me kashtë, me trashësi 1,5 cm.

Piktura e re mbi të është e një shtrese (intonako) në smërç, gëlqere dhe li, me trashësi 7-8 mm. Nga analizat e kryera me mostrat e marra nga të dy shtresat e pikturave rezultoi:

1- Suvaja e pikturës më të vjetër, gjatë analizës elementare doli me përmbajtje të lartë kalciumi dhe pak stroncium, i cili shoqëron përmbajtjen e kalciumit (skica 2). Në vrojtimet me mikroskop në dritë të polarizuar, kjo mostër rezultoi me përmbajtje mbi 80% gëlqere (karbonat kalciumi) dhe në gramalometri nga 0,5 deri 0,7 mm dhe pak grimca të shkëputura silici. Gjithashtu vërehen fijet e kashtës së shpërndarë uniformisht.

2- Suvaja e pikturës së re rezultoi përsëri me përmbajtje galciumi dhe stronciumi, që shoqërojnë njëra-tjetrën. (Skica 3). Vrojtimi me mikroskop me dritë të polarizuar tregoi se kjo mostër është një përzierje gëlqereje dhe silici. Përmbajtja e silicit këtu është më e madhe se te mostra e parë, është një llaç më i ashpër, ku vërehen fibra liri.

Pas dokumentacionit grafik dhe fotografik fiIluar ndërhyrjen restauruese. Fillimisht ndërhymë për mënjanimin e mbivënieve në stukoreliev sepse gjatë pastrimit me bisturi krijoheshin pluhura, copra të vogla të bojës së vajit, të gëlqeres së çliruar, që dëmtonin pikturën.

Ndërhyrja restauruese konsistoi në mënjanimin në mënyrë mekanike të mbivënieve në stukoreliev dhe me tampona të mëdhenj pambuku në amoniak, të mbyllur në aceton në ornamentet plastike. Kështu në gjysmën e krahut të majtë u procedua me bisturi, ndërsa në pjesën e djathtë ornamentet u rrethuan me tampona të mëdhenj pambuku me amoniak të mbyllur në celefon. Pas 20 minutave u hoq dhe

DO NOT COPY



Fig. 9



Fig. 10



Fig. 11

u pastrua në mënyrë mekanike boja e vajit, tanimë e zbutur. Zbutja e saj shkurtoi në mënyrë të ndjeshme dhe lehtësoi pastrimin e bojës së vajit blu në gri nga ornamentet plastike në stukoreliev (fig. 9, 10).

Në kolonat vertikale të stukorelievit dhe në harqet bashkuese të tyre, pas sondazheve u vu re se, për të arritur në patinën e stukorelievit, duhet të hiqnim mekanikisht me bisturi dy shtresa boje, njëra blu në gri (e sipërmja) dhe tjetra, nën të, me varak të verdhë. Me kujdes u punua për çlirimin e gjithë stukorelievit mbuluar nga mbivëniet, për të ruajtur një ornament fillestar të tij në kanelyrën qendrore. Ai paraqitej në reliev të lehtë, një linjë vertikale anash me krahë të shumtë, simetrikë çifte-çifte, që ngrihen në gjithë lartësinë e kolonës vertikale. Ky ornament ndikon figurativisht në lehtësimin viziv të stukorelievit (skica 4).



Skëma 4

Në pjesën e sipërme të harqeve, në krahun e majtë gjatë heqjes së mbivënieve me bojë vaji dolën në pah disa motive floreale të punuara lirshëm në teknikën e afreskut. Meqë dhe këtu intonakoja paraqet buzë mbi stukorelievin i përket pikturës më të vonë. Tani estetikisht absida dukej mirë, në ngjyrën e patinës së stukorelievit. Megjithëse mungesat e tyre merrnin pjesë në historikun e monumentit, prania e tyre në muze na sugjeroi plotësimin e tyre. (fig. 9, 10).

Kokat e kapiteleve që mungonin, meqë ishin të njëjta, u plotësuan me kopje të nxjerra nga negativi i njërës prej ekzistueseve.

Plotësimi i zbukurimeve të vendosura mbi harqet u kryen duke u nisur nga fakti se ato ishin në simetri ndaj qendrës, sepse të njëjta ishin dy anësoret.



Fig. 12

Mungesat u plotësuan me negativë të marrë prej ekzistuesve. Për 2-shin morëm kopje nga 8, për 3-shin nga 7-t, ndërsa tek 6 vumë kopje nga respektivja e saj në krahun e djathtë. Tek e 5 dëmtimin në majë e lamë pa plotësuar, sepse gjurma e thelluar në kornizën e sipërme krijonte vizion të qartë të formës së saj. Gjithashtu, plotësuam mungesat e shumta në kornizën ndarëse të absidës. Ngjyra e allçisë distancohej nga ngjyra e stukorelievit origjinal. U çlirua nga mbivëniet e gëlqeres dhe të bojës së vajit piktura nën dritaren e absidës. Në të duken të piktuaara motive floreale dekorative. (Fig. 11). Në figurën e pestë pas heqjes me daltë të plombimit të vjetër, që paraqitej i ashpër, skrupuloz, gati 10 cm mbi pikturë e i ritokuar në bojë vaji (Fig. 12), doli buza e shtresës së vonë të pikturës e më pas një sipërfaqe prej 182 cm² e pikturës së vjetër. Në të vërehen vrimat e dy gozhdëve kovaçi. Prania e gozhdëve tregon se kjo pjesë është dëmtuar prej vendosjes në qendrën e absidës së ndonjë elementi mbajtës, që përdorej gjatë shërbesave fetare.

Nga vrojtimet rezultoi se në sipërfaqen e pikturës së vjetër nuk kemi çukitje për vendosjen e intonakos së pikturës së mëvonshme. Plombimi i ri, në shtratin e të vjetrit, u krye duke ruajtur të ekspozuar edhe fragmentin nga piktura e vjetër. Gjatë pastrimit me aceton dhe terpentinë të pikturës murore në figurën e parë, në krah të majtë, u vu re se bloza dhe verniku i degraduar hiqej me lehtësi. Në figurën e dytë sasia e vernikut ishte më e pakët, prandaj shtuam raportin e terpentinës. Dolën në pah siluetat e plota të figurave, veshja liturgjike, pergamena, dora e djathtë që predikon, aureolat, portretet dhe shkrimet. Pastrimi i pikturës nëpërmjet acetonit merr një aspekt të ndërmjetëm midis krijimit dhe gjendjes në të cilën piktura ka ardhur në kohën tonë. Ky aspekt e bën atë të ekspozueshme, megjithëse përmban akoma vernik (Fig. 9, 10, 13).

Për të arritur në aspektin fillestar të afreskut, natyrën e tij mat u procedua me dimetil dhe terpentinë. Gjatë përdorimit të dimetilit e kuqja pastrohej me lehësi, te e zeza aj vepronte, ndërsa tek e bardha nuk dha rezultat, ngaqë ajo ishte oksiduar. Pas pa-



Fig. 13

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Fig. 14



Fig. 15



Fig.

Fig. 17



strimit të të gjitha skenave dolën në pah 8 figurat e etërve të kishës, ndërsa në mes, mbi dritaren e mbyllur të absidës doli tavolina e altarit me një kupë të madhe vere në mes, nga del portreti i Krishtit me dy engjëj anash tij (fig. 14). Poshtë figurave, frizin e pikturuar, për largimin e papastërtive dhe të blozës, e pastruam me solucion amoniaku të holluar. Në cepin e djathtë, poshtë figurës së parë, doli një fragment 140 cm^2 nga piktura e vjetër, mbi të cilën me intonako të hollë është pikturuar afresku i ri. Në gjatësinë e frizit vihet re se midis dy pikturave ka shumë boshllëqe, xhepa, ku me goditje të lehta mekanike mund të hiqen pjesë të mëdha të pikturës së vonë (fig. 15). Menduam që të mos injektojmë kazeinë për konsolidimin e pikturës së sipërme, intonakoja e së cilës vendoset mbi sipërfaqen e pikturës së vjetër pa e çukitur atë, sepse në një të ardhme, me zhvendosjen e së sipërmes, mund të ekspozohen të dyja.

Nga sondazhet e kryera del se piktura e vjetër është e njëkohshme me stukorelievin dhe pas shtresës mbajtëse të saj vjen muri. Kjo u vu re në fragmentin me motive gjeometrike te dritarja dhe te frizi floreal në krahun e djathtë, ku del një perde, siluetuar në kafe me dritë, ndërsa tri linja vishnje të errëta, të vendosura horizontalisht ndjekin format e palëve. Afër tyre shihen dy lule me gjashtë petale. (fig. 7). Piktura e vjetër, mjaft e dëmtuar vazhdon dhe në pjesën e sipërme të absidës, ku vihet re skena e Shën Mërisë me Krishtin dhe poshtë saj, skena e kungimit të apostujve. Në fragmentin e pikturës së vjetër, në krahun e majtë të dritares së absidës (te figura e pestë, pas heqjes së plombimit të vjetër) dallojmë dy raporte ngjyrash, sipër jeshil dhe poshtë vishnje në ngjyrë kafe me pika të vogla rozë. Këto dy raporte përfaqësojnë një fragment nga sfondi që pikturohet prapa figurës me tri breza ngjyrash, e poshtmja kafe, nga gjuri deri në bërryl jeshile dhe në pjesën e sipërme blu e errët. Të njëjtin trajtim hasim dhe në pjesën



Fig. 18



Skema 5



Skema 6

DO NOT COPY

DO NOT COPY



Skema 7



Fig. 19

e sipërme të absidës, te kungimi i apostujve. Ky trajtim i sfondit ndryshon nga ai i pikturës së dytë, në pjesën e poshtme të absidës. Mënyra si është trajtuar toka në fragmentin e afreskut të vjetër (fig. 12) identifikohet me pikturimin e tokës në ikonat e mëdha të Joan Çetirit «Mbledhja e apostujve» dhe «Fjetja e Shën Mërisë» në ikonostasin e kësaj katedraleje (fig. 16). Nga krahasimi i një figure (e dyta në të djathtë) të skenës «Kungimi i apostujve» në absidë (fig. 17, 18), që paraqitej në gjendje relativisht më pak të dëmtuar me figurat e ikonës «Mbledhja e apostujve» evidentojmë disa të dhëna të afërta.



Skema 8

Gjatë pikturimit të portreteve çdo piktor mundohet, që me anë të disa elementeve të veçanta, të krijojë një tipologji të vetën. Kjo vërehet në portretet e ekspozuara, në gjysmëprofilin e majtë të ikonës së sipërpërmendur (skica 5) dhe në portretin e figurës së afreskut (skica 6), në zgjidhjen konvencionale të pikturimit të veshit (skica 7 b,c,), tek forma e kërcyer e hundës (skica 7a), sytë afër njëri-tjetrit, me qeskë pak të spostuar nga qendra (skica 7,d). Bebet e syve në të dy rastet paraqiten të mëdha. Zgjidhja e palave gjatë ndërtimit të figurës në afresk, grupimi i tyre për evidentimin sa më të mirë të lëvizjes së këmbës, është e ngjashme me zgjidhjet e kryera në ikonat e mëdha e të vogla të ikonostasit (skica 8). Po kështu, lidhja e sandaleve paraqitet e njëjtë (skica 9). Tendenca piktorike në punimin e portreteve përkufizohet në trajtimin e ngjyrës së mishit me nuancë gri, e cila krijon në hije tone, që mbyllen me anë të sienës. Kjo përbën një karakteristikë të paletës së piktorit. Kërkesa e tij në ngjyrë rrugëzohet në evidentimin sa më të qartë të veçorive të tij në ndërtimin e figurave të përcaktuara. Jan Çetiri është autori i tetë ikonave të vogla në ikonostasin e kësaj katedraleje. Katër nga ikonat e mëdha janë datuar prej tij «Shën Kolli me skena» dhe «Fjetja e Shën Mërisë» më 1814, ndërsa «Joan Theologu» dhe «Shën Spiridhomi» më 1812. Meqë piktura e vjetër është e njëkohshme me stukorelievin kornizues dhe ky i fundit përmban në kapitelin e kolonave të njëjtin ornament plastik në formë guaske (fig. 19), ashtu si ato të përdorura në kolonat e ikonostasit (si kapitel i tyre), mendojmë s

DO NOT COPY



Fig. 20



Fig. 21



autori i këtij afresku mund të jetë Joan Çetiri, i cili ka punuar ikonografinë (fig. 19, 20). Veprimtaria e tij si piktor ikonograf dhe freskograf shtrihet nga vitet 1792 deri më 1813. Nëqoftëse afresku i vjetër në pjesën e poshtme të absidës së katedrales është i Joan Çetirit, ai i përket fundit të krijimtarisë së tij.

Në studimin e pikturës së vonë në absidën e katedrales (pjesa e poshtme) vëmë re se figurat pikturohen lirshëm e me shpejtësi, me pala ekspresive, me penel të madh (fig. 12). Autori preferon ngjyrat ultramarinë dhe gri. Ai realizon një pikturë të unifikuar, jo me ngjyra të lokalizuara potente. Kaligrafia duket e shpejtë dhe me një tendencë diagonale nga e majta në të djathtë. Në gërmat e fundit ky fenomen vërehet më qartë. Tipi i portreteve është i njëjtë. Ato pikturohen në gjysmë profil, kanë ballë të madh, sy të mëdhenj e shprehja e tyre lëviz nga portreti në portret, për të krijuar tip tjetër me anë të ndryshimit të formës së mjekrës dhe ngjyrës së saj. Aureolat në stukoreliev siluetohen me linjë të bardhë dhe të zezë.

Frizi me motive floreale është pikturuar plot ekspresion. Një fjongo e kuqe përshkon me delikatesë qendrën e ornamentit. Piktura murore e këtij autori (anonim) është dëshmia e fundit e pikturës pasbizantine në Berat.

Të njëjtin piktor anonim mendojmë se hasim në pikturën e vetme të absidës (fig. 22) dhe niket në kishën e Vangjelizmosë në Kalanë e Beratit. Në gjysmën e poshtme të absidës janë pikturuar gjashtë figura, tri në çdo anë, të etërve të kishës (fig. 22). I njëjti portret dhe po ajo shpejtësi në ndërtimin e tyre vërehet te të gjitha figurat. Kjo veçori (dukuri) këtu paraqitet më e theksuar. Janë të njëjtat pigmente ngjyrash në harmoni ndërmjet tyre, e njëjta kaligrafi e shpejtë dhe me tendencën për t'u ngritur nga e majta në të djathtë. Aureola okër siluetohet me dy linja; të bardhë e të zezë. Mbrapa piktura ndahet në tri breza ngjyrash, veçse këtu ngjyra në brezin e mesit paraqitet më afër okrës se në Katedrale. Edhe këtu kjo pikturë murore është realizuar me një shtresë të hollë intonakoje, vendosur drejt mbi patinimin autentik të kishës.

Me daljen e pikturës murore të vonë, në pjesën e poshtme të absidës në Katedralen e Shën Mërisë dhe identifikimin e saj me pikturën e absidës në kishën e Vangjelizmosë, hedhim dritë mbi një piktor anonim, i cili ka punuar në këto dy kisha.

Gazmend MUKA

DO NOT COPY

NOUVELLES DONNÉES SUR LA RESTAURATION DE LA FRESQUE DANS LA CATHÉDRALE «LA DORMITION DE LA VIERGE MARIE» À BERAT

RÉSUMÉ

La cathédrale «La dormition de la Vierge Marie» construite en 1797 (aujourd'hui le musée «Onuphre») se situe au centre de la forteresse de la ville de Berat. Dans son abside se conserve un fragment complet de la fresque de cette cathédrale. Les endommagements partiels et les superpositions ne permettaient pas une distinction nette de l'image, ce qui dictait une intervention de restauration. Avant tout, il fallait jeter de la lumière sur l'historique et l'époque de sa création.

Les sondages effectués dans la partie inférieure de la fresque firent apparaître deux couches de peinture superposées, qu'on distingue néttement au coin gauche de la frise en motifs floraux, à un fragment endommagé de la deuxième figure ainsi qu'à la partie intérieure des montants verticaux de la fenêtre de l'abside. On remarqua que les bords de l'intonacco sur lequel se réalisa la deuxième peinture, passe sur le stuccorelief.

Avant d'entreprendre la restauration on analysa l'humidité qui venant de l'extérieur menaçait la sauvegarde du monument. L'humidité de l'air à l'intérieur de la cathédrale, pendant les trois dernières années présente une moyennede 95% en hiver et 80-90% en été. L'amplitude de ses changements dans le temps se présente constante évitant ainsi des pressions variées sur la surface de la peinture lesquelles causeraient de multiples altérations. L'humidité accentuée mais constante à l'intérieur du naos de la cathédrale accompagne toujours les objets qui s'y trouvent en leur assurant une ambiance uniforme. Afin d'étudier les différentes couches et leur contenu, on fit les analyses de la couche support des deux peintures murales superposées.

L'intervention de restauration consista à l'enlèvement de façon mécanique des couches au-dessus du stucco relief et au nettoyage des ornements plastiques au moyen de grands tampons en coton imprégnés d'ammoniaque.

L'enlèvement de l'ancien plombage retouché sur la peinture, au côté gauche de la fenêtre de l'abside, apporta des données intéressantes. Les observations minutieuses prouvèrent qu'à la surface de l'ancienne peinture il n'y a pas eu des picots pour l'aménagement de l'intonacco de la deuxième peinture. Le nouveau plombage à la couche-support de l'ancienne peinture se fit en gardant exposé le fragment de l'ancienne peinture.

Au cours du nettoyage avec acétone et térébenthine de la fresque du côté gauche, la suie et le vernis dégradé s'enlevaient facilement. Afin d'atteindre l'aspect initial de la fresque, sa nature mate, on utilisa le dimethyle formamide et lc térébenthine. Le diméthyle nettoyait bien le rouge, agissait sur le noir et ne donnait aucun résultat sur le blanc qui était oxydé. Le nettoyage mit en relief la silhouette des images, les habits, le parchemin, la main droite du prédicateur, les auréoles, les portraits et les inscriptions.

Les sondages effectués démontrèrent que l'ancienne fresque cantinue même dans la partie supérieure de l'abside. Elle représente la scène de la Vierge avec le Jesus et en dessous celle de la Communion des Apôtres. Le traitement pictural, dans tous ses éléments, présente des points communs avec la création de Joan Cetiri qui est représentée par les icônes de l'iconostase de cette cathédrale et la fresque de l'église «La dormition de la Vierge Marie» à Bishqethem de Lushnje. La typologie des figures de la fresque de l'abside de la cathédrale ressemble à celle de la création signée par Jean. Puisque l'ancienne peinture est contemporaine au stucco relief de la corniche et que celle-ci contient le même ornement plastique en forme de coquillage que celui des chapiteaux des collones, nous pensons que l'auteur de cette fresque est Joan Çetiri qui a peint également des icônes. Son activité comme peintre d'icônes et de fresques s'étend de 1792 en 1813 donc 21 année. Durant l'étude de la peinture plus récente dans l'abside de la cathédrale (la partie inférieure) on a remarqué que les figures sont peintes en hâte et plus librement. La typologie des portraits ressemble à une expression qui passe d'un portrait à l'autre pour créer un autre type par la modification de la forme de la barbe et de sa couleur. Cette peinture témoigne de la décadence de l'art à cette époque.

On retrouve le même peintre à la peinture unique de l'abside de l'église d'Evangélisme à la forteresse de Berat. Là également, la fresque est réalisée sur une mince couche d'intonacco appliquée directement sur l'enduit authentique de l'église.

Nr. 1 1990

monumente

DO NOT COPY

Koço MIHO

MBI DISA NDËRHYRJE NDËRTIMORE PUBLIKE NË VITET 1920-1938 DHE MBI VENDIN E ROLIN E TYRE NË EVOLUIMIN URBANISTIK TË QYTETIT TË TIRANËS

Urbanizimi i vendit tonë, si pjesë e pandarë e botës sonë materiale e shpirtërore, përfaqëson një dukuri të përhapur, më se njëzetepesëshekullore të lashtë. Si proces i kultivuar, ai ndeshet i pjesshëm në disa nga qendrat e antikitetit iliro – jugor. Gjatë mesjetës, karakterizuar nga periudha tkurrjeje e lulëzimi ai vazhdon si veprimtari praktike e mjeshtrit tradicional dhe, nga shekujt XVIII – IX (në formë të organizuar e të përparuar për kohën e vet), rishfaqet në shembujt e strukturave drejtkëndore të lagjeve të reja të qyteteve të Korçës e të Fierit[1].

Me kuptimin bashkëkohës të termit, procesi në fjalë zhvendoset në Tiranë, me disa ndërhyrje urbanistike – arkitektonike, që u kryen në vitet 1920-1938.

Ndërtimi e sistemimi i kryeqytetit tonë është cekur, në të kaluarën, nga autorë të ndryshëm, vendas e të huaj. Mbresat e tyre kanë ndihmuar dhe në portretizimin urbanistiko-arkitektonik të tij. Veç, të nisura nga botëkuptime apo interesa të caktuara, ato kanë dhe caqet e dobësitë e tyre. Në këtë drejtim, një vështrim realist, metodologjik e metodik mbi gjerësinë e këtyre ndërhyrjeve, mbi vendin e rolin e tyre në evoluimin e qytetit, do të ishte me interes, si për zgjerimin e shkallës së njohjes së përvojës pozitive ashtu dhe për sintezat historiografike përkatëse.

Këtij synimi rrahin t'i përmbahen e t'i përkushtohen dhe shënimet që vijojnë.

Mendimi ynë historik për fillimet urbanistike të Tiranës është i ndarë. Autorë të veçantë, mbështetur në ndërtesat më të vjetra të dokumentuara të qytetit e vendosin themelimin e tij në fillim të shekullit të XVII. Të tjerë, të nisur nga disa gjurmë godinash arkeologjike dhe nga legjendat popullore, e mendojnë më herët. Gjithsesi, analiza urbanogjene mundëson fiksimin e dy momenteve kryesore. E para, si kategori ekonomiko-shoqërore, Tirana është pjellë e nevojës së trevës së vet bujqësore, për një treg të afërt shkëmbimi dhe së dyti, si dukuri fiziko-materiale, bërthama historike lindi mbi një kryqëzim rrugësh të rëndësishme[2]. Me zanafillën spontane, strukturën feudo-mesjetare e dallimin ekonomiko-shoqëror, ajo u rrit ngadalë e pa ndonjë kriter të theksuar urbanistik.

Zhvillimin relativ më të madh, si mjaft qendra të tjera shqiptare bashkëkohëse, e arriti në shekullin XVIII, kur në qendër u rrit e u pajis me ndërtesa tregtie e zejtarie të kultit (si Xhamia e Ethem Beut e vitit 1794-1821) e shoqërore (Kulla e Sahatit e vitit 1821), me disa saraje e sidomos me banesa të shpërndara, rrethuar nga kopshte të mëdha. Megjithë arritjet, Tirana nuk mundi të ngrihej tej nivelit të një qyteti modest, ku tradita vendase dhe ndikimi i huaj

1) E. Baglioti, Albania, Milano 1940 f. 190: Fieri u themelua nga O. Vrioni më 1877, në një çiflig të tij, mbi bazën e një projekti të hartuar nga arkitekti frëng Barthelemy.

2) Është fjala për rrugë – karvanet Shkodër-Kërrab-Ohër dhe Kavajë, Durrës-Dajt-Dibër.

ngurtësoheshin në një urbanistikë e arkitekturë mesdhetare-orientale. Ky do të ishte, përmbledhtazi, identiteti urbanistiko-arkitektonik, me të cilin Tirana më 11 shkurt 1920 u ballafaqua me historinë si kryeqytet i Shqipërisë së Pavarur. Si produkt i një etape të kapërcyer, nga pikëpamja e strukturës urbanistike dhe e fondit ndërtimor të trashëguar, ajo nuk ishte e përgatitur për funksionin e ri. Prandaj i duheshin më parë e më shumë se çdo qyteti tjetër, ndërtime e sistemime, si rrjedhojë, studime, projekte për harmonizimin e tyre dhe një plan rregullues.

Kjo detyrë, siç kishte provuar përvoja e vendeve të tjera të Ballkanit, të dala para nesh nga e njëjta zgjedhë, nuk mund të zgjidhej tërësisht, njëherësh e vetëm me mjetet e forcat e brendshme[3]. Në rrethana të tilla, përmbushja ek ërkesave të domosdoshme, që diktonte gjendja e përcjellë e zhvillimit të qytetit, nisi e shkallëzuar, me projekte e masa të thjeshta, herë të hartuara nga teknikët e paktë vendas e herë nga të tjerë të huaj. Në drejtim të ndërtimeve publike, ato prekën rrjetin rrugor urban dhe sistemimin e qytetit.

Njoftimet bashkëkohëse përmendin dhe një «plan rregullues», të vitit 1923, nga një inxhinier vendas[4], plan i cili u paraqit, por nuk u miratua[5]. Ky projekt, tani për tani, mbetet ende një objekt me konture pak të qarta, sepse gjurmët e tij mungojnë. Por ekzistojnë fragmente planimetrish[6], mbi të cilat janë treguar çeljet e dy rrugëve të ardhme kryesore të Tiranës: të rrugës së Durrësit (sot «Kongresi i Përmetit») dhe Bulevardit të Madh.

Me masa të tilla, të pjesshme, të përkohshme e mbi të gjitha të pamjaftueshme, nuk mund të shkohej më tej. Ndaj nga fillimi i gjysmës së dytë të viteve 20 u sigurua jashtë vendit një pjesë e burimeve të financimit, konceptimit e realizimit të ndërhyrjeve urbanistike, për një farë ndërtimi e sistemimi të qytetit të Tiranës.[7]

Ideja e caktimit dhe e ndërtimit të kryeqytetit kishte kohë që ushqente mendimin shoqëror vendas. Kushtet e krijuara i dhanë shkas sensibilizimit të mëtejshëm. Por, pas faktorëve emotivë, qëndronin të tjerë, më thelbësorë, filtruar përfundimisht nga realiteti objektiv, por sidomos nga kushtëzimi që impononte huaja e jashtme, projekt-detyra e studimit urbanistik të qytetit u kufizua, kryesisht, me sistemin urban.

Në bazë të programit të mësipërm, nga viti 1927 deri më 1929-30, u paraqitën dy studime. I pari, iu besua arkitektit Armando Brazini[8]. Me të na njohin vetëm njoftimet e shtypit[9] dhe botime[10] që i bënë jehonë zgjidhjes urbanistike të tij. Prej tyre mund të kuptohet se ai rroku zonën qendrore të qytetit, veçmas Bulevardin e Madh (sot sheshi «Skënderbej») dhe një pjesë të Bulevardit të Tiranës së Re. Krijimi i vëllimeve e hapësirave të mëdha, në forma skenografike rilindase, meqë kërkonte prishje e shpenzime të mëdha, jashtë kohës e mundësive reale të vendit, nuk u miratua. Kështu, nga viti 1929, u ndërmor një studim i ri, i hartuar nga arkitekti Floreano de Fausto[11]. Ky studim, i cili u miratua, nisi nga zbatimi më 1931[12]. Ai la pas vetes pak gjurmë projektesh, por diçka më tepër në terren. Ai dallonte prej të

3) Plani rregullues i Athinës dhe mjaft nga ndërtesat kryesore të saj prej vitit 1834 deri më 1914 u hartuan nga arkitektë gjermanë, suedezë, danezë, etj (A. Whihick. EUROPIAN ARCHITECTURE OF THE TVENTIETH CENTURY LONDON Përkthim rusisht, U 1960. ff. 25-26). Planet rreg të Sofies, në vitet 1879, 1880 dhe 1913 si dhe mjaft nga objektet kryesore të saj, u hartuan nga arkitektë austro – hungaresë, rusë, italianë, polakë etj (KRATKAJA ISTORIA BOLLBASKOJ ARHITEKTURI, SOFIA 1969, ff. 415, 454, 456, 532 dhe 537).

4) Fletorja Zyrtare, 31.7.1923 shih dhe Tirana 1607 – L 937, Tiranë 1937 fq. 28.

5) Indipendenca Shqipëtare, 25.6.1925.

6) Arkivi teknik i Ministrisë së Ndërtimit Tiranë.

7) Në vitin 1926, qeveria feudoborgjeze e Zogut, kontraktoi një hua me një grup financiar italian, në dukje për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe në realitet të konsumuar kryesisht për ndërtime rrugësh urash e objektesh ushtarake, objekte të cilat përkonin me interesat ekspansioniste të imperializmit italian.

8) Telegrafi, 32.8.1927 dhe G.E.I. Treccani, 1937, zëri Brasini.

9) Besa, 2.10.1931.

10) Relazione della SVEA, Roma 1926.

11) Si ky arkitekt dhe i pari, ishin sprovuar në ndërtimet e ish kolonive italiane të Afrikës (shih G.E.I. Zëri Tripoli)

12) Besa, 2.8.1931.

DO NOT COPY

parit, kryesisht, nga përmasat e zgjidhjet modeste, të cilat kufizoheshin me studimin urbanistik e projektet arkitektonike të sheshit «Skënderbej»[13], zgjidhur në plan në një lloj barroku e në hapësirë në një stil neoklasik të kapërcyellit të shekullit XIX. Një studim, diçka më i plotë[14], autorësia e të cilit është e diskutueshme[15], u hartua për zonën e banueshme që me këtë rast mori emrin Tirana e Re, e cila u zgjidh me një strukturë drejtkëndore, me ngastra karakteristike, destinuar për shtresat e larta. Interes paraqet dhe zgjidhja harkore e sheshit «Avni Rustemi». Me studime të veçanta u hartuan dhe disa projekte kanalizimi, gjelbërimi, ndriçimi rrugor, etj.

Të dhëna jo të drejtpërdrejta bëjnë fjalë dhe për një studim urbanistik në vitin 1935, për zonën midis rrugës së Shkodrës (sot Mine Peza) dhe Bulevardit të Madh[16].

Prirë nga studime urbanistike, gjatë viteve 1922-1923, u çel rruga e Durrësit[17], 1000 metra e gjatë dhe 20 metra e gjerë, u zgjerua e u sistemua rruga «28 nëntori», 250 m e gjatë dhe 15 + 5 m e gjerë, u grumbulluan në një vend të vetëm, diku në periferinë veriore, varrezat e shpërndara, të cilat më pas u vendosën në zonën lindore (të Bamit), u ndërtua një lulishte e vogël dhe godina e parlamentit më 1924 (sot Teatri i kukullave). Në vitet 1927 – 1934 u çel rruga që sot mban emrin e Barrikadave, 725 m e gjatë e 15 e gjerë, Bulevardi i Madh dhe pjesërisht ai i Tiranës së Re. Zgjerime e sistemime të pjesshme pësuan dhe rruga e «Bamit» (sot Q. Stafa), Hoxha Tasiini, e Pishës, e Tafajve (sot «4 Dëshmorët»), e Fortuzit (sot «A. Vokshi») Kamavon (sot «Dëshmorët e Rilindjes») etj. U zgjeruan e u sistemuan me ecurinë e tyre origjinale, arteriet gjenetike të planit të qytetit. Rruga e Kavajës (sot «Konferenca e Pezës»), e Dibrës, (sot «B. Curri») e Elbasanit (sot «Konferenca e Labinotit»), etj. Një pjesë e këtyre rrugëve, në vite të ndryshme u shtru-



Fig. 1



Fig. 2

DO NOT COPY



Fig. 3



Fig. 4

an me trotuare, me pllaka, u pajisë me ndriçim elektrik, gjelberim, kanal zim etj. Në vitet 1930-1931 u ndertu sheshi që sot quhet «Skenderbej». Pë formulimin e tij u vendosën 7 godin administrative dy-trekatëshe, të cil mbylleshin në një hapësirë rreth 1, ha. Pjesa veriore ishte caktuar pë transportin tranzit dhe ajo jugor për gjelbërim. Në pika të ndrysnm u naertuan disa komplekse kazer mash, spitali ushtarak, shtëpia e of cerëve, dy ura mbi përroin e Lane e bashkë me to u krye një farë siste mimi i tij, etj.

Ç'përfaqësuan këto ndërhyrje?

Fikesëpari duhet thënë se megj thëse Pavarësia u fitua që më 191 shenjat potenciale për evoluimin relc tiv të qytetit u krijuan vetëm në vite 1920 – 1938. Edhe kjo etapë nisi e mbyll në kushte objektive e subjektiv tepër të vështira[18]. Nën ndikimin tyre, ndonëse nevojat ishin të mëdhc realizimet qenë modeste, të kryera j në sferën prodhuese, pra dhe pa forc shtytëse. Vetë plani rregullues u re duktua më tepër në një skenë drej tuese rrugore[19]. Edhe në këtë gjendje me lënien e rrezeve pa lidhje unazore ai e përqëndronte trafikun në qendë Disa rrugë u çelën me drejtime t diskutueshme, të tjera, u lanë me ecu rinë e lakuar, të papërligjur me terre nin e rrafshët. Kompozimi gjatësor veri – jug i sheshit «Skënderbej» 90 gradë kundrejt hyrjeve kryesore t qytetit, e shndërronte atë në një ha pësirë të nënshtruar ndaj një hapë sire e një objekti tjetër[20], në ven që të shfrytëzonte epërsitë e terreni në ngjitje, aksialitetin e rrugë-hyrjev dhe stondin e malit të Dajtit, shtrir dhe në truaj të lirë. Territori i qytet përdorej në mënyrë irracionale[21]. Zo nat më të shëndosha u liheshin objek teve komunale etj, ndërsa banesav të reja ato depresive. Për mungesë t një mendimi arkitektonik të kristali zuar vendas u la fushë e lirë eklek tizmit. Po t'u shtohet këtyre dobësiv dhe ndërtimi vetëm në zonën qendror dhe në mënyrë perimetrike, duke kri

DO NOT COPY



Fig. 5

juar një lloj fasade dekorative apo dhe shkeljet e ndryshme e të shumta ndërtimore del mjaft qartë tabloja e vështirë urbanistike e qytetit, e cila shkaktoi reagimin e drejtë të opinionit shoqëror[22] dhe atij teknik.[23]

Por, megjithë dobësitë e mungesat e mësipërme, krahasuar me pikënisjen e me qytetet e tjera bashkëkohëse vendase, ndërhyrjet ndërtimore publike të viteve 20 – 30 lanë dhe gjurmë pozitive.

Tirana nuk kishte rrugë automjetesh e asnjë shesh qendror arkitektonikisht të organizuar. Asaj i mungonin ndërtesat e superstrukturës, zoningu urbanistik, etj. Të ndërtuar në këtë kohë, këta përbërës të rëndësishëm plotësuan disa nga nevojat fillestare, utilitare e funksionale dhe i dhanë qytetit frymëmarrje më të madhe, ndërlidhje më të lehtë e qarkullim të disiplinuar automobilistik. Në të njëjtën kohë, duhet theksuar se ato qenë për kohën e vet operacione të thella urbanistike dhe bartëse vlerash funksionale e estetike-kulturore, të cilat ndikuan në shndërrimin e Tiranës në qendrën më të madhe ekonomike, politike e administrative bashkëkohëse të vendit.

Mjaft nga ndërtimet e kësaj kohe nuk ekzistojnë më, të tjera, të kapërcyera e të amortizuara, presin të zëvendësohen. Por një pjesë syresh, në raporte të drejta bashkëkohore me strukturën urbanistike dhe fytyrën arkitektonike të qytetit, duke i qëndruar fizikisht e moralisht kohës e zhvillimit, janë integruar në mënyrë krijuese në realitetin e ri të tij.

Si përfundim, mund të themi, se ndërhyrjet publike të viteve 20-30 të vlerësuara në mënyrë kritike e në kontekstin e gjithë ndërhyrjeve të tjera çuan më tej arritjet e përcjella të qytetit.

13) Tirana, vep.cit, f. 39.

14) Piano regolatore di Tirana, Relazione, Tirana 1943, fq. 1 (Arkivi teknik i Min-Ndërtimit).

15) Gazeta e Re, 8.4.1929.

16) Piano reg. vep. e cit, f. 1.

17) Tirana, vep. e cit. f. 28.

18) Si rrjedhim i politikës antikombëtare të dyerve të hapura të regjimit feudoborgjez të Zogut, kapitali i huaj kapte gati 1/4 e gjithë sipërfaqes së vendi (Historia e Shqipërisë, 1965, V. 2, f. 567).

19) Piano reg. vep. cit, fq. 1.

20) Sipas studimit të parë urbanistik të Tiranës, në përfundim të bulevardit të Tiranës së Re, parashikohej të ndërtohej një objekt i rëndësishëm administrativ dhe para tij një shesh.

21) Në vitin 1937, Tirana numëronte rreth 35 mijë banorë e një sipërfaqe prej afro 500 hektarëshe, që i përgjigjej një dendësi e vogël 70 banorë për hektar.

22) Është fjala për kërkesat për një ujësjellës, kanalizim, asfaltimin e disa rrugëve, për një lulishte, transportin urban, etj.

23) Q. Butka, **Fshati, qyteti, kryeqyteti,** Përpjekja Shqipëtare, 1938 Nr. 16, f. 171-176.

DO NOT COPY

Koço MIHO

QUELQUES INTERVENTIONS CONSTRUCTIVES PUBLIQUES AU COURS DES ANNÉES 1920-1938, LEUR PLACE ET LEUR RÔLE DANS L'ÉVOLUTION URBANISTIQUE DE LA VILLE DE TIRANA

DO NOT COPY

RÉSUMÉ

En comparaison avec les autres centres du pays Tirana est une ville relativement nouvelle. Sur ses débuts urbains, la discussion demeure toujours ouverte. Quelques auteurs, appuyés sur les anciennes habitations documentées, placent sa fondation au début du XVII sc. D'autres, se basant sur les traces archéologiques des habitations et sur la légende populaire, projettent plus tôt cet acte. Tout de même, une analyse de son urbanisme permet la définition de deux moments principaux.

En tant que catégorie économique sociale, Tirana fut le produit du besoin d'un marché d'échanges agricoles.

En tant que phénomène physique-matériel le noyau historique naquit sur un carrefour important et son origine spontanée et sa structure féodale médiévale évoluèrent lentement.

Tirana connut un certain développement au XVIII sc. avec la construction de quelques bâtiments de commerce et d'artisanat, d'habitations et de mosquées, dont celle d'Ethem Bey (1794-1821) et la tour d'horloge tout près, demeurèrent pendant longtemps des symboles urbanistiques et aujourd'hui sont traitées de monuments culturels de la ville.

Malgré ses réussites, Tirana ne put pas dépasser le niveau d'un habitat provincial modeste où la tradition de construction autochtone et l'influence orientale se mêlaient à une architecture méditerranéenne centrale.

Ce serait en synthèse l'identité par lequel le 11 février 1920, la ville fut confrontée à l'histoire, en tant que capitale de l'Albanie indépendante.

Sans s'arrêter à la conception politico-géographique de cet acte, la nouvelle fonction dicta le besoin de quelques changements structurels, fonctionels et formels qui pour des raisons objectives et subjectives liées à l'état arriéré et les rapports politico-économiques intérieurs et extérieurs créés, furent conçues et appliquées simplement et graduellement. Depuis les années 1920-1925 elles portèrent essentiellement sur l'aménagement de la ville. La construction de la rue de Durrës, l'élargissement de celle nommée «28 Novembre», le regroupement des cimetières et du marché des paysans. l'aménagement d'un jardin etc. se réalisèrent par les forces économiques et techniques intellectuelles de la ville. Plus tard les interventions publiques s'effectuerent par des spécialistes étrangers. L'architecte A. Brasini fut chargé de la première étude urbanistique de la ville. Conçue en grands espaces et volumes de la scénographie de la Renaissance, contrairement aux possibilités réelles du pays, elle fut renoncée. Par conséquent, fut approuvée et appliquée l'étude de l'architecte F. di Fausto qui différait de la première par les dimensions modestes et les formes stylisées. Son application commença en 1929 et porta sur les principales rues, la place centrale et quelques parties de la ville.

Qu'est-ce que ces interventions représentaient? Avant tout, on peut dire que face aux exigences de la ville, elles furent modestes et sans force impulsive. L'étude urbanistique même, en conservant la structure rayonale sans une liaison avec les ceintures respectives, constituait en essence un schéma directeur d'où furent prises les données pour la construction et l'aménagement des rues dont quelques-unes prirent des directions discutables, alors que les artères génératrices furent abandonnées à leur évolution originale. La place «Skënderbeg» d'une planimétrie baroque et néoclassique en espace, de la fin du XIX sc. et du début du XX sc. à une étendue longitudinale de 90 par rapport aux principales rues d'entrée, sans utiliser leur direction axiale, l'avantage du terrain ascendant et le fond suggestif de la montagne de Dajti, devient un espace d'importance secondaire.

Malgre cela, face à l'état hérité pour le temps disponible, les interventions urbanistiques de l'étape située entre les années 20-30 (surtout les rues, la place centrale etc) furent des opérations importantes. Elles donnèrent à la ville plus d'espace, des liens organiques et une possibilité de transport automobile. De pair à quelques autres constructions privées elles satisfirent aux quelques besoins vitaux immédiats, enrichirent le répertoire typologique des objets sociaux, donnèrent à la ville des qualités esthétiques contemporaines, en synthèse firent de Tirana un grand centre politique, économique et culturel contemporain du pays.

Nombre de ces constructions ont disparu. Quelques-unes, résistant au temps, à l'évolution tels: le boulevard «Tirana e Re», une partie de la place «Skënderbeg» etc, sont intégrés de façon créatrice dans la nouvelle realité urbanistique et architectonique de la capitale.

Nr. 1 1990

monumenet

DO NOT COPY

Moikom ZEQO

SHYQRI NIMANI «ONUFRI DHE PIKTORË TË TJERË MESJETARË SHQIPTARË», «RILINDJA», PRISHTINË 1987*

Grafisti dhe personaliteti i njohur i kulturës shqiptare në Kosovë, Shyqri Nimani, ka botuar në Prishtinë më 1987 një libër-album me 127 faqe (22,5 x 29 cm) të titulluar «Onufri dhe piktorë të tjerë mesjetarë shqiptarë». Libri është një ndihmesë e veçantë për popullarizimin e zbërthimin e disa vlerave kryesore artistike të krijimtarisë madhore të Onufrit, piktorit të madh të shekullit të XVI, si dhe të veprave të piktorëve të tjerë të koleksionit të rëndësishëm e shekullor të arteve figurative të mesjetës në Shqipëri, që kanë rrezatuar edhe në vise të ndryshme të Ballkanit e në Italinë e Jugut.

Teksti synon të japë një tablo të shumanshme kulturore, parë në vështrimin historik të vetë vlerave të kombit shqiptar, sepse për të kuptuar thelbin e mesazhet e veprave artistike ato duhen vendosur saktë në kordinatat e hapësirës dhe kohës, në lidhje të ngushtë, të sinkronizuar me historinë e kombit në përgjithësi, apo dhe të arealit në kombëtar.

Në parathënie autori bën një skicë lakonike, të frymëzuar të historisë, nga ilirët te shqiptarët e sotëm, duke vënë edhe vepra të shumë piktorëve të huaj, të cilët kanë trajtuar tema shqiptare si: Cockerell, Woodville, Bananone, Dutertres, Lear, Avelot, Fritel, Valerio, Kirchner, Brown, Paja Jovanoviqi, Delakrua, Kore, etj.

Mbas parathënies hapet sythi «Perifrazime onufriane» (f. 22-50), në të cilin çdo gërmë e emrit «ONUFRI» është përdorur si gërmë nismëtare e një meditimi për jetën e veprën e piktorit (kemi kështu një lloj anagrame) Sh. Nimani në mënyrë origjinale, me depërtime të zgjuara, në mënyrë të hijshme analizon, sintetizon, perifrazon tërë kuptimet e metaforikën pikturike të artistit shqiptar. Grafikisht, këto meditime janë organizuar në formën e vargjeve, por pa ritmin e detyruar poetik, apo dukurinë e rimës. Autori, duke ngritur lart artin e Onufrit thekson se «Onufri synonte në kompozicion një të kuqe eruptive, një të kuqe që s'ishte as cenobrium e as murtasangi, as krimezi bizantin e as e kuqe dheu nga Sinopa e Azisë së Vogël, pra me të drejtë ajo është quajtur e kuqja onufriane».

Në sythin «Piktorët mesjetarë shqiptarë», që përbën edhe pjesën kryesore e shkencore të tekstit (f. 51 – 74) Sh. Nimani, duke filluar nga origjina e lindja e artit bizantin, nga shekujt V e VI të antikitetit të vonë, flet për ato kushte historike që çuan në sintezën e kulturës helenike me religjonin e krishterë, për barazimin e krishterimit me shtetin, i cili do të reflektonte dhe në barazimin e artit me konceptin estetik bizantin. Në këtë fushëpamje, Nimani, ravijëzon edhe skicën e pikturës mesjetare shqiptare të dy periudhave të mëdha, bizantine dhe pasbizantine. Në këtë trashëgimi të pasur, duke mbështetur tezat e studiuesve tanë e të huaj të kësaj tematike, studimi vë në dukje se afreskat e trapezerisë së Kishës së Shën Mërisë së Apolonisë në shekullin e XVI, pikturat e Onufrit në shekullin e XVI dhe ato të David Selenicës në shekullin e XVIII «përbëjnë një trinom të madh të traditave të arteve figurative në Shqipëri».

*) Botim i «Galerisë së arteve», biblioteka «Ars», Recensues dr. Ibrahim Rugova e Rexhep Goçi, redaktor Nazmi Rahmani, përkujdesja artistike nga Shyqri Nimani.

Mbasi jep të dhënat e pakëta për jetën e Onufrit, autori flet për veprat e tij që dokumentohen në Berat, në Kostur, si dhe në Shelcan e në Valësh të Elbasanit[1]. Në analizën e krijimtarisë së Onufrit, autori nuk ka asnjë mëdyshje se nuk niset thjesht nga zbërthimi ikonografik, leximi i skenave ungjillore, si dhe nga klishetë tematike të njohura. Ndihmesa e Sh. Nimanit në këtë libër – album është se duke qenë edhe vetë artist, njohës i mirë i artit pikturik jep për vepra të veçanta të Onufrit mendime estetike me interes të cilat pasurojnë të dhënat për figurën e piktorit. Sh. Nimani thekson se është pikërisht forca artistike e pazakontë që «e ngre Onufrin në piedestalin e më të merituarve në të tërë gjerësinë e artit bizantin... vetëm me ata të kalibrit të Theofan Grekut e të Andrea Rublovit» se «Onufri ishte piktor i rrallë, të cilit i shkonte përdore që vizionet e veta t'i realizonte me sukses të njëjtë, si në teknikën e pikturës murore, ashtu dhe në atë të tablove ikonografike».

Sh. Nimani ndalet te portretet e Roman Melodit nga Kisha e Shën Kollit në Shelcan, në atë të Stefanit e të Lavrentit në Kishën e Shën e Premtes në Valësh, por vlerëson se «një kthesë drejt një arti me notë më realiste bëjnë portreti i profetit David dhe figura e bariut» (f. 58). Për portretin e profetit David, Nimani, shënon «se është një kryevepër portreteske e Onufrit... në gjysmë anfas me shikim të rrëmbyeshëm. Proporcionet e tipareve të fytyrës janë të një vizatimi të përsosur» (f. 59).

Në një vështrim më përgjithësues, Nimani, vlerëson lart sidomos fuqinë krijuese të Onufrit në konceptimin e realizimin e kompozimeve shumëfigurëshe «Onufri, shkruan autori, është mjeshtër i vërtetë i skenave monumentale qoftë kur kompozicionin e krijon me parim simetrik (ikona «Hyrja e Marisë në tempull»). Këto skena i stolis ndjenja e zhvilluar për fantazi të pakufizuar narrative me repertor elementesh alegorike, me një afinitet të posaçëm për shtjellim fantastik (ikona «Pagëzimi i Krishtit»). Kompozimet e Onufrit janë gjithnjë të frymëzuara, të papërsëritshme, madje edhe kur e njëjta temë shtjellohet dy herë (ikona Shën Kostandini dhe Shën Elena», që gjendet në Shqipëri dhe piktura murore me të njëjtin titull në kishën e Agioi Apostoloi në Kostur të Greqisë).

Duke u ndalur në harmoninë koloristike të Onufrit, Nimani, vë re se e zeza, e blerta, e arta dhe e kuqja përdoren nga paleta magjike onufriane me një mjeshtri të madhe e në funksion të emocioneve që duhet të ndikojë tema e pikturuar. Me anë të penelit mjeshtëror ai nënvizon jo vetëm aspekte të peizazhit shkëmbor amëtar, elemente të garderobës etnografike popullore shqiptare, por edhe vizione të arkitekturës vendase, kryesisht të banesës popullore beratase. Në ndonjë ikonë Onufri është aq i guximshëm në harmonizimin e ngjyrave sa që në kompozicionin e ikonës «Lindja e Krishtit» aplikon një zgjidhje interesante e të paparë koloristike: vendos në raport harmonik detajin me figura monokrome (të blerta) kundrejt polikromisë së përgjithshme, që si aksent ideor e koloristik zë vend të posaçëm në kompozicion.

Nimani pranon faktin e dhënë nga studiuesit se Berati është një lloj metropoli i arteve figurative shqiptare të mesjetës, si dhe të krijimit të shkollës së pikturës onufriane ose të quajtur edhe shkolla beratase. Në këtë shkollë mbas emrit të Onufrit ngrihet edhe ai i të birit të tij, Nikollës, por pa arritur lartësitë e të parit.

Për artin e Nikollës, Nimani, shënon se «shëmbëllesat e tij të vendosura në amfas, të zëna në një çast të caktuar, kanë një statikë natyrore që u jep figurave pamjen e një gjendjeje të thuash ëndërruese me një shikim të domosdoshëm sugjestionues kah e maja e skenës.

Një nga emrat e tjerë të shkollës beratase qe edhe Onufër Qiprioti, por me të drejtë Nimani shënon se «Qiprioti nuk i shkon për dore të arrijë një dramaticitet figurativ mjeshtëror të Onufrit, po as edhe lirizmin poetik me një ëndërrim të papërsëritshëm të Nikollës».

Sh. Nimani ndalet pastaj në analizën e shpejtë e lakonike të veprës krijuese të David Selenicës, të cilin e quan një «fenomen» në horizontin kulturor shqiptar të shekullit të XVIII. Sipas Nimanit, David Selenica aplikon zgjidhje të reja në kompozicion, në lëvizjen e figurave, në saktësinë anatomike, ndërsa figurën e farëmbjellësit e pikturon me një koncept modern, duke depërtuar edhe në psikologji, kurse portretin e ktitorit voskopojar, Haxhi Jorgji, në afreskun e Kishës së Shën Kollit në Voskopojë, «më shumë se çdo figurë tjetër na e jep me një realizim artistik që nuk lidhet me kurrëfarë kushtëzimesh kanonike afreskologjike, por si një pikturë të realizuar kryekëput sipas parimeve të Renesancës (f. 65).

Vëmendjen e Nimanit e tërheq dhe veprimtaria e

1) Kohët e fundit është zbuluar se Onufri ka pikturuar dhe në Manastirin e Slepçës në Maqedoni, Shih. Dh. Dhamo **Onufri figurë e shquar e artit mesjetar shqiptar** Studime historike, Tiranë 1980, 2, f. 151-177.

DOKTORATURA

ikonografit Kostandin Shpataraku, piktor i specializuar për pikturimin e ikonave në miniaturë dhe në këtë znanër i takon «primati i mjeshtrit më të mirë në tërë pikturën shqiptare» (fq. 66).

Pastaj shtjellimi i tekstit lëviz me të dhënat për krijimtarinë e vëllezërve piktorë Zografi të shkollës korçare të pikturës pasbizantine.

Një tjetër familje e shquar piktorësh shqiptarë në shekullin e XVIII-XIX janë dhe piktorët Grabovari (Çetiri). Të dhëna me interes ka nxjerrë Nimani nga studimi i Miogad Jovanoviqit, i cili ka zbuluar se piktori shqiptar Joan Çetir Grabovari ka punuar shumë ikona në Sllloveni e Hungari, në ikonostaset e manastirit të Lepavinës në Orahovicë (1775) në atë të Stonit në Beograd (1776), në Gudovc (1780), në Sllatinë (1785), në Shiklush (1733) e në Mikloc (1773).

Sythi i fundit i librit – album titullohet «Pelegrinazhi në Agion Oros» (f. 119 – 126). Në të autori paraqet përshtypjet vetjake, si artist e historian arti, për pikturat që ka parë në kishën e Shën Athanasit të Muzakajve në Kostur të Greqisë (ndërtuar nga princërit shqiptarë Stoia e Teodor Muzaka në vitet 1384-1385), si dhe për ato në kishën e Shën Apostujve, po në Kostur, ku gjendet edhe një pjesë e rëndësishme e opusit pikturik të Onufrit, i cili në mbishkrimin e tij, që mban vitin 1457, shënon se ka ardhur «nga qyteti i shumëshkëlqyer Berat».

Udhëtimi i Sh. Nimanit në Athos (Agios Oros) është pasqyruar në formë reportazhi artistik e historik, duke u ndalur veçanërisht në përshkrimin e varrit të Reposhit, vëllait të Gjergj Kastriot Skënderbeut, i cili vdiq e u varros në manastirin e Hilindarit në 1430/31. Nimani na jep edhe një fotografi të mbishkrimit të varrit dhe një përshkrim të afreskeve që dekorojnë akrosoliumin e Reposhit.

«Onufri dhe piktorë të tjerë mesjetarë shqiptarë» është një vepër me vlera të veçanta paraqitëse për disa aspekte të thesarit të arteve figurative të kombit tonë, të popullarizimit të emrave të artistëve të shquar në një hark kohor shekullor.

Libri përmban 105 fotografi, nga të cilat 18 janë me ngjyra, si edhe 8 grafika. Në fund, Nimani ka përpiluar edhe një bibliografi të artikujve e studimeve për Onufrin e piktorët e tjerë[2].

Vlen për t'u vënë në dukje se formulimi grafik i këtij libri – album është tepër tërheqës e me shije artistike të larta.

Mendojmë se ky botim i rëndësishëm do të fitonte më shumë në qoftëse autori do të kishte në dorë gjithë literaturën shkencore kushtuar veprës onufriane e piktorëve shqiptarë mesjetar, si dhe nëse do të thellohej më tepër në analizat ideoestetike e profesionale. Pavarësisht nga ndonjë mungesë, apo edhe nga ndonjë pasaktësi, si p.sh. cilësimi i stilit të Onufrit si shprehje e një «realizmi fantastik», kur dihet fare mirë se kemi të bëjmë me një pikturë pasbizantine me elemente kompozicionale, ku luan rol të dukshëm vendosja konvencionale e figurave me një ose dy pika të shikimit, shpesh me mungesën e prespektivës ose të përdorimit të ashtuquajturës «prespektivë negative», duke krijuar kështu një ndjesi të pazakontë si edhe ireale etj, libri – album për të cilin folëm në këtë shkrim ka rëndësi veç të tjerave edhe si një vepër nismëtare në llojin e vet në historikun e arteve figurative të kombit shqiptar në kohëra të ndryshme.

2) Bibliografisë së shënuar nga Sh. Nimani po i shtojmë V. Puzanaova «Piktori i madh i shek. të XVI Onufri nga Neokastra» në BSHSH Tiranë 1953, 3 f. 8-23. St. Pelekanidhis, «Kastoria», I. Thessaloniqi, 1953, Th. Popa «Onufri piktor i madh shqiptar i shek. të XVI», BSHSH, Tiranë 1957, f. 208-219, po ai «Onufri ikonograf i shquar shqiptar» BSHSH, Tiranë 1962, I, f. 54-57, po ai, «Të dhëna të reja rreth piktor Onufrit në Studime historike», Tiranë, 1966, I, f. 141-145, po ai «Rreth veprës së Onufrit» në «Monumente të kulturës në Shqipëri», Tiranë 1975, 2, f. 72-74, M. Zeqo «Bariu i Onufrit dhe Farëmbjellësi i David Selenicës», në «Nëntori», Tiranë 1977, I, f. 205-210, po ai, «Piktori i madh i Shpatit dhe ngjyrat e kohës tonë», «Nëntori» Tiranë 1979, 10, f. 232-239.

DO NOT COPY

Moikom ZEQO

«ONUPHRE ET D'AUTRES PEINTRES ALBANAIS DU MOYEN ÂGE» – LIVRE ALBUM ÉCRIT PAR SHYQYRI NIMANI

RÉSUMÉ

Shyqyri Nimani, graphiste et personnalité connue albanaise de Kosova écrit un livre-album de 127 pages (22,5 x 29 cm) intitulé «Onuphre et d'autres peintres albanais du moyen âge», apparu à Prishtina en 1987.

Ce livre donne une contribution particulière à la vulgarisation de quelques principales valeurs artistiques de la considérable création d'Onuphre, le grand peintre du XVI sc, et des oeuvres des autres peintres de la collection importante séculaire des arts figuratifs du moyen âge en Albanie, qui ont rayonné dans les autres pays des Balkans et en Italie du sud.

Cette importante édition aurait eu plus de valeur si l'auteur avait disposé de toute la littérature scientifique dédiée à l'oeuvre d'Onuphre et à celle des autres peintres albanais du moyen âge et s'il s'était approfondi davantage dans les analyses idéo-esthétiques et professionnelles. Indépendamment de quelque lacune ou incorrection, ce livre – album offre de l'importance en tant que première oeuvre sur l'histoire des arts figuratifs albanais de différentes époques.

DO NOT COPY

DO NOT COPY